

**Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
MISIONI NË KOSOVË**

**DEPARTAMENTI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE SUNDIM TË SË
DREJTËS**

KOSOVË

**SHQYRTIMI I SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE
SHTATOR 2001-SHKURT 2002**

**TEMAT:
PAVARËSIA E GJYQËSISË
PARABURGIMI
ÇËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL**

TABELA E PËRMBAJTJES

<u>SHKURTESAT</u>	4
<u>FUSHËVEPRIMI I RAPORTIT</u>	6
METODOLOGJIA	6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
QËSHTJET TEMATIKE	8
PAVARËSIA E GJYQËSISË	8
PARABURGIMI	8
ÇËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL	9
<u>PJESA 1: MONITORIMI</u>	10
I. MANDATI I SEKSIONIT TË MONITORIMIT TË SISTEMIT LIGJOR	10
RAPORTI ME SHTYLLAT TJERA	11
DREJTA PËR GJYKIM OBJEKTIV (TË DREJTË)	12
RASTET PRIORITARE	13
<u>PJESA 2: LIGJI I APLIKUESHËM</u>	14
ZHVILLIMET E THEKSUESHME NË LIGJIN E APLIKUESHËM	14
II. ÇËSHTJET QË RRJEDHIN NGA SHQYRTIMET E MË PARSHME TË OSBE-SË	15
HARTIMI DHE IMPLEMENTIMI I LIGJEVE TË REJA	15
KRIMINALITETI I TRAFIKIMIT DHE PËRGJIGJJA E AUTORITETEVE TË UNMIK-UT	16
ÇËSHTJET E PËRKTHIMIT/INTERPRETIMIT	19
EKSPERTËT GJYQËSOR DHE CILËSIA I EKSPERTIZAVE FORENZIKE	19
III. ZHVILLIMET BRENDA SISTEMIT GJYQËSOR DHE STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË	20
SEKSIONET E SPECIALIZUARA BRENDA DD	20
INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS	20
NJËSITI I INSPEKSIONIT GJYQËSOR DHE KËSHILLI GJYQËSOR DHE I PROKURORISË TË KOSOVËS	21
INSTITUTI FORENZIK	21
IMPLEMENTIMI I REKOMANDIMEVE TË OSBE	22
<u>PJESA 3: PAVARËSIA E GJYQËSISË</u>	23
I. HYRJE	23
II. PAVARËSIA INSTITUCIONALE/ORGANIZATIVE	24
EMËRIMI I GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE	24
EMËRIMI I GJYKATËSVE DHE PROKURORËVE DHE NDARJA E LËNDËVE	26

PËRGJEGJËSIA DISIPLINORE DHE SHKARKIMI NGA DETYRA	28
III. PAVARËSIA FUNKSIONALE	31
NDËRHRYJA E EKZEKUTIVIT NË PAVARËSINË GJYQËSORE	31
NDËRHRYJA E LEGJISLATIVIT NË PAVARËSINË GJYQËSORE	33
IMUNITETI PËR UNMIK-UN DHE KFOR-IN	34
IV. REKOMANDIMET	39
PJESA 4: PARABURGIMI	40
<hr/>	
I. HYRJE	41
II. PARABURGIMI SIPAS URDHËRIT EKZEKUTIV TË PSSP-SË	41
III. PARABURGIMI NGA KFOR-I	42
SHQYRTIMI FAKTIK	42
BAZAT PËR PARABURGIM	43
PRAKTIKA E PARABURGIMIT 72-ORËSH NGA ANA E KFOR-IT	46
IV. REKOMANDIMET	47
PJESA V: ÇËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL	47
<hr/>	
I. PARABURGIMI	48
INSTITUCIONI SPECIAL NË SHTIMJE	48
SPITALI I PRISHTINËS	50
PËRDORIMI I “MASAVE TË SIGURISË” NË KUADËR TË SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE	51
II. TRAJTIMI I TË BURGOSURVE ME NEVOJA TË SHËNDETIT MENTAL	51
III. EKSPERTIZA E SHËNDETIT MENTAL BRENDA SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE	53
IV. REKOMANDIMET	53
LIGJET	54
PARABURGIMI	54
TRAJTIMI I TË BURGOSURVE	54
PROVAT E EKSPERTIZËS	55
REKOMANDIMET E KONSOLIDUARA	56
<hr/>	
PAVARËSIA E GJYKATAVE	56
PARABURGIMI	57
QËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL	57
LIGJET	57
PARABURGIMI	57
TRAJTIMI I TË BURGOSURVE	57
PROVAT E EKSPERTËVE	58

SHKURTESAT

ABA-CEELI	Iniciativa Ligjore e Asociacionit Amerikan për Evropën Lindore dhe Qendrore
DAD	Departamenti Administrativ i Drejtësisë
KEGJFDKF	Konventa mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
COMKFOR	Komandanti i Forcave të NATO-s në Kosovë
QPS	Qendrat për Punë Sociale
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
PLPP	Projekti i Ligjit të Procedurës Penale
DSHMS	Departamenti për Shëndetësi dhe Mirëqenje Sociale
DD	Departamenti i Drejtësisë
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
RFJ	Republika Federale e Jugosllavisë
LP RFJ	Ligji Penal i RFJ-së
LPP RFJ	Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së
Ish-RJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
KNDCP	Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
GJND	Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë
KNKK	Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
GJNPJ	Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë
KPK	Këshilli i Përbashkët Këshilldhënës mbi Çështjet Juridike
NJIGJ	Njësia e Inspektionit Gjyqësor
KFOR	Forcat e Kosovës
KGJPK	Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë së Kosovës
LPK	Ligji Penal i Kosovës

SHPK	Shërbimi Policor i Kosovës
LKV	Ligji mbi Kundërvajtjet
SMSL	Seksioni për Monitorim të Sistemit Ligjor
GJKV	Gjykatat për Kundërvajtje
MTU	Marrëveshja Tekniko-Ushtarake
NATO	Organizata e Aleancës Veri-Atlantike
ZKLDNJ	Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
ZKJ	Zyrë e Kshilltarit Juridik
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RKS	Rezoluta e Këshillit të Sigurimit
PSSP	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SHKFAE	Shtabi Kryesor i Fuqive të Aleancës në Evropë
NJHTP	Njësia Hetimore për Trafikim dhe Prostitucion
UNHCR	Komisioneri i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuara
UNICEF	Fondacioni i Kombeve të Bashkuara për Fëmijë
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

FUSHËVEPRIMI I RAPORTIT

Në dy raportet e para mbi sistemin e të drejtës penale¹, OSBE, nisur nga këndvështrimi i legjislacionit mbi të drejtat e njeriut, ka prezentuar një analizë të gjërë dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të drejtësisë. Shqetësimet e shprehura në këto raporte i referohen rasteve specifike ku aktivitetet e gjyqësisë, të administratorëve të tyre dhe organeve të rendit, dështuan të reagojnë në përputhshmëri me standardet dhe garancat e gjykimit të drejtë dhe të procedurës së rregullt. Raporti i tretë² i OSBE-së ndërroi fushëveprimin e tij për të identifikuar shqetësimet brenda sistemit të gjyqësisë në nivelin struktural. Gjerësisht janë adresuar fushat e veçanta përmbajtësore të sistemit të së drejtës penale, për të cilat konsiderohet se kanë ngritur çështjet më kryesore të të drejtave të njeriut. Praktikrat e paraburgimeve të paligjshme, çështjet e mbrojtjes, dhuna seksuale dhe trafikimi janë shqyrtuar për të ndriqur pengesat e vazhdueshme të harmonizimit me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Ky raport mbi sistemin e të drejtës penale, e ka të njejtën qasje si ai i kaluari. Çështjet siq janë, pavarësia e gjyqësisë, kompetencat e organeve ekzekutive dhe ushtarake për paraburgim, dhe paraburgimet e vazhdueshme arbitrare të personave të sëmurë psiqikisht në Kosovë, paraqesin fushat më të mëdha të shqetësimeve të cilat i adreson ky raport. Në harmoni me traditën tanimë të krijuar nga raportet e më hershme publike, OSBE, gjithashtu do të paraqesë rekomandimet gjegjëse për të ndihmuar Shtyllën I dhe autoritetet tjera përgjegjëse në konstituimin efektiv të rregullave dhe politikave të tyre të nevojshme.

Theksimi i ri i OSBE-së në shqetësimet strukturale tematike përbrenda sistemit të drejtësisë, ka për mandat një mbivështrim shumë më të gjërë të zhvillimit dhe të kaluarës së sistemit, i cili ndonjë herë, mund të prekë në çështje, raste, apo pjesë të legjislacionit që qëndrojnë jashtë periudhës kohore të cilën e mbulon ky raport gjashtë mujor. Rastet apo legjislacioni i tillë, do të analizohet dhe komentohet edhe nëse i njëjti është përmendur në raportet e më hershme.

METODOLOGJIA

Analizat dhe argumentet nga ky raport janë të bazuara në të dhënat dhe informatat faktike të mbledhura gjatë periudhës së raportimit të monitoruesve të terrenit të OSBE-së. Monitoruesit e OSBE-së kanë mbledhur shënime gjatë përcjelljeve të drejtpërdrejta të procedurave gjyqësore, gjatë shqyrtimeve të shkresave të lëndëve, dhe intervistave personale me akterët relevant (gjykatësit, zyrtarët e gjyqësisë, prokurorët, avokatët mbrojtës, dhe zyrtarët e organeve të rendit). Gjatë kësaj periudhe të raportimit, zyrtarët e SMSL në terren, monitoruan njëqind e pesëdhjet e gjashtë (156) raste. Pesëdhjetë nga këto raste kanë qenë të lidhura me akuzat për krime lufte, krime të motivuara etnikisht apo politikisht, dhe krim të organizuar, (19 raste për krime lufte dhe të motivuara etnikisht, 9 raste për krim të organizuar, dhe 22 raste -trafikim të personave-). Çështjet e ngritura dhe argumentet e bëra në tre shqyrtimet e më hershme të sistemit të gjyqësisë penale, nuk përsëriten tërësisht në këtë raport. Në vend të kësaj, aty ku shfaqet nevoja, dokumenti i tanishëm i referohet raporteve të më hershme përmes fusnotave.

Rastet që përkrahin apo ilustrjnë analizat dhe përfundimet e këtij raporti paraqiten si të ndara në paragrafe të veçuara të cilat janë të kufizuara nga teksti kryesorë. Kjo për arsye që t'ju ndihmohet lexuesve për të dalluar rastet e marrura si shembuj nga paragrafet analitike të raportit. Materiali nga paragrafet e veçuara përbëhet nga të dhënat dhe rastet faktike.

¹ Shqyrtimi i Gjyqësisë Penale i OSBE-së 1 shkurt 2000-31 korrik 2000 (tasht e tutje shqyrtimi i parë); Shqyrtimi i Gjyqësisë Penale I OSBE-së, 1 shtator 2000-28 shkurt 2001 (tash e tutje shqyrtimi i dytë);

² Shqyrtimi i Gjyqësisë Penale i OSBE-së, tetor 2001 (tash e tutje shqyrtimi I tretë)

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky dokument është raporti i katërt publik i rradhës mbi sistemin e gjyqësisë penale, dhe i përgatitur nga Seksioni i Monitorimit të Sistemit Ligjor (SMSL). SMSL është pjesë e Divizionit për të Drejtat e Njeriut të Shtyllës III të UNMIK-ut (Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë – OSBE). Ky raport mbulon periudhën kohore prej shtatorit të v.2001, deri në shkurt të v.2002. Kombet e Bashkuara - Misioni i Administratës së Përkohshme në Kosovë (UNMIK), përmes Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), në pajtim me pushtetin ekzekutiv dhe legjislativ me të cilin e pajisë Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara – ka mandatin për të administruar sistemin gjyqësor në Kosovë.

Ky mandat momentalisht përmbushet nga Shtylla e parë e UNMIK-ut për Polici dhe Drejtësi, e cila ka integruar departamentin e policisë me atë të çështjeve juridike për të lehtësuar bashkërendisjen interne dhe bashkëpunimin me OSBE-në, KFOR-in dhe organizatat tjera ndërkombëtare të vendosura në Kosovë. Sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/09 për Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, (Korniza Kushtetuese e hyrë në fuqi me 15 maj 2001), disa nga funksionet administrative të sistemit të gjyqësisë, u janë bartur institucioneve të reja të vetëqeverisjes së përkohshme, respektivisht, Ministrisë të Shërbimeve publike.

Në pajtim me mandatin e saj, OSBE, në kuadër të UNMIK-ut, ndanë, përgjegjësinë *për të siguruar se çështjet e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut janë të adresuara gjatë aktiviteteve të gjithëmbarshme të misionit*³. Në përputhje me mandatin e UNMIK-ut që të zhvilloj mekanizma për të siguruar pajtueshmërinë e organeve të rendit publik dhe sistemit gjyqësor me standardet ndërkombëtare të gjyqësisë penale dhe të drejtave të njeriut, OSBE ka vazhduar t'i fokusoj kapacitetet e veta monitoruese në identifikimin e shqetësimeve për të drejtat e njeriut në të gjitha nivelet e sistemit të gjyqësisë. Ky shqyrtim pretendon të kuptohet si instrument ndihmës për adresim gjithpërfshirës të sfidave/problemeve të llojllojshme që paraqiten para sistemin gjyqësor penal, dhe me qëllim të përparimit/avancimit të një kulture të respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të së drejtës.

Siq është shprehur në raportet e mëparme⁴, OSBE kupton pengesat me të cilat është përballuar UNMIK-u, në themelimin e sistemit gjyqësor në shoqërinë së cilës i mungon si korniza koherente ligjore ashtu edhe bërthama e profesionistëve me përvojë përbrenda gjyqësisë lokale, për shkak të përjashtimit të një numri të konsiderueshëm të tyre nga sistemi ligjor në periudhën para vendosjes së UNMIK-ut. Megjithatë, një sistem gjyqësor funksional tani është themeluar ndërsa gjendja e jashtëzakonshme ka përfunduar, andaj, duhet siguruar pajtueshmërinë me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në kuptim të mbrojtjes dhe promovimit të drejtave të njeriut, aprovimi i Rregullores 2001/9, nënkupton njohjen e nivelit më të lartë të zbatueshmërisë së drejtpërdrejtë të mekanizmave për të drejtat e njeriut në kuadër të kornizës ligjore në Kosovë. Çdo shkelje e këtyre standardeve themelore nga çfarëdo autoriteti duhet të vrojtohet dhe menjëherë të adresohet, pasi që mund të krijoj precedent të kundërt me zhvillimin e ardhshëm të sistemit gjyqësor dhe shoqërisë në përgjithësi.

³ Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së për Këshillin e Sigurimit të KB-së 12 korrik 1999, para. 87.

⁴ Lexo shqyrtimi i Sistemit të Gjyqësisë Penale i OSBE-së 1 shtator 2000-28 shkurt 2001, Përmbledhje Ekzekutive.

QËSHTJET TEMATIKE

Pavarësia e gjyqësisë

Pavarësia e gjyqësisë paraqet pjesën përbërse të secilës kornizë qeveritare moderne dhe demokratike, dhe qëndron si kusht paraprak për mbrojtjen e procesit gjyqësorë nga intervenimi jo legjitim nga ana e shtetit. Gjithashtu u jep individëve garanca që procedura gjyqësore posedon mekanizma për të ofruar mbrojtje juridike, kur ajo është e nevojshme, nga veprimet apo vendimet e autoriteteve tjera të shtetit. Me fjalë të tjera, pavarësia gjyqësore garanton përgjegjësi qeveritare.

Ky shqyrtim do të analizojë nivelin teorik dhe praktik ekzistues të pavarësisë së gjyqësisë përbrenda strukturës së UNMIK-ut, dhe do të konsideroj këtë pavarësi nga perspektiva e dy koncepteve të saj themelore: pavarësia institucionale dhe pavarësia funksionale.

Pavarësia në kuptim institucional, kërkon që gjyqësia të përbëhet nga zyrtarët, emrimet, ushtrimi i detyrës së tyre dhe përgjegjësia disiplinore e të cilëve gëzon një autonomi efektive institucionale. Në këtë drejtim, OSBE do të analizoj nivelin në të cilin procedura e emrimit dhe e vazhdimit të kontratave të gjykatësve dhe prokurorëve, si atyre vendorë ashtu edhe ndërkombëtarë, është në përputhje me garancat dhe standardet e gjyqësisë së pavarur. Aspektet e organizimit të brendshëm të gjykatave siq është, mekanizmi i caktimit të rasteve për gjykatësit apo kolegjet e gjykatësve, gjithashtu do të adresohen nga perspektiva e kontrollit që degët ekzekutive të UNMIK-ut mund të ushtrojnë në mekanizmat e tilla. Në fund, përgjegjësia disiplinore, e konsideruar si garancë e pavarësisë institucionale por edhe si garancë kundër ndarjes së gabuar të drejtësisë, do të shqyrtohet në raport me mënyrën në të cilën funksionon mekanizmi disiplinues; OSBE gjithashtu do të përqendrohet në përputhshmërinë e këtyre mekanizmave me standardet relevante ndërkombëtare dhe gjithashtu zbatueshmërinë e tyre ndaj gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë të punësuar nën kornizën e UNMIK-ut.

Pavarësia në kuptimin funksional implikon mos-përzierjen organeve tjera jo-gjyqësore në ushtrimin e funksioneve gjyqësore, dhe gjithashtu mbulon obligimin e shtetit që të ruaj punën e pavarur të gjykatave, gjegjësisht pavarësinë personale të gjykatësve. Përbrenda kornizës konceptuale të pavarësisë funksionale, OSBE do të adresohet çështjes së ndërhyrjes ekzekutive nga ana e PSSP dhe KFOR-i në fushën e marrjes së vendimeve, dhe gjithashtu do të përqendrohet në intervenimet legjislative të cilat dëmtojnë pavarësinë funksionale. Sëkëndejmë, OSBE, do të shqyrtoj edhe çështjen e konfliktit në mes të imunitetit, i cili e mbron UNMIK-un dhe KFOR-in nga çfarëdo procesi gjyqësor në Kosovë, dhe pavarësisë së gjyqësisë.

Paraburgimi

Ndalimi i arrestimeve dhe paraburgimeve arbitrare është pjesë fundamentale e ligjit ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut. OSBE vuri në pah në raportet e mëparshme se konflikti i supozuar në mes të çështjes së sigurisë dhe drejtësisë, nuk mund të përdoret si arsye për ndërhyrje të ekzekutivit në sferën gjyqësore, veçanërisht duke paraburgosur personat jashtë procesit gjyqësorë.⁵ Në vend të kësaj, OSBE identifikoi nevojën për një strategji të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse për t'ju adresuar sfidave afat-gjata në sistemin gjyqësorë, në atë mënyrë që do të mund të mbulonte me sukses fushat e kriminalitetit në të cilat PSSP dhe KFOR-i kanë vazhduar të ushtrojnë ndërhyrjen ekzekutive. Pa marrë parasyshë rekomandimet konkrete nga OSBE, dhe përpjekjet e bëra nga DD për të siguruar

⁵ Lexo shqyrtimi i dytë, Përmbledhje Ekzekutive, faqe 3.

dispozicionin e gjykatësve dhe bashkëpunëtorëve profesional, kurdo që duhet të bëhet marrja në pyetje gjatë paraburgimit, KFOR-i ka vazhduar, megjithëse, në muajt e fundit në një shkallë më të vogël, të paraburgosë personat pa u bazuar në ligjin në fuqi dhe pa ofruar mundësi për një rishqyrtim gjyqësor.

Edhe një tjetër fushë e paraburgimeve jashtë-gjyqësore, për të cilat OSBE ka raportuar në të kaluarën, është praktika e Urdhërit Ekzekutiv të lëshuar nga PSSP⁶. Në këtë drejtim, OSBE përshëndetë faktin se PSSP nuk ka lëshuar ndonjë Urdhër Ekzekutiv në gjashtë muajt e fundit, dhe momentalisht, nuk ka persona të paraburgosur në bazë të Urdhërit Ekzekutiv. Duke pasur parasysh këto zhvillime, ende ekzistojnë disa shqetësime të caktuara në lidhje me pushtetin e PSSP-së në fushën e privimit nga liria.

Çështjet e shëndetit mental

Edhe një fushë në të cilën zhvillimet mund të konsiderohen si dëshpruese, është paraburgimi i të sëmurëve mental. OSBE vazhdimisht ka theksuar në shqyrtimet e saj të sistemit të gjyqësisë - se numri më i madh i të paraburgosurve në mënyrë kundërligjshme në Kosovë, ekziston brenda sistemit shëndetit mental⁷. Kjo gjithashtu është aspekti i paraburgimit ku më së paku ka pasur përparim në adresimin e çështjes së privimit të kundërligjshëm nga liria. Në këtë raport OSBE, do të trajtoj shqetësimet që kanë të bëjnë me personat me paaftësi mentale dhe sistemin gjyqësor, e që shtrihen në tre fusha kryesore; përdorimi i paraburgimit; trajtimi i të burgosurve të ligjshëm; dhe përdorimi e ekspertizës së shëndetit mental përbrenda sistemit të gjyqësisë penale.

⁶ Lexo shqyrtimi i tretë, pjesa 4, faqe 32-35

⁷ Lexo shqyrtimi i tretë, pjesa 4, faqe 41-42.

PJESA 1: MONITORIMI

I. MANDATI I SEKSIONIT TË MONITORIMIT TË SISTEMIT LIGJOR

Me *Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të KB* (RKS 1244), Këshilli i Sigurimit i KB ka autorizuar Sekretarin e Përgjithshëm të KB që në Kosovë të themeloj prezencën civile ndërkombëtare, e cila do të vendoste një administratë të përkohshme. Njëra prej përgjegjësive kryesore të prezencës ndërkombëtare ishte “mbrojtja dhe afirmimi i të drejtave të njeriut”.⁸

Sekretari i Përgjithshëm i KB në referimin e tij para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 korrik 1999, rolin udhëheqës për ndërtimin e institucioneve në kuadër të UNMIK-ut i’a ka caktuar OSBE-së dhe ka vënë në pah se njëra prej detyrave të Shtyllës së Ndërtimit të Institucioneve (Shtylla III) do të përfshijë monitorimin e të drejtave të njeriut dhe ndërtimin e kapaciteteve.

Në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB para Këshillit të Sigurimit të KB të datës 12 korrik 1999, janë dhënë instruksione UNMIK-ut për themelimin e mekanizmave bashkërendues në mënyrë që të lehtësohet monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe funksionimi i drejtë i sistemit gjyqësor, duke shtuar këtu se raportimi duhet të zhvillohet në mënyrë të bashkërenditur në mënyrë që të lehtësohet zotësia e veprimit. E në veçanti:

“UNMIK-u do të ketë një trup monitoruesish dhe këshilltarësh për të drejtat e njeriut të cilët do të kenë *qasje të papenguar* në të gjitha pjesët e Kosovës për të hetuar cenimet e të drejtave të njeriut dhe do të sigurojnë që shqetësimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut të jenë të shfaqura nëpërmjet të aktivitetit të gjithmbarshëm të misionit. Monitoruesit e të drejtave të njeriut lidhur me informatat e mbledhura i raportojnë Përfaqësuesit Special përmes zëvendësit të tij të ngarkuar për ndërtimin e institucioneve. Të dhënat e mbledhura nga monitoruesit e të drejtave të njeriut do të publikohen në baza të rregullta dhe do të shkëmbehen sipas nevojës edhe me mekanizmat për të drejtat e njeriut në kuadër të Kombeve të Bashkuara, e në konsultim me Zyren e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. UNMIK-u do të mundësoj raportimin bashkërendues dhe zotësinë për të vepruar”. (Para. 87).

Në “Dokumentin e Marrëveshjes”, më 19 korrik 1999, në mes të nën-Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Operacione Paqëruajtëse dhe Kryesuesit të Radhës të Zyres së OSBE-së, vendoset që Shtylla III, OSBE-ja do të zhvilloj mekanizma për të garantuar se gjyqet, tribunalet administrative dhe strukturat tjetra gjyqësore të veprojnë në harmoni me standardet ndërkombëtare të së drejtës penale dhe të drejtave të njeriut. Për më shumë, duke u thirrur në *Rregulloren 2000/15* të datës 21 mars 2000 mbi themelimin e Departamentit Administrativ të Drejtësisë, është marrë konfirmimi nga ana e Departamentit Administrativ të Drejtësisë që OSBE-ja të jetë organizata përgjegjëse për monitorimin e pavarur të sistemit gjyqësor dhe shërbimit korrektues.

Qarkorja Gjyqësore (2001/15) e shpallur më 6 qershor 2001, u konfirmoi qasjen monitoruesve të OSBE për të drejtat e njeriut në procedurat dhe dokumentet gjyqësore. Qarkorja pritet të forcoj kuptimin e gjyqësisë përkitazi me mandatin e OSBE, dhe të siguroj mbulimin e tërësishëm të të gjitha fazave të procedurës penale nga monitoruesit e OSBE. Sidoqoftë, OSBE vazhdon të përjetojë mohimin e qasjes në dëgjimet hetimore dhe në shkresat e lëndës gjatë fazës hetimore, ekskluzivisht në rastet e zhvilluara nga gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë. Ky qëndrim i adoptuar nga zyrtarët ndërkombëtarë

⁸ Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, 12 qershorë 1999 para. 11/j.

gjqësor ka pasur efekt në pengimin e OSBE për të ushtruar mandatin e saj. Monitorimi i sistemit gjyqësor kërkon njohjen e plotë dhe të saktë të përmbajtjes së punëve gjyqësore. Që OSBE të jetë në gjendje të lëshoj raporte të bazuara, dhe në mënyrë precize të përcaktoj pajtueshmërinë me standardet e pranuar ndërkombëtarisht për të drejtat e njeriut, është kruciale që të bëhet një vështrim i plotë në faktet dhe procedurat e rasteve të monitoruara. Përpjekjet për të sqaruar këtë çështje me DD nuk kanë pasur rezultate përbrenda periudhës së raportimit, kështu duke vështirësuar mundësitë e OSBE-së për të kryer detyrimet e parapara që në themelimin e misionit.⁹

Raporti me Shtyllat tjera

OSBE, ka paraparë në shqyrtimet e më parshme të sistemit të gjyqësisë penale një bashkëpunim të ngushtë me Shtyllën e Parë të UNMIK për Polici dhe Drejtësi, pasi që objektivat e caktuar nga ky i dyti hyjnë në qëllimet substanciale të ndërtimit të institucioneve dhe kapaciteteve e theksuar nga OSBE. Në nivelin e sistemit të gjyqësisë penale, Shtylla e parë është caktuar për të konsoliduar “*strukturën e ligjit dhe rendit e cila është logjikisht funksionale, e veçanërisht në themelimin e një procesi gjyqësorë të pa anshëm, fillimisht përmes pjesëmarrjes ndërkombëtare dhe reformën e sistemit gjyqësorë*”¹⁰ në të njëjtin drejtim dhe në bazë të mandatit të OSBE-së, Departmenti për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës (DNjSD), promovon zhvillimin e një shoqërie të bazuar në sundimin e së drejtës dhe duke garantuar respekt të plotë për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale të secilit individ. Këto qëllime të përbashkëta të caktuara nga OSBE dhe Shtylla e Parë mund të ndiqen në mënyrë efektive vetëm përmes inkorporimit të dimensionit të të drejtave të njeriut në procesin e vendim-marrjes në nivelin e Shtyllës së Parë. Pas shpërbërjes së Zyrës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të zyrës së PSSP-së, OSBE, u bë organi i vetëm brenda UNMIK-ut me mandatin për të drejtat e njeriut. Rregullat dhe strukturat e vendim-marrjes brenda UNMIK-ut, për momentin, u mungon komponenta e të drejtave të njeriut. Mëtej, si shqetësim tjetër paraqitet mungesa e vazhdueshme e vëzhgimit të të drejtave të njeriut në kuadër të Rregulloreve të UNMIK-ut, përkundër ankesave të shpeshta dhe të mëdha mbi këtë çështje që nga viti 1999. Rrjedhimisht, pjesëmarrja dhe konsultimet aktive të OSBE-së në këto struktura janë qenësore, nëse mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe promovimi tyre duhet të mbikqyren plotësisht, në kuadër të UNMIK-ut por dhe nga UNMIK-u.¹¹

Departamenti i të Drejtave të Njeriut dhe Sundimit të së Drejtës pranë OSBE-së, si pjesë e Shtyllës për ndërtimin e institucioneve, bashkëpunon ngushtë me organizatat e KB siç janë, OHCHR, UNHCR dhe UNICEF. Departamenti bashkëpunon gjithashtu edhe me organizatat tjera ndërkombëtare dhe të vendit siç janë, Këshilli i Evropës, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe Dhoma e Avokatëve Amerikan-Iniciativa Ligjore për Evropën Qendrore dhe Lindore (ABA-CEELI).

Që nga nëntori i v.2001, OSBE ka bashkëpunuar me Tribunalin Ndërkombëtar Penal për Ish-Jugosllavinë (ICTY) përmes zyres së ndërlidhjes së ICTY në Prishtinë. OSBE e informon rregullisht me shënimet më të reja koordinatorin e zyrës së ICTY për Kosovë, përkritazi me proceset gjyqësore nëpër gjykatat vendëse lidhur me krimet e luftës dhe ato të motivuara politikisht/etnikisht. Krahas

⁹ Një marvesgje me Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit Ligjor pranë OSBE-së me DD, për qasjen monitorëve të OSBE-së në procedurat gjyqësore dhe dokumentet gjatë hetuesisë, është nënshkruar me 22 Prill 2002.

¹⁰ Lexo, prezantimi i ZPSSK i Shtyllës së Parë në artikullin “Themelimi i sistemit të ri të Policisë dhe Drejtësisë” në lajmet e UNMIK-ut Nr. 93, 21 maj. 2001

¹¹ Në raportin e Përfaqësuesit Special të Komisionit për të Drejtat e Njeriut për situatën e të drejtave të njeriut në Bosne dhe Hercegovinë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë, të prezantuar me 8 janar 2002 në seancën e 58 të Komisionit të KB-së për të Drejtat e Njeriut, është përmendur që “Përfaqësuesi Special mbetet i shqetësuar që parimet e të drejtave të njeriut nuk janë integruar mjaft në procesin nga i cili legjislacioni dhe procedurat administrative janë shpallur dhe inplemetuar.”

kësaj, shqetësimet, qëndrueshmëria apo zhvillimet përkitazi me sistemin penal gjyqësor të Kosovës, ashtu si të identifikuar nga OSBE, shkëmbehen me Zyren e ICTY për tu përfshirë në raportin e qasjes të Gjykatës së Hagës.

Si pjesë e Shtyllës III dhe e UNMIK-ut si tërësi, mandati i monitorimit të sistemit ligjor të OSBE-së përfshin raportimin e saktë dhe të menjëhershëm në kuadër të UNMIK-ut mbi: statistikën aktuale mbi sistemin e gjyqësisë penale, shkeljet sistematike të së drejtës ndërkombëtare, dhe shkeljet e rënda të standardeve mbi gjykimin objektiv në rastet individuale, të cilat duhet menjëherë të menjahohen (shërohen).

SMSL, si pjesë e Departamentit të DNJSD, mbanë raporte konsistente dhe bashkëpunuese me Shtyllat tjera dhe me agjencitë tjera ndërkombëtare. Shkeljet sistematike, trendet e vëzhguara, problemet individuale dhe çështjet e identifikuar nga SMSL, në kuadër të mandatit më të gjërë të OSBE-së, i komunikohen DD-së rregullisht, dhe në baza javore. Për më tepër, SMSL përherë ka shprehur vullnetin për të punuar më ngushtë me DD për të ndihmuar në implementimin dhe adresimin e këtyre shqetësimeve sistematike. Rrjedhimisht, një raport pune më efikas, në mes të Departamentit DNJSD dhe DD-së, mund të rezultoj si rrjedhojë e një dialogu më të shtuar dhe transparence më të theksuar. Një përgjigje dhe komunikim më konsistent do të shërbente shmangjes së instancave, kur veprimet e DD-së të ndërmarra në bazë të monitorimit dhe kapaciteteve raportuese të SMSL, nuk përcillen në mënyrë efektive dhe nuk shkëmbehen me OSBE. Në një theks pozitiv, mund të themi se SMSL ka përmirësuar raportet me Njësinë e Inspektionit Gjyqësor të DD-së, pasi që ky i fundit, kishte themeluar politikën gjegjëse të ofrimit të përgjigjes lidhur me ankesat e pranuar nga SMSL. SMSL dhe NJIGJ gjithashtu janë pajtuar për një mekanizëm më konsistent të përdorimit të të dhënave të mbledhura nga OSBE përmes monitorimit gjyqësor, për t'u përdorur si pikë fillestare për përpjekjet e NJIGJ për të mbledhur dëshmitë për hetimet e tyre.

Drejta për gjykim objektiv (të drejtë)

Standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë pjesë e legjislacionit pozitiv në bazë të *inter alia Rregullores 1999/24*, e cila obligon bartësit e funksioneve publike në Kosovë që t'i përmbahen standardeve të pranuar ndërkombëtarisht mbi të drejtat e njeriut, e së voni përmes Kornizës Kushtetuese.¹² Krahas kësaj, Republika Federative e Jugosllavisë është palë e një numri të instrumenteve për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe *Konventën Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike* (KNDCP), e cila për ndryshe, obligon secilin organizëm qeveritar në këtë territor që t'i garantojë popullit të Kosovës këto të drejta.

- OSBE analizon ligjin dhe praktikën vendëse lidhur me pajtueshmërinë e tyre me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe objektivitetin në procedurën penale. Standardet ndërkombëtare janë të precizuara, *inter alia*, në nenet 9,10,14 të KNDCP dhe nenet 5,6 të *Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut* (KEDNj) dhe standardeve tjera të KB që nuk përfshihen në Pakte. Ligji vendës – kryesisht *Ligji i Procedurës Penale i RFJ-së* (LPP) dhe *Ligji Penal i Kosovës* (LPK), në bazë të analizës së SMSJ-së. Analiza e “Gjyimit objektiv” në bazë të legjislacionit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut fillon prej momentit kur individit arrestohet nga ana e autoriteteve, deri në shtjellimin përfundimtar të rastit.

¹² Rregullorja e UNMIK-ut 2001/09 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetqeverisjen e Përkohshme, e miratuar me 15 maj 2001, Kreu 3, neni 3.3.

OSBE monitoron rastet të cilat përshkojnë tërë sistemin penal të drejtësisë, prej momentit të arrestimit dhe/apo paraburgimit deri te gjykimi dhe ankesa. OSBE, monitoron rastet që kanë të bëjnë me vepra të rënda penale, shumica prej të cilave janë të parapara nga OSBE, si raste prioritare dhe që bijnë në kompetencën e gjykatave të qarkut. Disa raste në gjykatat komunale apo ato kundërvajtëse mund të monitorohen nëse përfshijnë çështje prioritare siç janë, rastet ku përfshihen minoritetet, të miturit dhe femrat.

Para pjesëmarrjes në procedurën formale të gjykimit, dhe aty kur kjo është praktike, monitoruesit e SMSL-së, hetojnë rastin në mënyrë që të sigurohen se ka pasur mundësi të parashtrihen dhe të trajtohen të gjitha çështjet lidhur me të drejtat para fillimit të gjykimit. Hetimi në fjalë krijon bazën për monitoruesit e OSBE, për analizën e procedurës gjyqësore. Monitoruesit e OSBE, mbledhin të dhëna duke shqyrtuar lëndën, nëse ka qasje; dhe, bëjnë intervistimin e të dyshuarve/të burgosurve, policisë/KFOR-it, avokatëve mbrojtës, prokurorëve publik, gjykatësve hetues dhe të tjerëve. Monitoruesit e OSBE, marrin pjesë në gjykime dhe raportojnë mbi praktikën e përdorur në procedurën para-penale dhe atë penale dhe në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare dhe vendëse.

Rastet prioritare

Në vijim është i paraqitur udhëzimi për rastet prioritare gjatë gjashtë muajve të fundit. Çështjet që kanë të bëjnë me qasjen dhe efektivitetin e mbrojtësit, si dhe shpërdorimit prokurorial dhe gjyqësor mbulojnë në kontekst të monitorimit të rasteve.

Krimet e luftës

Krimet e motivuara etnikisht

Krimet e motivuara politikisht

Krimi i organizuar

Dhuna seksuale përfshirë këtu edhe viktimat e dhunës familjare dhe të trafikimit të femrave.

Trajtimi i të miturve

Paraburgimi

Gjykimet në Gjykatat Komunale dhe Gjykatat për Kundërvajtje

OSBE, monitoron burgjet vetëm përkitazi me çështjet e “qasjes në drejtësi”. OSBE, nuk monitoron burgjet për çështjet e kushteve nëpër burgje apo të keqtrajtimit nëpër burgje meqenëse këto çështje janë të mbuluara nga zyrtarët e OSBE-së për të drejtat e njeriut dhe KNKK-së.

Që nga dhjetori 2001, OSBE gjithashtu ka filluar të monitoroj rastet civile – kryesisht rastet familjare – duke përcjellur shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut që kanë të bëjnë me çështjet diskriminimit dhe të drejtat e fëmijës. Rezultatet dhe të vërejturat të cilat rezultojnë nga ky dimenzion i ri i monitorimit do të raportohen në një raport tjetër tematik.

PJESA 2: LIGJI I APLIKUESHËM

ZHVILLIMET E THEKSUESHME NË LIGJIN E APLIKUESHËM

Gjatë gjashtë muajve të fundit, që nga shqyrtimi i fundit i OSBE mbi sistemin e gjyqësisë penale, disa zhvillime të theksueshme kanë ndodhur në ligjin e aplikueshëm, disa prej të cilave do ti shënojmë në vijim.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/20 Mbi Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve në Procedurën Penale, ka hyrë në fuqi më 20 shtator 2001, për të krijuar masa ligjore për ofrimin e mbrojtjes për palët e dëmtuara dhe dëshmitarët, për t'ju mundësuar atyre të marrin pjesë në procedurë penale pa frikë apo rrezik për sigurinë e tyre.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/21 Mbi Dëshmitarët Bashkë-Punues, ka hyrë në fuqi më 20 shtator 2001, me qëllim të krijimit të masave legjore për të nxitur dëshmitarët që të bashkëpunojnë me gjykata.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/22 Mbi Masat Kundër Krimit të Organizuar, e hyrë në fuqi më 20 shtator 2001, e njeh nevojën për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar në Kosovë dhe krijon mekanizma për ndjekjen dhe dënimin e kryesve të krimit të organizuar.

Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28 Mbi të Drejtat e Personave të Arrestuar nga Organet e Rendit Publik, kishte hyrë në fuqi më 11 tetor 2001 për të krijuar dhe mbrojtur të drejtat e personave të arrestuar nga autoritetet policore, përkatësisht Policia Civile e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (Policia e UNMIK-ut) dhe Shërbimi Policor i Kosovës.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/1, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut 2001/20 Mbi Mbrojtjen e Palëve të Dëmtuara dhe Dëshmitarëve në Procedurë Penale, e nënshkruar më 24 janar 2002, e zgjeron aplikueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/20 në procedurat penale të inicuar në mes të qershorit 1999 dhe datës së Rregullores në fjalë.

Rregullorja e UNMIK-ut 2002/2, që ndryshon Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/21 Mbi Dëshmitarët Bashkë-Punues, zgjeron aplikueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut 2001/21 në procedurat penale të inicuar në mes të 10 qershorit 1999 dhe datës së rregullores në fjalë.

Aplikueshmëria e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kosovë

Ndonëse aplikueshmëria e drejtpërdrejtë e standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në Kosovë ishte, në teori, e sqaruar me Kornizën Kushtetuese¹³, përpjekjet për të gjetur mekanizma praktik për implementimin e këtyre standardeve gjer më tani kanë qenë sporadike dhe jokonsistente. OSBE ka vërejtur se vetëm një numër i vogël i avokatëve mbrojtës kanë testuar aplikimin e garancave të të drejtave të njeriut nëpër gjykata, përderisa një numër edhe më i vogël i gjykatësve kanë tentuar t'i arsyetojnë vendimet apo veprimet e tyre në frymë të parimeve të instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe praktikës gjyqësore e cila i shoqëron ato¹⁴. Andaj, mbetet të shihet se a do të bëhen

¹³ Lexo *ante note* 11.

¹⁴ OSBE ka monitoruar gjatë periudhës së raportimit, vetëm një rast kur një zyrtarë gjyqësorë, prokurorë ndërkombëtarë nga Gjykata e Qarkut në Gjilan, arsyetoi një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë me garancat që parashihen me nenin 5 dhe 6 të KNDNj, dhe me praktikën relevante gjyqësore të Gjykatës Evropiane.

ligjet e të drejtave të njeriut pikënisje në zhvillimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, përmes promovimit të qëndrueshëm dhe iniciativave për rritjen e vetëdijësitimit, apo do të mbesin vetëm në nivel të qëllimeve politike.

OSBE gjithashtu është në pritje të legjislacionit e ri penal dhe procedural, pasi që kjo mund të ketë ndikim pozitiv mbi qartësinë dhe koherencën në aplikimin e dispozitave relevante ligjore në çështjet penale.¹⁵ Përgatitja e këtyre dy ligjeve kishte filluar në shtator të v.1999, pas kërkesës së PSSP, dhe procesi i hartimit të tyre, përfundoi në vjeshtë të v.2001.¹⁶ Hyrja në fuqi e këtyre dy ligjeve do të ishte një hap i madh në drejtim të një shoqërie moderne, demokratike në Kosovë, dhe të themeluar mbi parimet e sundimit të së drejtës dhe sigurisë ligjore.

II. ÇËSHTJET QË RRJEDHIN NGA SHQYRTIMET E MË PARSHME TË OSBE-SË

Hartimi dhe implementimi i ligjeve të reja

Që nga shqyrtimi i parë i OSBE-së mbi sistemin gjyqësor nga vera e v.2000, akoma ka mbetur si një prej problemeve kryesore, vetë mënyra e hartimit të ligjeve (rregulloreve) të reja si dhe implementimi i tyre në sistemin gjyqësor. Dy çështje qenësore ishin pararendëse. E para është, mungesa e konsultimeve dhe përdorimit të ekspertizës dhe resurseve në disponim, gjatë procesit të hartimit të legjislacionit të ri. Kjo rezulton në atë se ligjet e reja shpeshherë vështirë implementohen, nuk i përgjigjen sistemit ekzistues (për shkak të mungesës së konsultimit me praktikientë apo ekspertë tjerë), dhe çka është më me rëndësi, mund të cenoj standardet e të drejtave të njeriut, pasi që nuk ekziston një revizion nga aspekti i të drejtave të njeriut mbi legjislacionin e hartuar. Çështja e dytë është edhe ma konkrete – dhe ajo është se, ligjet e shkruara zakonisht hyjnë në fuqi menjëherë pas shpalljes, por në përgjithësi ato dalin vetëm në gjuhën angleze dhe më pastaj përkthehen ngadalë në gjuhën shqipe dhe atë serbe, dhe nuk shpërndahen. Kjo do të thotë se nga gjykatësit dhe profesionistë ligjor kërkohet të aplikojnë ligjin të cilin ata nuk e kuptojnë.

Përkundër mungesës së përparimit në këtë fushë, akoma nuk ekziston ndonjë kërkesë për PSSP të konsultohet me ndonjë organizatë apo institucion, para shpalljes së një rregulloreje. Edhe në rastet kur grupet punuese, të cilat zakonisht përbëhen prej ekspertësh, e dorëzojnë ndonjë propozim ligj, këto propozim ligje, përfundojnë në Zyren e Këshilltarit Juridik të PSSP (ZKJ), zakonisht për të qëndruar aty me muaj, derisa të paraqitet një verzion i cili mund të mos ngjajë shumë me origjinalin¹⁷. Kritika më e fortë dhe këmbëngulëse ndaj procesit të ligj-bërjes, që nga krijimi i UNMIK-ut më 1999, ishte mungesa e revizionit nga aspekti i të drejtave të njeriut në hartimin e ligjeve, që kishte rezultuar në atë që UNMIK-u vazhdimisht krijonte ligje të cilat shkelin standardet për të drejtat e njeriut. Për më tepër, UNMIK-u nuk ndërmerr asnjë hap tjetër për të përmirësuar këtë situatë edhe kur kjo theksohet veçanërisht.¹⁸ Përkundër kritikave të gjëra të kësaj procedure si nga brenda ashtu edhe jashtë KB,¹⁹ nuk

¹⁵ Projektet e Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale presin miratimin dhe shpalljen nga PSSP.

¹⁶ Prosesi i hartimit të dy ligjeve ishte rezultat i përpjekjeve të përbashkëta të Këshillit të Përbashkët Këshilldhënës për Çështje Legjislative (KPK), bashkë me ndihmën e ekspertëve ligjor ndërkombëtar dhe Kosovar.

¹⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/28 për të drejtat e personave të arrestuar nga organet e rendit publik, ka hy në fuqi me 12 tetor 2001. Prosesi i hartimit kishte filluar në vitin 2000, me grupin e hartuesve të përbërë nga OSBE, UNMIK, DAD dhe Policia e UNMIK-ut. Projekti i përgatitur nga ky grup megjithatë, ishte lënë anash dhe u formua një grup i ri duke mos përfshirë OSBE-në. OSBE-së dy herë ju dha mundësia për komente për projekt rregullorën e përgaditur nga grupi i dytë por siq shihet nga verzioni përfundimtarë i kësaj Rregulloreje shumë nga këto komente kurrë nuk janë marrë parasyshtë (*shih më tutje shënimi 17*).

¹⁸ Një çështje që u raportua në shqyrtimin e fundit ishte hartimi i asaj që më vonë u pagëzua Rregullorja nr. 2001/28, mbi personat e arrestuar nga organet e rendit publik. Përkundër shkeljes së qartë të ligjeve mbi të drejtat e njeriut, në nenin 3.7 të

është bërë asnjë përpjekje që të bëhet një revizion sistematik nga aspekti i të drejtave të njeriut në të gjitha propozim ligjet, për të lënë të hapur mundësinë që ligjet të hartohen në atë mënyrë ku ekspertët do të kishin mundësi të ndikojnë në verzionin final të propozim ligjeve.²⁰ Ky sistem duket se do të bëhet edhe më i komplikuar dhe konfuz, me Parlamentin, i cili sipas Kornizës Kushtetuese ka të drejtën e mxjerrjes së ligjeve, por me paqartësitë rreth asaj se, cilat ligje saktësisht do të vazhdojnë të nxirren ekskluzivisht nga PSSP.

Përkthimi dhe shpërndarja jo me kohë e rregulloreve të UNMIK-ut, është çështje tjetër mbi të cilin është fokusuar OSBE-ja në të gjitha raportet e saj paraprake. Rregulloret e UNMIK-ut në përgjithësi hyjnë në fuqi që në ditën kur ato nënshkruhen nga PSSP, por ato janë në dispozicion të menjëhershëm vetëm në gjuhën angleze, dhe nuk ka shpërndarje të shpejtë dhe sistematike për të gjithë personat brenda sistemit gjyqësor, për të përsëritur se, shumë pak apo fare, është përmirësuar gjatë dy viteve të fundit. Asnjë nga rregulloret e UNMIK-ut të miratuara në vitin 2002 nuk janë përkthyer në gjuhën shqipe apo serbe. Për rregulloret e miratuara në vitin 2001, procesi i përkthimit u ndal në Rregulloren e UNMIK-ut 2001/19 (nga gjithsejt 41 rregulloret e miratuara në vitin 2001). OSBE ka dokumentuar një numër situatash ku gjykatësit, prokurorët, avokatët dhe policia nuk ishin të vetëdijshëm mbi ndryshimet në ligjin e aplikueshëm, përmes rregulloreve të UNMIK-ut, sepse verzionet e përkthyer të këtij legjislacioni nuk ishin në dispozicion. Kjo situatë mbetet e papranueshme: legjislacioni që është i aplikueshëm por për të cilin nuk kanë njohuri zyrtarët gjyqësor të cilët janë të obliguar ta aplikojnë atë, mund të dëmtoj përpjekjet për ndërtimin e një mjedisi të sigurisë ligjore në Kosovë, prandaj mungesa e vëmendjes përkitazi me këtë çështje është veçanërisht zhgënjyese.

Kriminaliteti i trafikimit dhe përgjigjja e autoriteteve të UNMIK-ut

Përgjigjja e UNMIK-ut ndaj trafikimit me njerëz

Në shqyrtimin e fundit të sistemit gjyqësor penal, OSBE ka theksuar, shqetësimet strukturale përkitazi me trafikimin dhe kriminalitetin seksual²¹. OSBE ka mirëpritur zhvillimet pozitive në këtë lëmi, siq ishte, krijimi i Njësitit Hetimor për Prostitucion dhe Trafikim (NJHPT) brenda Policisë së UNMIK-ut. Krijimi i njësitit iu përgjigj shqetësimeve në rritje të cilat rrjedhnin nga eskalimi i trafikimit në Kosovë²², e që shihej si degë e veçantë e krimit të organizuar, andaj edhe kërkonte një qasje të dalluar dhe të pavarur të një pjesë të zyrtarëve policor. Për më tepër, NJHPT gjithashtu ka zhvilluar, në bashkëpunim të ngushtë me IOM-in the OSBE-në, një qasje koherente drejt viktimave të trafikimit. Ndihma e ofruar për viktimat e tilla u shëndrrua në një ndihmë procedurale të besueshme dhe të organizuar, në të cilin NJHPT vazhdimisht i referonte viktimat e caktuara në programin për riatdhesimit të themeluar nga IOM-i, përderisa vazhdonte t'ju ofronte mbrojtje dhe ndihmë atyre viktimave që ende ishin të involvuara në procesin gjyqësor. OSBE konsideron se karakteristikat dhe shkalla e trafikimit në Kosovë, nuk ka ndryshuar gjatë vitit të fundit²³. Andaj përgjigjja e Policisë së UNMIK-ut kundër këtij lloji të kriminalitetit duhet të vazhdojë bile edhe të përforcohet.

kësaj Rregulloreje (e cila lejon që të paraburgosurve t'u mohohet deri në 48 orë qasja në avokat mbrojtës), nuk janë bërë përpjekje që kjo të ndryshohet.

¹⁹ Lexo raportin e Jose-Maria Cutieliero, Raportuesit Special për ish-Jugosllavinë, 8 janar 2002, par. 92-94.

²⁰ Në janar 2002, ZPSSP e informoi OSBE-në se një mbikqyrje e tillë e të drejtave të njeriut mbi projekt ligjet duhet të vendoset, me pjesëmarrjen e OSBE në shqyrtimin dhe komentimin mbi të gjitha projektet e ligjeve për pajtueshmërinë me standardet e të drejtave të njeriut. Kjo mbikqyrje akoma nuk është implementuar.

²¹ Lexo shqyrtimi i tretë, pjesa 5

²² Krijimi i NJHPT erdhi pas hyrjes në fuqi të legjislacionit të ri për luftimin e trafikimit, respektivisht Rregullores së UNMIK-ut 2001/04 Për ndalimin e trafikimit me njerëz në Kosovë.

²³ Në raportin për situatën, shkurt 2000 - maj 2001, nga njesia luftimit të trafikimit të IOM-it, IOM-i vleron që prostitucioni me dhunë kishte ndodhur në së paku 33 bare në Kosovë. Në raportin për situatën, shkurt 2000 deri dhjetor 2001, IOM-i tha

Shqetësimet tjera përkitazi me përgjigjen e autoriteteve ndaj krimeve të trafikimit, kanë buruar nga vet monitorimi i gjykimeve gjegjëse. OSBE ka vërejtur se akoma gjykatësit dhe prokurorët vendës nuk e kuptojnë plotësisht kuptimin dhe implikimin e veprave të trafikimit, apo edhe rolin dhe pozitën e viktimave të trafikuar. Përkundër trajnimit tematik të organizuar nga IGJK, gjykatësit dhe prokurorët ende nuk arrijnë të vërejnë garancat dhe kërkesat e siguruara me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4 përkitazi me atë se si hetohen këto krime²⁴. Masat e përkohshme të marrjes së dobisë pasurore që rrjedhë nga kryerja e këtyre krimeve, mbyllja e objekteve dhe afarizmit të kundërligjshëm, janë aplikuar rrallë nga gjykatësit hetues. Edhe atëherë kur ato janë aplikuar, këto objekte janë rihapur shumë shpejt pas mbylljes në emër të pronarit tjetër dhe për një lloj “tjetër” të veprimtarisë, duke i plotësuar kushtet e autoriteteve të UNMIK-ut për dhënjen e lejeve të biznesit. Sa i përket procedurës gjyqësore, OSBE ka vërejtur se gjykatësit hetues vazhdojnë të mospërfillin garancat procedurale të rezervuara për mbrojtjen e viktimave/dëshmitarëve duke siguruar një ndjekje të suksesshme të kryesve. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/4 thotë se riatdhesimi i viktimave të trafikimit nuk mund të shtyhet për shkak të procedurës gjyqësore dhe, për atë shkak, gjykatësve hetues iu është bërë e ditur se dëgjimi i këtyre viktimave/dëshmitarëve duhet të mbahet menjëherë dhe në mënyrë të duhur, kështu që deklaratat mund të përdoren më vonë nga pala ndjekëse gjatë gjykimit. Një prej garancave kryesore që këta gjykatës duhet të kenë parasysh gjatë këtyre dëgjimeve, është prezenca e të pandehurit apo avokatit të tij mbrojtës, ashtu që, më vonë gjatë gjykimit, pala mbrojtëse nuk mund të ankohet se nuk është marrë parasysh e drejta marrjes në pyetje të dëshmitarit apo nuk është bërë vlerësimi i besueshmërisë së dëshmitarit.²⁵ Në vend të kësaj, OSBE gjatë gjashtë muajve të kaluar, ka monitoruar dështimet e përsëritura të gjykatësve hetues të involvuar në procedurën hetimore për rastet e trafikimit, për të siguruar prezencën e të dyshuarit apo mbrojtësit të tij/saj gjatë dëgjimit të viktimave/dëshmitarëve²⁶.

Shqetësim tjetër mbetet mungesa e objekteve të mbrojtjes së përkohshme të dëshmitarëve për viktimat e trafikimit – që janë të rrezikuara, të cilat japin deklarata në procesin gjyqësor. Rregullorja 2001/4 obligon që *“do të ndërmerren masa adekuate për mbrojtjen e dëshmitarëve gjatë çfarëdo hetimi dhe/apo procedure gjyqësore të ngritur sipas rregullores së tanishme.”* OSBE vazhdimisht ka ngritur këtë çështje brenda Policisë së UNMIK-ut por hap konkret në këtë drejtim ende nuk është ndërmarrë²⁷.

Dhuna seksuale

OSBE përshëndetë çdo iniciativë për krijimin e përgjigjes së specializuar policore ndaj rasteve të dhunës seksuale. Gjatë rrjedhës së raporteve paraprake të SMSL, OSBE ka vënë në pah nevojën e pasjes së një politike koherente lidhur me trajtimin e viktimave të dhunuara. Nevoja për një përgjigje konsistente dhe të rregulluar policore, ritheksohet përmes shembullit të memorandumit të cilit i është bashkangjitur protokoli regjional dhe i shkruar nga hetuesit e “Divizionit të Hetimeve Kriminalistike

se në bazë të Policisë së UNMIK-ut vleron se përafërsisht në 104 objekte në Kosovë gratë dhe femrat e reja janë shtyer në prostitucion.

²⁴ Njesia për ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave (NjNBV) përpreda DD-së shpalli, në një letër të dërguar OSBE-së me datën 16 Prill 2002, që trajnim i mëtutjeshëm në aplikimin e Rregullorës 2001/04 do të përgaditet dhe ti ofrohet Gjyqësisë vendore.

²⁵ Lexo nenin 333 LPP RFJ.

²⁶ Nga 12 rastet e trafikimit të monitoruara direkt nga SMSL në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë, që nga shtatori 2001 deri në shkurt 2002, në 6 raste, gjykatësit hetues para gjykimit morrën në pyetje viktimat/dëshmitarët pa prezencën e mbrojtësit të të akuzuarit.

²⁷ DD informoi OSBE-në, për mes letrës së 16 Prillit 2002, që NjNBV, NjHTP, dhe Njesiti për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (NjMD) janë duke punuar në një projekt të përbashkët për të themeluar një lehtësi emergjente tranzitore të dedikuar për viktimat e trafikimit, nuk është dhënë ndonjë afat kohorë për themelimin e kësaj lehtësie.

(DHK)”, të datës 31 tetor 2001. Në këtë memorandum thuhet: “Ajo që kam vërejtur është se vetëm disa prej dhunimeve të raportuara në të vërtetë janë të tilla. Shumica prej tyre janë, si duket, mendime të mëvonshme të femrave të cilat kishin pasur marrëdhënje seksuale me pajtimin e tyre dhe tani duhet të ballafaqohen me familjen. Siq e dini, në këtë kulturë, marrëdhënjet seksuale para-martesore janë të ndaluara, dhe i sjellin turp femrës dhe frikë nga represioni nga familja e saj. Ne, si Hetues të Paanshëm, duhet të hetojmë secilin rast dhe të nxjerrim përfundimin se çfarë, nëse fare, krimi është kryer dhe të raportojmë për faktet e rastit. Viktima apo familja e saj mund të jetë e pakënaqur por kjo nuk është çështje për të cilën ne duhet të brengosemi.” *Protokoli i bashkangjitur vazhdon me udhëzimet e dhëna hetuesve që të ofrojnë shembuj të dhunimeve dhe të mbledhin provat mjeko-ligjore vetëm “nëse hetuesit ndiejnë se ky nuk është rast i vërtetë i dhunimit me përdorim të forcës, ai do ta këshilloj viktimën dhe familjen për atë se çfarë beson dhe do t’ju shpjegoj se pse beson kështu.”*

Këto pikëpamje të shprehura nga hetuesit policorë të UNMIK-ut janë alarmuese. Një politikë e tillë e formës së shkruar nënkupton që hetuesit policor duhet të fillojnë prej prezumimit se raportimi i dhunimit është i rrejshëm dhe se pjesërisht, prova forenzike nuk është e domosdoshme të konstatoj të vërtetën e raportimit. Krijimi i njësitit të specializuar hetimor policor dhe një politike policore koherente dhe e centralizuar mbi dhunën seksuale, mund të ndihmoj për t’u siguruar se paragjykimet e tilla nuk do të ndikojnë në sjelljen e policisë ndaj viktimave të mundshme të dhunës seksuale. Ndonëse OSBE përshëndet krijimin e Njësitit Special të Viktimave/Dhunës Familjare për të ndihmuar në përgatitjen e përgjigjes senzitive për viktimat të tilla, Njësi ishte penguar nga mungesa e resurseve dhe nga ndërhyrja nga strukturat komanduese regjionale. Përkrahja më e fortë politike, resurset dhe inkuadrimi i këtij Njësi për të punuar ngushtë me hetuesit e specializuar të dhunës seksuale gjithashtu duhet të përmirësoj përgjigjen e policisë ndaj viktimave.

Mungesa e politikës së standardizuar policore përkitazi me viktimat e dhunimit dhe ekspertiza e specializuar brenda policisë, është njëra prej pjesëve përbërëse të dështimit të gjithëmbarshtëm për t’u përgjigjur çështjeve të dhunës seksuale. Me qëllim të adresimit të plotë të përgjigjes ndaj viktimave të dhunës seksuale, Seksioni i OSBE mbi Mbrojtjen dhe Përkrahjen e Viktimave kishte inicuar një grup punues, i cili involvonte Njësinë e Viktimave Speciale/Dhunës Familjare të Policisë së UNMIK-ut, SHPK, DD, Institutin e Mjekësisë Ligjore, dhe tani të krijuar mes tjerash, Zyren e Ekzaminuesve Mjekësor.

Krahas kësaj, në raportet paraprake të SMSL²⁸, OSBE ka theksuar shqetësimet e veçanta përkitazi me trajtimin nga gjykatat të fëmijëve viktimat të dhunës seksuale. Ky shqetësim është akoma prezent, pasi që vazhdojnë të paraqiten rastet në të cilat gjykatat i trajtojnë fëmijët viktimat/dëshmitarë si të jenë madhorë, pa pasur konsideratë për ndikimin e trajtimit të tillë në mirëqenjen psikologjike dhe emocionale të fëmijëve. Kjo edhe përkundër faktit se ligji vendës i procedurës penale lejon përdorimin e disa teknikave speciale përkitazi me marrjen në pyetje të fëmijëve dhe se gjykatat mund të përdorin standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut për të plotësuar çdo zbrazëti. Krahas kësaj, Rregullorja 2001/20 siguron përdorimin e masave mbrojtëse në gjykata të cilat mund të aplikohen për të mbrojtur fëmijët, siq janë, dëgjimet *in camera* me përjashtimin e publikut. Sidoqoftë, sipas Gazetës Zyrtare, kjo rregullore nuk është përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe²⁹.

²⁸ Lexo shqyrtimi i parë, pjesa 7, dhe shqyrtimi i dytë, pjesa 7 faqe 69-74

²⁹ Gazeta Zyrtare, e cila është në faqen e internetit të UNMIK-ut i ka vetëm 19 rregulloret e para të cilat janë miratuar në v. 2001 e që janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe.

Çështjet e përkthimit/interpretimit

Shërbimet e përkthimit/interpretimit nëpër gjykata në tërë Kosovën kanë vazhduar të jenë shkak i shqetësimit për OSBE-në, përkundër përpjekjeve të ndërmarra nga DD për të gjetur zgjidhje afat-gjate për këtë çështje. Në raportin e vet të fundit mbi sistemin penal gjyqësor, OSBE kishte rekomanduar themelimin e një trupi të përkthyesve në kuadër të DD-së, i cili do të jetë në gjendje të ofroj përkthim adekuat në të gjitha procedurat gjyqësore³⁰. Ky rekomandim ishte përcjellur nga DD, në kuptim që ishte krijuar një post brenda DD-së për një përkthyes të gjuhës rumune/ruse dhe angleze, i cili ishte paraparë të ofroj interpretim adekuat në procedurat përkitazi me rastet e trafikimit. OSBE e përshëndeti këtë iniciativë, por shqetësimet ende mbeten nga fakti se, edhe tre muaj pas publikimit të konkursit, vendi i punës ende nuk është plotësuar përkundër ekzistimit të disa aplikacioneve. Në ndërkohë, NJHTP dhe gjykatat ende po ballafaqohen me vështirësi të mëdha në gjetjen, *ad-hoc*, të përkthyesve për gjuhën ruse apo rumune, saherë që paraqiten hetimet për trafikim³¹. Përveq çështjes së interpretimit, OSCE gjithashtu shpreh shqetësimin përkitazi me cilësinë e përkthimit të ofruar gjatë procedurave gjyqësore, në të cilat janë përfshirë gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë. Shumica prej asistentëve/përkthyesve të caktuar për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë janë rekrutuar nga Shqipëria. Ka dallime të theksueshme në fjalor në mes të gjuhës shqipe të folur nga shqiptarët e Kosovës dhe asaj të folur nga shqiptarët, dhe rezultatet e monitorimit të gjykatave kanë treguar se këto diferenca nuk janë mënjanuar nga përkthyesit e lartpërmendur nga Shqipëria.³² Me moskuptimin e disa fjalëve dialektike të shqiptarëve të Kosovës, përdorimi i përkthyesve të tillë në procedurat gjyqësore kishte rezultuar në seanca gjyqësore të tejzgjatura dhe, disa herë, në ndërprerje të procedurës kur avokatët mbrojtës apo madje edhe anëtarët e publikut kontestuan fuqishëm cilësinë e përkthimit³³. OSBE konsideron se efektet e situatës së tillë, e cila përndryshe nuk ka mundur të parashihet nga DD gjatë punësimit të këtyre përkthyesve, mund të korrigjohet ashtu që atyre tu sigurohet, pas konsultimeve me ekspertin gjuhësor shqiptarë të Kosovës, një listë me shprehje vazhdimisht të përdorura në dialektin Kosovar. Zgjidhje tjetër e mundshme mund të ishte shmangja e përdorimit të këtyre përkthyesve në procedurat e hapura gjyqësore, ku janë paraqitur më së shumti ankesa; në vend të kësaj, ata mund të përdoren për përkthimet me shkrim të procesverbaleve gjyqësore apo dokumenteve të gjykatës.

Ekspertët gjyqësor dhe cilësia i ekspertizave forenzike

Refuzimi i ekspertëve gjyqësor për të ushtruar detyrat e tyre ligjore në procedurat penale, është bërë dukuri nëpër tërë gjykatat e Kosovës. Në të kaluarën, OSBE kishte veçuar rastet kur ekspertët forenzik dështuan ose të kryejnë raportet e urdhëruara nga gjykatat ose të paraqiteshin sipas thirrjes për të prezentuar raportet gjatë gjykimeve. Kjo praktikë ka vazhduar gjatë gjashtë muajve të fundit, dhe OSBE ka komentuar përkitazi me ndikimin që kjo ka në të drejtat e palëve të involvuara në procedurat gjyqësore,³⁴ (sikurse është e drejta për tu gjykuar brenda kufijve të arsyeshëm kohor,³⁵) dhe ndikimin e në zhvillimin e gjithëmbarshëm dhe rezultatit e gjykimeve penale. Nëse në mënyrë adekuate kjo nuk adresohet nga autoritetet e UNMIK-ut, gjykatat do të rezultojnë në shkelje serioze të garancave të të

³⁰ Lexo shqyrtimi i tretë, pjesa 5, rekomandimet, faqe 66

³¹ Në një letër të 16 Prillit 2002, DD informoi që arsyet e vonesës së regrutimit të një përkthyesi për gjuhën Rumune/Ruse/Angleze ishin procedura e ngadalsuar e UNMIK-ut për rekrutimin dhe problemet e identifikimit të një numri të mjaftueshëm të kandidatëve të kualifikuar për këtë pozitë.

³² Ankesat lidhur me përkthimin jo adekuat në gjykimet në të cilat janë angazhuar gjykatësit ndërkombëtarë dhe përkthyesit e tyre nga Shqipëria, janë dokumentuar nga OSBE në Prizren, Gjilan dhe Prishtinë.

³³ Në një rast të vrasjes të motivuar etnikisht e monitoruar nga OSBE në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, cilësia e përkthimit të bërë nga përkthyesi i gjykatës ka qenë subjekt i debatit gjatë seancave të përsëritura gjyqësore në janar dhe shkurt të 2002.

³⁴ Lexo Raportin Special të OSBE mbi Administrimin e Gjyqësisë.

³⁵ Lexo nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 14 KNDPC.

drejtave të njeriut për gjykim korrekt dhe procedurë të drejtë.³⁶ Më tej, kjo do të dobësoj autoritetin e gjyqësisë për të ekzekutuar vendimet e veta dhe për të fituar ndihmë të duhur nga zyrtarët dhe departamentet që janë parashikuar për të forcuar administrimin e drejtësisë.

III. ZHVILLIMET BRENDA SISTEMIT GJYQËSOR DHE STATUSI I IMPLEMENTIMIT TË REKOMANDIMEVE TË OSBE-SË

Seksionet e specializuara brenda DD

Nga këto Seksione të specializuara, Njësiti i Mbrojtjes dhe Ndhmës Viktimave (NJMNV) ishte krijuar si rezultat i rekomandimeve të OSBE-së, që i kishte bërë DD, I lidhur me rregullat brendshme të vendimeve duke theksuar nevojën për të përmirësuar qasjen në drejtësi për të gjitha viktimat e krimit. NJMNV është parashikuar që të krijohet në një autoritet të qëndrueshëm të pavarur qeveritar për viktima të krimit, duke marrur për sipër rolin koordinues dhe të krijimit të politikës, përfshirë edhe trajnimin dhe krijimin e rrjetit të avokuesve të viktimave dhe një përgjigjëje emergjente dhe sistem të referimit përndihmën e viktimave të krimit. . Si pjesë e këtij mandati, NJMNV do të ketë Koordinatorin e Ndhmës Viktimave të krijuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4 dhe do të implementoj aspektet e ndihmës për viktimat sipas kësaj Rregulloreje. NJMNV tashmë ka krijuar kontakte me organizatat dhe institucionet tjera që u ndihmojnë viktimave, ka kërkuar mjete dhe ka marrë pjesë në shumë aktivitete aktuale përkitazi me përforcimin e përgjigjes ndaj viktimave të rrezikuara të krimit. Seksioni i Mbrojtjes së Viktimave dhe Përkrahjes i OSBE-së, e mbështet NJMNV-në me resurse përfshirë këtu edhe kuadrin, siq është, Koordinatorin e Ndhmës Viktimave.

Seksioni i tjetër i specializuar brenda DD që OSBE pret se do të ketë ndikim pozitiv mbi zhvillimin e sistemit gjyqësor në Kosovë është Seksioni i Integritimit Gjyqësor (SIGJ). OSBE ka rekomanduar në rastet e mëparshme nevojën për përpjekje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për të krijuar një gjyqësi multietnike në Kosovë, dhe gjithashtu për të siguruar qasje të barabartë dhe efektive në gjyqësi për anëtarët e komuniteteve minoritare.³⁷ Shumica e shqetësimeve të shprehura nga OSBE në lidhje me çështjet e përmendura më lart biejnë nën mandatin e SIGJ dhe, andaj, OSBE e përshëndet themelimin e tij dhe mbështet bashkëpunimin e ngushtë me të.

Instituti Gjyqësor i Kosovës

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) ka vazhduar programin e tij për edukimin ligjor për gjykatës që aktualisht punojnë në gjykatat dhe zyrat e prokurorisë së Kosovës. Seminaret dhe seancat informative ishin mbajtur lidhur me çështje të ndryshme, siq është edhe legjislacioni i ri mbi posedimin e armëve, ligji mbi procedurën penale, Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë i Kosovës, raportet në mes të prokurorit publik, gjykatësve hetues dhe organeve të rendit publik, dhe rregullat kundër korrupsionit. Një seminar mbi procedurën e ekstradimit, si nga perspektiva teorike ashtu edhe nga ajo praktike, ishte mbajtur në dhjetor të v.2001 dhe më vonë ishte përsëritur sipas kërkesës së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë në janar të v.2002. Trajnimi i ri mbi aplikimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 ishte organizuar nga IGJK në shkurt të v.2002, dhe, për dallim nga trajnimet fillestare mbi këto çështje, ai u ofronte pjesëmarrësve një analizë shumë të fokusuar të të gjitha aspekteve praktike që mund të shfaqen nga aplikimi i rregullores.

³⁶ Lexo pjesën V të këtij shqyrtimi.

³⁷ Lexo, Raportin Special të OSBE mbi Administrimin e Gjyqësisë.

Në raportin e fundit, OSBE rekomandoi implementimin, brenda planprogramit të IGJK, e seancave trajnuese për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë të sapo ardhur³⁸. Qëllimi i seancave të tilla do të ishte që këtyre zyrtarëve gjyqësor, t'ju ofrohete një pasqyrë e përgjithshme e sistemit ligjor në Kosovë, dhe gjithashtu me problemet praktike potenciale të cilat ata mund t'i hasin gjatë ushtrimit të funksionit të tyre. IGJK tashmë ka filluar hartimin e planprogramit përkatës për kurse të tilla njoftuese, dhe programi fillestar do të mbahet në Qershor të v.2002, në bashkëpunim me DD UNMIK.

Njësitit i Inspektionit Gjyqësor dhe Këshilli Gjyqësor dhe i Prokurorisë të Kosovës

Themelimi i Njësitit për Inspektionin Gjyqësor (NJIGJ) brenda DD dhe, më vonë, i Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë të Kosovës (KGJPK), ishin mirëpritur nga OSBE si mekanizëma të paraparë për të forcimin e përgjegjësis gjyqësore duke përcjellur gjithashtu edhe pavarësinë gjyqësore. NJIGJ deri më tani ka arritur të kryej detyrat e veta me një numër të kufizuar të inspektorëve gjyqësor, si ndërkombëtar ashtu edhe vendës. Me qëllim që proceset e veta t'i bën më transparente dhe përgjegjëse, NJIGJ kohëve të fundit ka themeluar një procedurë të brendshme që kërkon lëshimin e një përgjegje zyrtare ndaj të gjithë parathuesve të ankesave të pranuar pranë njësitit, pa marrë parasysh se a janë zhvilluar hetimet apo jo. Që nga fundi I Dhjetorit v.2002, NJIGJ ka bërë hetimet e 73 rasteve të shpërdorimit të mundshëm gjyqësor; në 29 nga këto raste raportimet për shpërdorimin janë gjetur të pa bazuara dhe, rrjedhimisht janë ndërprerë, përderi sa në 44 rastet tjera vlerësimet preliminare tërhoqën vërejtje për hetime të më tutjeshme dhe më të detajizuara.

Sa i përket KGJPK-së, OSBE, në raportet paraprake, ka lëshuar një vlerësim preliminar për dobitë që një organ i tillë do të kishte për gjyqësinë Kosovare³⁹. Në shumë drejtime, KGJPK ka filluar ta përmbushë misionin e tij.

Që nga janari i v.2002, KGJPK kishte shikuar në 16 nga rastet e parashtruara nga NJIGJ, nga të cilat 13 prej tyre iu nënshtruan procedurës disiplinore, dhe 3 ishin parashtruar vetëm për shqyrtim. Gjithësejt, 20 gjykatës dhe prokuror i janë nënshtruar procedurës para KGJPK. Këshilli kishte gjykuar 10 raste, nga të cilat 6 raste rezultuan me vendimin për largimin nga detyra - vendim i marrë nga PSSP sipas propozimit të Këshillit - dhe dy raste përfunduan me vendimet për qortim dhe vërejtje. Në dy raste Këshilli nuk kishte konstatuar shpërdorim dhe si pasojë kishte ndërprerë procedurën disiplinore.

Megjithate, janë disa aspekte të caktuara organizative brenda strukturës dhe fushëveprimit operativ të KGJPK që vazhdojnë të ngrisin shqetësime; këto shqetësime do të adresohen më vonë në këtë raport në lidhje me çështjen e pavarësisë së gjykatave.

Instituti Forenzik

Zyra e Ekzaminuesit Mjekësor ishte krijuar në Seksionin e Operacioneve Forenzike të Divizionit të Zhvillimit Gjyqësor të DD. Si rezultat i këtij zhvillimi, çështja e statusit të Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe mjekët e tij të lidhur me Univerzitetin dhe Spitalin, mbetet e paqartë. Edhe pse se Instituti i Mjekësisë Ligjore duket se është i vetmi ka përgjegjësinë për sigurimin e ekzaminimeve të dhunimeve, ekzaminimet e tilla bëhen në teren nga personeli mjekësor i patrajnuar. Me qëllim të përmbushjes së nevojave të viktimës, poashtu edhe të policisë, duket se është i domosdoshëm, trajnimi i personelit mjekësor në tërë Kosovën për ofrimin e ekzaminimeve efektive dhe senzitive. Mungesa e qartësisë mbi

³⁸ Lexo, shqyrtimi i tretë, pjesa 2, faqe 16.

³⁹ Lexo, shqyrtimi i tretë, pjesa 2, faqe 17,

ardhmërinë e shërbimeve forenzike mjekësore në Kosovë përfaqëson një pengesë të konsiderueshme për zhvillimin e protokoleve koherente për ekzaminimin dhe trajtimin e viktimeve të dhunimeve dhe për fillimin e trajnimit të personelit mjekësor në teren për kryerjen e ekzaminimeve të tilla.

Implementimi i Rekomandimeve të OSBE

Siq u përmend në kuadër të këtij raporti, qasja e OSBE-së drejt shqetësimeve që ajo identifikon është që gjithmonë të paraqesë rekomandime konkrete, me qëllim të ndihmës së strukturave tjera brenda UNMIK-ut, përgjegjëse për adresimin praktik të këtyre shqetësimeve. Pas shqyrtimit të parë të sistemit penal gjyqësor të OSBE, ish-Departamenti Administrativ i Drejtësisë (DAD)⁴⁰ dhe OSBE themeluan një grup punues, i cili kishte për detyrë të analizoj rekomandimet e bëra në atë shqyrtim dhe për t'i parashtruar projekt-propozimet autoriteteve relevante për implementimin e të njëjtave. Aktivitei i këtij grupi u ndërpre pas vetëm disa takimeve dhe nuk vazhdoi më kurrë.

Pas shqyrtimit të dytë të sistemit penal gjyqësor, nga OSBE-ja ishte kërkuar të hartoj një dokument të Strategjisë për Drejtësi, duke përmbledhur rekomandimet e bëra në shqyrtim, dhe duke i kornizuar ato në struktura të qëndrueshme dhe të realizueshme. Për më tepër, me themelimin e Shtyllës së I të Policisë dhe Gjyqësisë, OSBE ishte ri-siguruar se do të themeloheshin mekanizmat e ri për implementimin e rekomandimeve të saj përkritazi me çështjet gjyqësore dhe legjislativ. Megjithate, Strategjia për Drejtësi e OSBE-së, asnjëherë nuk ishte shqyrtuar nga Shtylla I si bazë për reformimin e sistemit gjyqësor në Kosovë. Gjithashtu, OSBE nuk ishte bërë anëtare e strukturës kryesore këshilldhënëse dhe të krijimit të politikave të Shtyllës I, - Bordit Udhëheqës. Në vend të kësaj OSBE-së i është dhënë vendi në tre nga gjashtë kolegjet e themeluara nga Shtylla I-rë për të zhvilluar punët në fushat më kryesore të interesit, siq janë, policia, çështjet gjyqësore, dhe zhvillimi legjislativ.

Ndonëse i dizajnuar në mënyrë joefektive për të implementuar rekomandimet e bëra, OSBE mirëpriti, në shqyrtimin e tretë të sistemit penal gjyqësor⁴¹, vendosjen e kolegjeve të Shtyllës së I-rë, të cilat OSBE i konsideron të jenë bazë punuese për adresimin e çështjeve më të rëndësishme që kanë të bëjnë me aktivitetin e gjyqësisë. Për më tepër, OSBE kishte pritur që prezenca e saj në kolegjin e zhvillimit legjislativ do të ofroj mundësinë e vuarjes në disponim të ekspertizës së OSBE-së në çështjet e të drejtave të njeriut, gjatë procesit të hartimit të ligjeve. Fatkeqësisht, kolegjet përbrenda Shtyllës I ishin shuar dhe asnjë kornizë tjetër konsultimi dhe bashkëpunimi nuk është vendosur që nga ajo kohë.

⁴⁰ Departamenti i Drejtësisë (DD) kishte qenë, brenda kornizë së re të shtyllës së I-rë të UNMIK-ut, pasardhës i Departamentit Administrativ të Drejtësisë (DAD).

⁴¹ Lexo shqyrtimi i tretë, pjesa 2, faqe 18.

PJESA 3: PAVARËSIA E GJYQËSISË

I. HYRJE

Parimi i pavarësisë së gjyqësisë duket se gëzon njohje univerzale në secilin sistem juridik kombëtarë. Për më tepër, instrumentet regjionale për të drejtat e njeriut kanë theksuar garancën e gjykatave të pavarura dhe të paanshme si elemente esenciale e të drejtës për gjykim korrekt. Në këtë drejtim, neni 6(1) KEDNJ thotë se *secili ka të drejtë në gjykim korrekt dhe publik brenda një afati të arsyeshëm kohor nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e themeluar me ligj*, dhe neni 14 (1) KNDCP përdorë një formulim gati të njëjtë për të definuar të drejtën e individit që të gjykohet nga një gjykatë kompetente, e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj.

Përkundër të qenurit i pranuar dhe i rregulluar thuajse univerzalisht, parimi i pavarësisë së gjyqësisë ka qenë objekt i kontesteve të vazhdueshme juridike nëpër gjykatat kombëtare dhe organet e ndryshme ndërkombëtare të cilat aplikojnë instrumentet regjionale të të drejtave të njeriut, sikurse është Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe Gjykata Ndër-Amerikane për të Drejtat e Njeriut.⁴² Për më tepër, Komisioni për të Drejtat e Njeriut të KB, që nga 1985, kishte emëruar tre Raportues Special për pavarësinë e gjyqësisë; kjo demonstroi interesin e bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin e politikave dhe praktikave të shteteve anëtare përkritazi me pavarësinë e gjyqësisë, si dhe interesimin e saj në implementimin e legjislacionit efektiv dhe garancave strukturale të domosdoshme për realizimin e standardeve të dëshiruara të pavarësisë dhe paanshmërisë në kuadër të të gjitha organeve gjyqësore.

Debatimi mbi pavarësinë e gjyqësisë nuk rrjedh nga definicioni i parimit, por më tepër nga implikimet praktike të saj. Në kuadër të kornizës së gjërë të bashkëpunimit ndërkombëtar në promovimin dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive fundamentale të njeriut, duhet të artikulohen konceptet bazike dhe praktike me qëllim të asistimit të qeverive në detyrat e implementimit të rregullave dhe udhëzimeve të përbashkëta, të cilat sigurojnë pavarësinë gjyqësore në kuadër të legjislacioneve të tyre vendëse. Në vendosjen e këtyre koncepteve themelore, parimi i pavarësisë së gjykatave ishte zbrëthyer në “nënparime” sipas shqetësimeve dhe çështjeve të ndryshme praktike të cilat janë shfaqur në kontestet juridike në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Kongresi i Shtatë i Kombeve të Bashkuara mbi Parandalimin e Krimit dhe mbi Trajtimin e Kryesve, e mbajtur në Milano në gusht/shtator të v.1985, ka miratuar “Parimet Themelore të Pavarësisë së Gjyqësisë” në përpjekje që t’ju ofroj gjykatësve udhëzime të duhura përkritazi me rolin e tyre në sistemin gjyqësor, dhe të vendosë rregullat specifike përkritazi me ushtrimin e funksioneve gjyqësore në pajtim me garancat e gjykimit korrekt, prezumimin e pafajësisë, dhe barazisë para ligjit.⁴³ Dokumenti vendosi një sërë standardesh përkritazi me raportet e gjyqësisë ndaj autoriteteve tjera shtetërore, dhe, më specifikisht, për selektimin, emërimin dhe trajnimin e zyrtarëve gjyqësor, kushteve të shërbimit të tyre dhe kohëzgjatjes, sekretit profesional, imunitetit, dhe suspendimit dhe largimit nga detyra. Ndërhyrja ekzekutive në çështjet gjyqësore, në formë të instruksioneve dhënë gjykatësve apo interpretimit të legjislacionit ekzistues posaçërisht ishte konsideruar të ketë efekt dëmtes mbi punën e pavarur të gjyqësisë.

Duke u nisur nga njohja teorike e parimit të pavarësisë dhe nënparimeve të tij specifike, ky raport përqëndrohet në shtrierjen aktuale të pavarësisë së sistemit të gjyqësisë penale në Kosovë. Ky raport do

⁴² Për një rishikim më të gjërësishëm të praktikës gjyqësore dhe debatit ligjor mbi çështjet e pavarësisë gjyqësore në vende të ndryshme, *lexo* raportet e Komisionit të KB për të drejtat e njeriut e përpiluar nga Raportuesi Special mbi pavarësinë e Gjykatësve dhe Avokatëve.

⁴³ Lexo Preambulën e Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjykatave.

të analizoj garancat e pavarësisë së gjyqësisë ekzistuese në kuadër të strukturës së UNMIK-ut, dhe do ta shqyrtoj pavarësinë gjyqësore nga perspektiva e dy koncepteve të saj themelore: pavarësia institucionale dhe pavarësia funksionale. Pavarësia në kuptimin institucional kërkon që gjyqësia të përbëhet nga zyrtarë, emërimi, ushtrimi i detyrës dhe përgjegjësia disiplinore e të cilëve gëzon autonomi institucionale efektive në krahasim me degët tjera të pushtetit. Në anën tjetër, pavarësia në kuptimin funksional nënkupton mospërzierjen e organeve jashtëgjyqësore në ushtrimin e funksioneve gjyqësore, dhe ajo gjithashtu përfshin obligimin e shtetit për të mbrojtur punën e pavarur të gjykatave dhe, kuptohet, pavarësinë personale të gjykatësve.

Të dy konceptet e përmendura më lart do të shqyrtohen në relacion me pavarësinë e zyrtarëve ndërkombëtarë gjyqësor në ushtrimin e funksioneve të tyre sipas dispozitave të përkohshme dhe të jashtëzakonshme të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64⁴⁴ dhe gjithashtu përkitazi me strukturën gjyqësore ekzistuese dhe funksionale sipas sistemit të rregullt gjyqësor.

II. PAVARËSIA INSTITUCIONALE/ORGANIZATIVE

Pavarësia e gjyqësisë në kuptimin institucional të saj, do të thotë se, funksionet ekskluzive të gjyqësisë ushtrohen nga bartësit e funksioneve të cilët gëzojnë garanca të gjëra dhe të definuara mirë, përkitazi me emërimin dhe largimin nga funksioni, përgjegjësinë disiplinore, dhe rregullat e caktimit të lëndëve.

Emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve

Sa i përket procedurës së selektimit gjyqësor, sistemet e ndryshme ligjore ofrojnë modele të ndryshme, duke filluar nga zgjedhja e drejtpërdrejtë nga njerëzit e deri te emërimet nga parlamenti apo qeveria. Pa marrë parasysh se cila procedurë përdoret, është me rëndësi që zyrtarët gjyqësor të jenë të pavarur nga organi apo personi i cili i zgjedh apo i emëron ata.

Në kuptim të procedurës së emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve në sistemin gjyqësor të Kosovës, mekanizmi i përdorur për zyrtarët ndërkombëtarë është i ndryshëm nga ai që përdoret për zyrtarët vendës gjyqësor. Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë në mënyrë të drejtpërdrejtë rekrutohen dhe lidhin kontrata me UNMIK-un brenda rregullave të punësimit të rregullt në KB, përderisa gjyqësia vendëse, deri më tani, ishte emëruar në detyrë për periudha njëvjeqare me mundësi të zgjatjes.

Ndonëse ende e pa definuar në një Rregullore të UNMIK-ut, DD ka bërë të ditur se duke filluar nga ky vit, gjykatësit dhe prokurorët vendës do të emërohen për kohë të pacaktuar e cila do të skadojë pas përfundimit të misionit të UNMIK-ut në Kosovë. Kjo procedurë e re, e ndryshon sistemin e kontratave të afatizuara me mundësi të zgjatjes, ashtu siq ishte emëruar gjyqësia vendëse që nga viti 1999. OSBE e shikon këtë zhvillim si hap pozitiv drejt forcimit të pavarësisë institucionale të gjykatësve dhe prokurorëve vendës.

Sa i përket zyrtarëve ndërkombëtarë, OSBE për një kohë të gjatë kishte shqetësime se statusi i tyre si të punësuar civil brenda UNMIK-ut ndikon mbi natyrën e pavarësisë së funksioneve të tyre. Gjykata Evropiane ka mbajtur qëndrimin se nominimi për funksionet gjyqësore, i bërë vetëm nga qeveria vetvetiu nuk ndikon mbi pavarësinë e gjykatave; ajo që është vendimtare është që të mos ketë çfarëdo kontrolli apo mbikqyrjeje nga ekzekutivi pas nominimit. Në këtë drejtim, periudha shumë e shkurtë

⁴⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 mbi emërimin e gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe ndrrimin e vendgjykimit, i hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2000.

kontraktuese për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë⁴⁵, dhe fakti se secila zgjatje e këtyre kontratave varet ekskluzivisht nga degët ekzekutive të UNMIK-ut –DD-së dhe, përfundimisht, PSSP-së – krijon një përshtypje të ekzistimit të kontrollit mbi këta zyrtarë. Vetë teksti i konkursit të fundit i shpallur nga UNMIK-u për pozitat e lira për gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë në Kosovë, është ilustrim i mbikqyrjes ekzekutive mbi këta zyrtarë: *nën mbikqyrjen e gjithëmbarshme të Zëvendësit të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për Polici dhe Drejtës, të Departamentit për Çështje Juridike, kandidati shërben si gjykatës ndërkombëtarë [...]*.⁴⁶

Sërish, vlenë të përmendet se pavarësia e gjykatave në kuptimin institucional, kryesisht ka për qëllim që të siguroj dukjen e pavarësisë kundër çfarëdo dyshimi të influencës së jashtme. Komisioni Evropian mbi të Drejtat e Njeriut ka deklaruar se me qëllim të përcaktimit se a mund të konsiderohet një organ gjyqësor i pavarur, duhet të merret parasysh, *inter alia*, mënyra e emërimit të anëtarëve dhe kohëzgjatja e mandatit, ekzistimi i garancave kundër presioneve të jashtme, si dhe çështja se a duket të jetë ky organ i pavarur. Komisioni shkoi më larg, duke thënë se – nuk është relevante nëse janë shfaqur ndikimet nga burimet e jashtme apo ndonjë njëanshmëri; ajo çka është relevante në ekzaminimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së një gjykate është, që dukja e saj duhet të merret parasysh.⁴⁷

Në raportin e datës 13 janar të v.1999,⁴⁸ Raportuesi Special i KB mbi pavarësinë e gjykatësve dhe avokatëve, përshëndeti vendimin e Gjykatës Supreme të Norvegjisë në rastin kur kishte marrë qëndrimin se gjykatësit e emëruar përkohësisht, të cilët nuk kanë mbrojtje të njëjtë sa i përket mandatit të tyre, sikur që e kanë gjykatësit e emëruar për mandat të përhershëm, nuk kanë kompetenca për të gjykuar kontestet në të cilat shteti apo ndonjë prej organeve të tij, ishin palë në kontest (çka do të përfshinte të gjitha veprat penale). Më tej ishte theksuar se gjykatat garantojnë sundimin e ligjit për qytetarët në raportet e tyre me pushtetin legjislativ apo ekzekutiv dhe, pasi që shteti është palë në një numër të konsiderueshëm rastesh, është veçanërisht me rëndësi që publiku të ketë besim të plotë në gjykatësin individual gjatë marrjes së vendimit të tij apo saj pa pasur parasysh ndonjë pasojë negative për pozitën e tij apo saj.⁴⁹

Vlen gjithashtu të përmendet se, sa i përket gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, rekrutimi në KB, emërimi dhe zgjatja e kontratave, varen gjithashtu nga negociatat me autoritetet përkatëse të shteteve të gjykatësve dhe prokurorëve nga të cilat vijnë. Kjo e shton edhe një element të pasigurisë për çështjen e kohëzgjatjes së mandatit të këtyre zyrtarëve gjyqësor në Kosovë, që e bën edhe më të komplikuar lejimin e kontratave më afatgjata apo të parashikohet prania e tyre vetëm në bazë të kryerjes profesionale të profesionit të tyre.

Si konkluzion, procedura dhe kushtet e tanishme për emërimin posaqërisht të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë, nuk janë në pajtim me parimet standarde të pavarësisë gjyqësore. Siguria e kohëzgjatjes së mandatit për gjyqësinë vendore është adresuar nga ri-emrimi I fundit në afat të pa caktuar . Sa i përket zyrtarëve gjyqësor ndërkombëtarë, cilësia e tyre si gjykatës dhe prokurorë dhe fakti se ata janë, teknikisht, të punësuar të rregullt të KB, paraqesin dy koncepte të cilat vështirë që mund të pajtohen. Korniza juridike e kontratave standarde të KB, nuk lejon nivelin e pavarësisë institucionale e cila duhet të jetë karakteristikë për secilin anëtar të gjyqësisë.

⁴⁵ Kontrata standarde për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë është për 6 muaj me të drejtë të rizgjatjes së kontratës.

⁴⁶ Teksti i konkursit është rishikuar siq është gjetur në faqen e internetit të UNMIK-ut.

⁴⁷ Lexo Raportin e Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut , Kompania B v. Holanda, 19 maj 1994.

⁴⁸ Raporti i Raportuesit Special mbi Pavarësinë e Gjykatësve dhe Avokatëve, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, 13 janar 1999.

⁴⁹ Lexo *Jens Viktor Plabte v. Shteti*, Gjykata Supreme e Norvegjisë, dhjetor 1997, siq është rishikuar në raportin e Raportuesit Special mbi pavarësinë e gjykatësve dhe avokatëve, 13 janar 1999.

Emërimi i gjykatësve dhe prokurorëve dhe ndarja e lëndëve

Emërimi sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64

Përpos çështjes së procedurës së emërimit të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar dhe çështjes se a e dëmton kjo procedurë pavarësinë gjyqësore apo jo, mekanizmi i ndarjes së lëndëve për këta zyrtarë, siç parashihet edhe me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64, shkakton shqetësime në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë strukturale të gjyqësisë.

Më 15 dhjetor 2000, PSSP-ja nxjerri Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64 mbi *Emërimin e Gjykatësve/Prokurorëve Ndërkombëtar dhe/ose Ndryshimin e Vendit*. Nga preambula e rregullores, shihet qartë se fushëveprimi i saj është i ndërlidhur ngushtë me çështjet e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore.⁵⁰ Në nenin 1, rregullorja parasheh se prokurori kompetent, i akuzuari, apo avokati munden, në çdo fazë të procedurës penale, të parashtrajnë kërkesë pranë DD-it (ish DAD) për caktimin e kolegjit të gjykatësve, gjykatësit hetues apo prokurorit publik, nëse një gjë e tillë konsiderohet si e domosdoshme për sigurimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësisë dhe administrimit të duhur të drejtësisë. Në pajtim me këtë kërkesë dhe gjithashtu me propozimin e tij, DD-i mund t'i bëjë rekomandime PSSP-së i cili, pas shqyrtimit të saj, do të aprovoj apo refuzoj një emërim të tillë.

Edhe pse një gjë e tillë kishte për qëllim që të eliminoj animet të cilat paraqiten në rastet e ndjeshme me motive etnike dhe politike, rregullorja arriti që të formoj një mekanizëm paralel për ndarjen e lëndëve gjykatësve përkatës, varësia e së cilit nga DAD-i dhe PSSP-ja nuk është në pajtim me standartet përkatëse ndërkombëtare që kanë të bëjnë me pavarësinë institucionale. Rregullorja krijon një mekanizëm dukshëm më të pavarur për parashtrimin e aplikacioneve, e cila iu jep mundësi palëve që në çfarëdo faze të procedurës penale të kërkojnë caktimin e prokurorit ndërkombëtar, gjykatësit hetues dhe kolegjit të gjykatësve për një lëndë përkatëse. Megjithatë, procesi i aplikimit ende mbetet nën hijen e vendimit përfundimtar të PSSP dhe , respektivisht DAD Mekanizimi për iniciimin e aplikimit të procedurës, siq është e paraparë me Rregullore, gjithashtu I mungon kjo qartësi dhe përgjegjësi. Rregullorja nuk kërkon mendim me shkrim për vendimi e DAD për të rekomanduar apo të mos rekomandoj një rast të PSSP, përderisa, vendimi I PSSP për të aplikuar këtë Rregullore në një rast specifik gjithashtu nuk shoqërohet me ndonjë arsytim juridik.

Kur të flasim për ndarjen e lëndëve një gjykatësi individual apo tërë kolegjit, sistemet e ndryshme gjyqësore përdorin mekanizma të ndryshëm për të realizuar një gjë të tillë. Sidoqoftë, karakteristikë e përbashkët e të gjitha sistemeve, që garanton pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë, është se rastet caktohen rastësisht, dhe se asnjëra palë, organ, apo trup ekzekutiv nuk mund të ndërhyjë duke i ndarë një lëndë përkatëse një gjykatësi apo kolegji të caktuar të gjykatësve. Ligji përkatës në Kosovë parasheh se orari për të gjithë gjykatësit caktohet paraprakisht, dhe se rastet caktohen dhe futen në orar në bazë të regjistrimit dhe numrit serik të tyre.⁵¹ Propozimi i Ligjit mbi Punën e Gjykatave që pritet të nxirret në vetë Serbi në nenin e tetë të saj parasheh se “*çdo njeri do të ketë të drejtë në gjykim të udhëhequr nga gjykatësit e zgjedhur rastësisht, pa pasur lidhje me palët dhe natyrën e çështjes ligjore*”. Sistemi për caktimin e rastësishëm të lëndëve përdoret nga gjykatat vendore si çështje rutinore, duke mos lënë hapësirë për shqetësim në lidhje me ndonjë ndërhyrje nga jashtë në pavarësinë e gjykatave.

⁵⁰ Preambula thotë se “duke pranuar se prezenca e kërcnimeve të sigurisë mund të minoj pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësisë dhe mund të pengoj aftësinë e gjyqësisë për të ndjekur në mënyrë të duhur krimet të cilat rëndë minojnë procesin paqësor dhe vendosjen e plotë të sundimit të ligjit në Kosovë [...]”.

⁵¹ Nenet 44-47 të Librit të Rregullave mbi Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave, Gazeta Zyrtare nr. 7/81.

Megjithatë, gjykatësit dhe kolegjet e gjykatësve të caktuar në lëndët sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 nuk gëzojnë garanca të njëjta kur kemi të bëjmë me mënyrën e ndarjes së lëndëve për ta. Pasi që DAD-i rekomandon edhe PSSP-ja konsideron se lënda përkatëse duhet të udhëhiqet nga një gjykatës ndërkombëtar apo trup gjykues i përbërë nga gjykatësit ndërkombëtar, lënda nuk caktohet as në mënyrë të rastësishme e as në bazë të një sistemi të formuar paraprakisht enkas për një gjë të tillë. Në vend të kësaj, DAD-i paraqet të vetmin subjekt i cili vendos se cilat raste i ndahen cilit trup gjykues, gjë që në këtë mënyrë i jipet DAD-it mundësi që t'i zgjedh gjykatësit në pajtim me interesat e ekzekutivit në lëndët përkatëse. Parimi 14 i *Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjykatave* parasheh se caktimi i lëndëve gjykatësve në kuadër të gjykatës të cilës ata i përkasin është qështje e brendshme e administratës gjyqësore të asaj gjykate.. Sërish, brengat e OSBE-së të theksuara më lart nuk nënkuptojnë se DD-ja iu përmbahet interesave jashtë-gjyqësore gjatë caktimit të lëndëve zyrtarëve ndërkombëtarë. Shqetësimet e shprehura nga OSBE-ja janë të ndërlidhura me efektin e mundshëm dëmtes që mekanizmat për caktimin e lëndëve sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 mund të kenë në procesin e pavarur gjyqësor, proces ky cili është mëse i nevojshëm për të pasur një sistem gjyqësor të besueshëm dhe funksional.

Mungesa e kritereve për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64

Sistemit të vendosur në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 gjithashtu i mungon koherenca dhe qëndrueshmëria. Më tepër se një vit pas plotëfuqishmërisë, nuk ekzistojnë instruksione administrative të qarta për rregulloren përkitazi me kriteret mbi të cilat do të bazohet vendimi për të emëruar prokurorin ndërkombëtar, gjykatësin hetues apo shumicën e kolegjit ndërkombëtar të gjykatësve.

Fakti se rregullorja aplikohet gjatë fazave të ndryshme të procedurës penale dhe ndonjëherë vetëm gjatë njëres fazë, dhe jo për tërë procesin gjyqësor, rezulton me brenga sa i përket transparencës së mekanizmit dhe kriteriumi në të cilin është bazuar. Në disa raste zyrtarët gjyqësor janë caktuar në bazë të Rregullores 64 për të vendosur në lidhje me çështjet e paraburgimit dhe çështjet tjera gjatë procedurës hetimore, mirëpo jo edhe për vetë gjykimin kryesor. Në rastet tjera gjykatësit vendës kryenin hetimet, gjersa trupi gjykues i formuar në bazë të Rregullores 64 udhëheqte me seancën gjyqësore. Në disa raste edhe prokurori ndërkombëtar ishte caktuar në bazë të Rregullores 64. Nën rrethanat e tilla, mungesa e kritereve të qarta për aplikimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 nënkupton se rastet e natyrës së tillë dhe pesha e tyre rrezikojnë të trajtohen ndryshe. Ajo gjithashtu lejon marrjen e konsideratave politike dhe konsideratave tjera të parëndësishme gjatë caktimit të trupit gjykues për lëndët përkatëse.

Në fillim të vitit 2001, ish DAD-i kishte informuar OSBE-në se kriteret për emërim gati ishin kompletuar. Më 23 nëntor 2001 Drejtorati për Përkrahje Gjyqësore Ndërkombëtare në kuadër të DAD-it konfirmoi se nuk ekziston ndonjë urdhëresë administrative e cila përcakton kriteret për zbatimin e rregullores në fjalë. Në vend të kësaj, një referim i posaçëm shkon për formularin për parashtrimin e kërkesave të parapara në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, e cila ishte paraqitur si një udhëzues për “parashtrim të sukseshëm të kërkesës”.⁵² Forma e kërkesës, e cila nga aspekti ligjor nuk është i natyrës obliguese, përcakton qëllimet e rregullores, siç thekson edhe vetë Preambula, dhe vazhdon dhe thotë:

“Departamenti do të vlerësoj kërkesën e dorëzuar duke iu përmbajtur kritereve të mëposhtme:

⁵² *Kërkesa për Emërimin e Gjykatësve/Prokurorëve Ndërkombëtarë dhe/ose Ndryshimin e Vendit sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, e vënë në dispozitim nga DAD-i.*

Ekzistenca, apo mundësia e ndodhjes së, abuzimit apo manipulimit të gjyqësisë vendëse dhe/apo prokurorëve vendës në lidhje me procedurën;

Ekzistenca e tanishme apo e mundshme e kërkesës publike për të marrur ndonjë veprim gjyqësor apo të prokurorisë në cilëndo fazë të procedurës;

Dallimi në mes të të akuzuarit, viktimës apo dëshmitarëve përkitazi me karakteristikat siq janë religjioni, përkatësia etnike, gjuha amtare, shtetësia, apo përkatësia politike.

Natyra e veprave penale të referuara në kallëzimin penal, aktakuzë apo edhe aktgjykim.

Faza e procedurës; dhe

Çfarëdo faktori tjetër i cili mund të ndikoj në mënyrë negative në paanshmërinë gjyqësore dhe/ose të prokurorisë apo të cilat mund të rezultojnë me një anshmëri gjyqësore apo të prokurorisë.”

Kjo formë e propozuar përcakton një sërë kriteresh për vlerësimin e kërkesës por, pasi që kjo formë formalisht asnjëherë nuk është miratuar me ndonjë urdhëresë administrative e cila e shoqëron Rregulloren e UNMIK-ut 2000/64, nuk ka ndonjë karakter ligjor. Pasi që forma e kërkesës nga aspekti ligjor nuk është e obligueshme, se a i marrin zyrtarët e DAD-it këto kritere në konsideratë, një gjë e tillë nuk mund të konstatohet. Siç u përmend edhe më lart, rregullorja nuk aplikohet në mënyrë konsistente; dhe rastet e ngjashme trajtohen në mënyra të ndryshme, të cilat, nëse kriteret e përmendura do të ishin vërtetë një bazë e shëndoshë për vlerësim, nuk do të duhej të numërohen. Pyetja e ardhshme është, pastaj, se deri në çfarë mase PSSP-ja, i cili ka pushtet të bie vendime përfundimtare, e konsideron vetën të obliguar nga këto kritere. Një vlerësim i saktë në lidhje me këtë çështje nuk mund të bëhet sepse vendimet e PSSP-së përkitazi me zbatueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 nuk japin ndonjë arsytim ligjor po faktik në lidhje me këtë. Pra, OSBE-ja brengoset se forma e propozuar jep një dukje të një transparence jorealiste, përderisa në fakt, aty mund të ekzistojnë kritere tjera të cilat vendosin në lidhje me çështjen në fjalë, duke marrë parasysh gjuhën e gjerë të vet rregullores.⁵³

Përgjegjësia disiplinore dhe shkarkimi nga detyra

Mekanizmi i përgjegjësive disiplinore

Garancë tjetër e pavarësisë institucionale të gjyqësisë është metoda i mbajtjes së gjykatësve dhe prokurorëve, përgjegjës për veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre gjyqësore. Kur zyrtarët gjyqësor kanë arsye për tu frikuar nga pasojat disiplinore dhe pasojat tjera për shkak të mënyrës së ushtrimit të funksionit të tyre, atëherë pavarësia gjyqësore dëmtohet. Kjo çështje gjithashtu prek në çështjen e sigurisë së mandatit të tyre, por, siç u theksua më lart në këtë seksion, rrethanat në Kosovë pamundësojnë themelimin e gjyqësisë të përbërë nga gjykatësit e emëruar për një periudhë më të gjatë kohore dhe ata të cilët nuk mund të shkarkohen nga detyra. Sidoqoftë, është tejet e rëndësishme që gjyqtarët të gëzojnë, për një periudhë të caktuar kohore, një stabilitet të sigurtë. Mungesa e stabilitetit të tillë për gjyqtarët në Kosovë, qoftë ata vendës apo ndërkombëtar, ngrit shqetësimet përkitazi me mundësinë që autoriteti ekzekutiv, i cili është përgjegjës për zgjatjen e kontratave të tyre, mund të përdor procedurën e zgjatjes së kontratave si një metodë për shkarkim nga detyra të zyrtarëve të padëshiruar gjyqësor pa iu përmbajtur procedurave të rregullta disiplinore.

Duke u larguar nga çështja e kohëzgjatjes së mandatit, e cila vetvetiu nuk duhet të ndikoj negativisht në pavarësinë e gjykatësve, mekanizmi i përgjegjësive dhe procesi i shkarkimit apo rrimërimin paraqet një rrezik të konsiderueshëm për pavarësinë gjyqësore. Si i tillë, përgjegjësia profesionale për anëtarët e gjyqësisë përfaqëson një mbrojtje të domosdoshme kundër dështimit të gjyqësisë, dhe mu për këtë

⁵³ Rregullorja 2000/64 i referohet vetëm domosdoshmërisë së sigurimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësisë apo administrimit të drejtë të gjyqësisë.

arsye OSBE-ja mirëpret, në raportin paraprak mbi sistemin penal gjyqësor, themelimin e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorisë (KGJP), si një organ i përkohshëm dhe kuazi i pavarur që ka mandat në fushën e disiplinës gjyqësore⁵⁴.

Sidoqoftë, KGJP-ja vetvetiu, ndonëse perceptohet të jetë një garantues i pavarësisë gjyqësore, ka detyrime të cilat nga rrjedhin nga stipulimet organizative të cilat janë në mospajtim me standartet e pavarësisë së gjykatësve, gjë që mund të ndikoj në ushtrimin e funksioneve nga ana e tyre. Së pari, fakti se KGJP, nga i cili pritet të siguroj një shqyrtim transparent dhe të pavarur të punës së gjykatësve, është i emëruar nga i njëjti pushtet ekzekutiv përgjegjës i cili gjithashtu është përgjegjës edhe për emërimin e anëtarëve të gjyqësisë, gjegjësisht PSSP-ja, ndikon negativisht në pavarësinë institucionale të këtij organi. Varësia e KGJP-së nga PSSP-ja thellohet edhe më tej nga fakti se kur të vij deri te largimi nga zyra, rezultati i shqyrtimit disiplinor nuk është vendim i cili ka karakter detyrues, por më shumë paraqet një rekomandim i thjeshtë i cili i bëhet PSSP-së. Sipas këtij mekanizmi, nuk është KGJP-ja ajo e cila bie vendimin në një lëndë disiplinore, por PSSP-ja, gjë që e bën KGJP-në vetëm një organ këshilldhënës për pushtetin ekzekutiv. Sa i përket garancave themelore për një proces të drejtë për gjykatësit dhe prokurorët të cilët i nënshtrohen shqyrtimit disiplinor nga KGJP-ja, OSBE është e brengosur se këta profesionistë nuk kanë të drejtë në ankesë kundër vendimit disiplinor të marrë kundër tyre. Rregullorja me të cilën themelohet KGJP-ja dështon të ofroj një mekanizëm për rishikimin e këtyre rasteve dhe, teknikisht, përderisa vendimet e tilla merren nga PSSP-ja, mundësia e rishqyrtimit (rishikimit) të këtyre rasteve ndërlikohet edhe më tepër. Ankesa kundër vendimit të marrë nga PSSP-ja përsëri ngrit çështjen e imunitetit të UNMIK-un, strukturën dhe përfaqësuesit e tij, duke mos lënë hapësirë për gjykatësit dhe prokurorët të cilët i nënshtrohen shqyrtimit disiplinor nga KGJP-ja që të kërkojnë rishqyrtimin e vendimeve të marra kundër tyre⁵⁵.

Çështja e përgjegjësisë gjyqësore bëhet edhe më problematike kur kemi të bëjmë me gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar. Përkundër rekomandimeve të shumta të cilat janë bërë përkitazi me zhvillimin e sistemit të përgjegjësisë disiplinore për anëtarët e gjyqësisë, kjo çështje ende nuk është adresuar. Së pari, fakti se mekanizmat disiplinor nuk janë njësoj të disponueshme sa i përket zyrtarëve gjyqësor vendës dhe atyre ndërkombëtarë në ushtrimin e detyrave të veta brenda gjykatave të njëjta dhe, ndonjëherë, si anëtarë të kolegjit të njëjtë gjyqësor, krijon standarte të dyfishta të cilat nuk janë në pajtim me gjyqësinë demokratike. E dyta, mungesa e mekanizmit të mbajtjes së gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtarë përgjegjës për veprimet e tyre gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre shkakton shqetësime përkitazi me shpërdorimin e drejtësisë apo shpërdorimin gjyqësor, të cilat mund të kalojnë të pakontrolluara.

Për më tepër, OSBE-ja është e brengosur se si rezultat i mungesës së një procedure të tillë disiplinore për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar, i vetmi opcion për t'i mbajtur edhe ata përgjegjës vie në pah vetëm gjatë ripërtrirjes së kontratave të tyre. Ky opcion, sidoqoftë, nuk është në pajtim me garancat e pavarësisë gjyqësore sepse zgjatja e kontratave është çështje me të cilën merret ekzekutivi.

Mjetet juridike kundër paanshmërisë

Ndonëse jo në lidhje të drejtëpërdrejtë me çështjen e përgjegjësisë disiplinore të gjykatësve, OSBE-ja është tejet e brengosur përse i përket mungesës së mjeteve juridike kundër animeve të mundshme të cilat mund të ndodhin gjatë gjyqimit. Të gjitha sistemet juridike, duke përfshirë këtu edhe atë të Kosovës, ofrojnë kritere të qarta dhe procedura për përjashtimin e gjykatësit. Ligji i zbatueshëm në

⁵⁴ Shih, Shqyrtimi i tretë, Pjesa 2, faqe 17,

⁵⁵ OSBE është informuar, në një letër të 16 Prillit 2002, që DD ka mbaruar punën në draftin e ndryshimeve të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/08; drafti pëfshinë, mes tjera qështjeve, dispoitita specifike për si për të drejtën e gjykatësve dhe prokurorëve për tu ankuar kundër vendimit të marrë nga KGJP-ja në rastet disiplinore.

mënyrë strikte parasheh një sërë situatash në të cilat gjykatësi përjashtohet gjatë dëgjimit të rastit, dhe ajo më tej siguron për palët të cilat kanë kërkuar përjashtimin e gjykatësit përkatës, paanshmëria e të cilit është vënë në dyshim.⁵⁶

Sidoqoftë, këto mjete juridike, të parashikuara me ligj si garanca të paanshmërisë gjyqësore, nuk zbatohen për gjykatësit ndërkombëtar të caktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64. Argument i qëndrueshëm për moszbatimin e procedurës së përjashtimit kundër këtyre gjykatësve ka qenë se nëse jipet kompetenca e përjashtimi simbas ankesës kundër gjykatësit apo prokurorit ndërkombëtarë të emruar nën Rregullorë e UNMIK-ut 2000/64, kryetarët e gjyqeve, të cilët nën ligjin e aplikueshëm janë kompetent të vendosin në procedurat e diskualifikimit, do të shpërdornin mekanizmin në dëmtim të zyrtarëve ndërkombëtarë.⁵⁷ Zgjidhja alternative e aprovuar nga DD për tu marr me ankesat për diskualifikimit të kolegjeve me gjykatës ndërkombëtarë të caktuar nën Rregullorën e UNMIK-ut 2000/64 ilustron më tutje kontrollin e DD mbi qështjet e pastërta gjyqësore. Kjo procedurë, e cila as nuk egziston në formën e ndryshuar përcakton që, kurdo që ngritet ndonjë ankesë për diskualifikimin e një kolegjii ndërkombëtarë, Drejtori I DD do të emrojë një gjykatës tjetër ndërkombëtarë për të vendosuar në qështjen e diskualifikimit. Me fjalë tjera, gjykatësit e caktuar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, jo vetëm që veprojnë jashtë sistemit të rregullt gjyqësor, pa mjete juridike apo garanca të cilat kanë të bëjnë me ushtrimin e funksioneve të tyre, por gjithashtu edhe DD-së i është dhënë pushtet plotësues nga fusha e procedurave gjyqësore, Ky pushtet për të emruar gjykatës individual, nga të cilët pritet të diskualifikojnë gjykatësit tjerë ndërkombëtarë të cilët DD vet I ka emruar dobëson pavarësinë e gjykatës.

Shkarkimi nga detyra dhe ndërprerja e kontratave për gjykatësit dhe prokurorët

OSBE-ja ishte tejet e brengosur në të kaluarën përkitazi me procedurën e shkarkimit nga detyra të gjykatësve dhe prokurorëve, pasi që kjo ishte bërë tërësisht nga ana e organit ekzekutiv. Në këtë drejtim, KGJP-ja tani ka mandatin për të vendosur në lidhje me çështjet e disiplinës gjyqësore, duke përfshirë këtu edhe mandatin e dhënies së propozimeve PSSP-së mbi emërimin dhe shkarkimin nga detyra si të gjykatësve ashtu dhe prokurorëve. Si çështje brengosëse ende mbetet, sidomos sa i përket metodës për ripërtirjen e kontratave për gjykatësit vendor dhe prokurorët, procesi i cili mund të përdoret si alternativë e shkarkimit nga detyra për shkaqe disiplinore.⁵⁸ Përmbledhja e kritereve për ri-emrimin në zyre, siq është paraqitur në seksionin 6.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/08, lejon që zyrtarët e gjyqësis të mos ri-emrohen për arsytet e integritetit moral apo praktikave diskriminuese,⁵⁹ të cilat normalisht duhet të justifikojnë procedurën disiplinore përbrenda NJIGJ dhe KGJP, ku gjykatësit apo prokurorët në fjalë mund të paraqesin prova në mbrojtjen e tyre. Gjykatësit dhe prokurorët kurrë nuk janë informuar përkitazi me bazat e vlerësimit të cilat i kishin paraprirë zgjatjes së kontratave të tyre. Situata të cilat nxisin kureshtje kishin ndodhur kohëve të fundit gjatë procesit të ripërtirjes së kontratave për vitin 2002. Intervistat e zhvilluara nga OSBE-ja me gjykatës dhe prokurorë në të gjitha rajonet e Kosovës treguan se, kah fundi i janarit 2002, ata ende nuk posedonin me informata zyrtare në lidhje me atë se a ishin zgjatur apo jo kontratat e tyre. Disa nga ta raportuan se kishin dëgjuar mbi zgjatjen e kontratave të tyre nga mediat por nuk kishin mundur të marrin një konfirmim zyrtar nga

⁵⁶ Neni 39-44 LPP RFJ.

⁵⁷ Në një letër të adresuar OSBE-së me 16 Prill 2002, DD, deklaroi se “qartë nëse kjo kompetencë u jipet kryetarëve të gjykatave në kolegjet e përbëra me shumicë të gjykatësve ndërkombëtarë, është e mundur që secili kolegj të mundet nga kryetari.”

⁵⁸ Siç është përmendur më lartë në këtë pjesë, sistemi i ripërtirjes së kontratave çdo vit është ndryshuar nga DD dhe emërimet tani bëhen për një kohë të pacaktuar, me mundësi të shkarkimit të tyre nga detyra me vendim të KGJP-së.

⁵⁹ Shiko Seksioni 6.1 (c,d) të Rregullorës së UNMIK-ut 2001/08.

DD⁶⁰. Nga situatat e tilla burojnë shqetësime të ndryshme sidomos nga perspektiva e ligjshmërisë së aktivitetit të këtyre gjykatësve brenda periudhës kur ata kishin ushtruar funksionet e tyre pa bazë ligjore. Për më tepër, këto mangësi të paraqitura në nivel të administrimit të drejtësisë dhe kriterëve jo-adekuate për vlerësimin e zgjatjes së kontratave rezultojnë me shqetësime të shumta përkitazi me pavarësinë organizative gjyqësore. Gjykatësi i cili nënshtrohet procedurës së riemërimit çdo gjashtë muaj apo çdo një vit, pa qenë mirë të informuar në lidhje me procedurën dhe kriteret e riemërimit, nuk mund të konsiderohet si anëtar i pavarur i gjyqësisë.

III. PAVARËSIA FUNKSIONALE

Duke lëshuar rrënjë thellë në konceptin themelor të ndarjes së pushtetit, i cili qeveris çdo shoqëri demokratike, parimi i pavarësisë funksionale të gjyqësisë është i bazuar në idenë se organet e ndryshme shtetërore posedojnë kompetenca specifike dhe ekskluzive, dhe së këndejmi organet jo-gjyqësore as nuk mund të ushtrorin e as të ndërhyjnë në funksionet gjyqësore. Testi i parë për konstatimin e masës së autonomisë gjyqësore të një sistemi ligjor të caktuar, është që të plotësoj kushtin për pavarësinë e legjislacionit në fjalë. Në këtë drejtim, shumica e kushtetutave nacionale apo dispozitave ligjore ofrojnë garanca për pavarësinë gjyqësore duke kërkuar që gjykatat të jenë të themeluara në bazë të ligjit dhe që gjykatësit duhet të jenë të udhëhequr vetëm nga ligji, dhe të mbajnë përgjegjësi vetëm para ligjit.

Megjithatë, edhe kur legjislacioni ofron garanca të mjaftueshme për pavarësinë gjyqësore në aspektin funksional, testi real i pavarësisë, i cili shkon edhe përtej garancave legjislative, paraqet një interaksion praktik ndërmjet të organeve ekzekutive apo legjislative, dhe gjykatave. Përsa i përket sistemit të gjyqësisë penale në Kosovë, ky raport do të shqyrtoj raportin funksional në mes të gjyqësisë dhe degëve ekzekutive të UNMIK-ut dhe atyre legjislative.

Siç është shpjeguar më herët në fushëveprimin e këtij raporti, OSBE-ja me një theks të posaçëm në problemet tematike strukturore të cilat lindin në kuadër të sistemit të drejtësisë, ofron një pasqyrë më të gjerë përkitazi me evoluimin dhe historikun e sistemit, i cili mundet, herë pas here, të prek në çështjet, rastet, apo pjesët e legjislacionit të cilat ndodhen jashtë kornizës kohore 6-mujore të nevojshme për përpilimin e këtij raporti. Sidoqoftë, pasi që ato mund të merren si të rëndësishme për temën të cilën po e shtjellojmë, këto raste apo ky legjislacion do të jetë i analizuar dhe i komentuar edhe ato janë përmendur në raportet paraprake; komentet e vjetra, megjithatë, nuk do të përsëriten, por të njëjtat çështje do të shtjellohen mirëpo nga një perspektivë e re.

Ndërhyrja e ekzekutivit në pavarësinë gjyqësore

Liria nga ndërhyrja në procedurat gjyqësore paraqet një garancë themelore në kuadër të konceptit të pavarësisë gjyqësore funksionale dhe në rradhë të parë kërkon që autoritetet ekzekutive apo legjislative nuk mund të japin instruksione të natyrës detyruese gjykatave gjatë ushtrimit të veprimtarisë (mandatit) të tyre.⁶¹

Dhënia e urdhërave ekzekutiv nga PSSP-ja për personat e paraburgosur rezulton me probleme të shumta, për të cilën gjë edhe OSBE-ja ka raportuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë përpilimit të

⁶⁰ Përgjigjësia e DD-së për këtë çështje ishte që ri-emrimet në zyret gjyqësore janë publikuar në mediat vendore. Megjithatë, publikime të tilla para lajmrimit zyrtar të adresuar zyrtarëve gjyqësorë në plotëson nevojën për informacion adekuat.

⁶¹ Shih Beumartin kundër Francës, GJEDNJ, 24 nëntor 1994.

raporteve paraprake mbi sistemin e drejtësisë penale në Kosovë.⁶² Shqetësimet e tilla të shprehura kanë të bëjnë me mungesën e bazës ligjore në ligjin ndërkombëtar dhe atë vendës për dhënien e këtyre urdhërave, dhe gjithashtu edhe me mungesën e rishqyrtimit gjyqësor për këto paraburgime. Përveq problemeve tashmë të njohura, praktika e PSSP-së për dhënien e urdhërave ekzekutiv për të paraburgosur rezulton me shqetësime të mëtutjeshme sidomos nga perspektiva e ndërhyrjes së ekzekutivit në ushtrimin e funksioneve gjyqësore. Në të gjitha rastet ku PSSP-ja ushtron pushtetin e tij për paraburgimin e personave të ndryshëm nëpërmjet të dhënies së urdhërit ekzekutiv, persona këta të cilët tashmë veç kishin qenë objekt i procedurave gjyqësore të inicuar kundër tyre dhe të cilët mëpastaj ishin liruar me vendime gjyqësore. Duke e rivlerësuar çështjen e paraburgimit, PSSP-ja filloj të ndërhyj në fushën e aktvendimeve gjyqësore, ku me pushtetin e tij ekzekutiv, ai gjithashtu filloj të ndërhyj edhe në mbarëvajtjen e procedurave gjyqësore dhe injoroi pushtetin e mirëfilltë të cilin zakonisht e kanë vetë gjykatat. Në praktikën e saj gjyqësore, Gjykata Evropiane kishte gjykuar se *pushteti i cili jep vendime të natyrës obliguese të cilat nuk mund të ndryshohen nga autoriteti jo-gjyqësor në dëm të palës individuale, është i pandashëm me nocionin e vetë gjykatës dhe paraqet elementet themelore të konceptit të pavarësisë gjyqësore.*⁶³

Rasti i katër shqiptarëve të Kosovës, të dyshuar për sulm me bombë në autobusin e Nish Ekspresit më 18 shkurt 2001, ilustron mënyrën në të cilën Urdhërat Ekzekutiv të PSSP-së ndërhyjnë në pushtetin e gjykatave. Pas hetimeve të ndërmarra nga gjykatësi hetues ndërkombëtar i caktuar për atë lëndë në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64, kolegji i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, i përbërë ekskluzivisht vetëm nga gjykatës ndërkombëtar, vendosi të liroj tre të dyshuarit në mungesë të provave për veprën me të cilën ngarkoheshin ata. Megjithatë, vendimi i gjykatës kurrë nuk u ekzekutua për shkak të intervenimit të menjëhershëm të PSSP-së. Paraburgimi i të dyshuarve vazhdoi në bazë të Urdhërit Ekzekutiv të PSSP-së⁶⁴.

Duke pasur në dijeni se PSSP-ja nuk kishte ushtruar pushtetin e tij për caktimin e paraburgimit gjatë gjashtë muajve të fundit, OSBE-ja është tejet e shqetësuar se thjeshtë ruajtja e këtij pushteti për caktimin e paraburgimit për personat përkatës jashtë procedurës gjyqësore ndikon në pavarësinë e cila duhet ta karakterizoj çdo sistem gjyqësor. Në këtë drejtim, vetëm braktisja e plotë e kësaj praktike mund të eliminoj ndërhyrjen e mundshme të ekzekutivit në çështjet specifike gjyqësore, siç është urdhërimi i paraburgimit për personat të cilët kryejnë vepra penale.

Përgjatë vijës së njëjtë të arsytimit, OSBE-ja është e brengosur thellë përse i përket praktikës të cilën e shfrytëzon KFOR-i gjatë paraburgimit të personave. Si pjesë e pushtetit ekzekutiv KFOR-i, në Kosovë, paraqet një organ më të politizuar se që do të ishte një forcë e rregullt ushtarake në një shoqëri demokratike. Ky status imponon një obligim për KFOR-in që të veprojnë me përgjegjësi më të madhe kur të ushtron apo supozon autoritetin ekzekutiv, posaçërisht në fushën e drejtësisë penale. Pushteti për t'i paraburgosur personat e ndryshëm jashtë procedurave gjyqësore, siç bëhet nga komandanti i KFOR-it sipas pushtetit i cili i është dhënë në bazë të RKS 1244, rezulton me paragjykime sa i përket pavarësisë funksionale të gjyqësisë. Kjo praktikë e paraburgimit po shëndërrohet në një ndërhyrje të ekzekutivit në ushtrimin e funksioneve gjyqësore, e veçanërisht në rastet ku procedurat penale janë në zhvillim e sipër dhe kur gjykatat tashmë kanë bërë vlerësimin e çështjes së paraburgimit.

Ndërhyrja e KFOR-it në çështjet gjyqësore është ilustruar me rastin e një të dyshuari shqiptar të Kosovës, anëtar i Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), i cili ishte arrestuar më 25 prill 2001 me akuzë për tentim-vrasje, posedim të paligjshëm të armëve, dhe sjellje kërcnuese. Më 4 qershor 2001, pas

⁶² Shih, Shqyrtimi i parë, Pjesa 4, faqe 24-26; Shqyrtimi i dytë, Pjesa 3, faqe 16-19; Shqyrtimi i tretë, Pjesa 4, faqe 32-37.

⁶³ Rasti Van de Hurk kundër. Holandës, GJEDNJ, 19 prill 1994.

⁶⁴ Tre të dyshimit janë liruar më 18 Dhjetor 2001 pas vendimit të Gjykatës Supreme.

ankesës së bërë nga mbrojtja kundër zgjatjes së paraburgimit të urdhëruar nga kolegji i Gjykatës së Qarkut, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi se nuk kishte baza për mbajtjen e të dyshuarit në paraburgim dhe si rezultat i kësaj urdhëruan lirin e tij. Për më tepër se një muaj pas lirit, më 14 korrik 2001, KFOR-i riarrestoj të dyshuarin në lidhje me të njëjtin rast dhe e paraburgosi atë në bazë të pushtetit të komandantit të KFOR-it

Parimet 3 dhe 4 të *Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjykatave* thonë se gjyqësia do të ketë kompetenca mbi të gjitha çështjet e natyrës gjyqësore, dhe do të ketë autoritet ekskluziv për të vendosur se a është çështja e parashtruar për vendosje, brenda kompetencës së saj siç definohet me ligj. Ato më tej parashohin se nuk do të ketë asnjë ndërhyrje të pavend apo të pakërkuar në procedurën gjyqësore, e as vendimet gjyqësore nga gjykata nuk do të jenë objekt i revizionit. Duke vlerësuar praktikën për caktimin e paraburgimit nga ana e PSSP-së dhe KFOR-it dhe pushtetin të cilin e kanë ata në dritë të këtyre parimeve, OSBE-ja është tejet e shqetësuar se çdo intervenim në statusin e paraburgimit të individit, në rastet kur gjykata e themeluar me ligj tashmë ka dhënë vendimin e vet, përbën shkelje të pavarësisë funksionale të asaj gjykate. Për më tepër, praktikën e tilla dobësojnë besimin që publiku ligj-kërkues e ka në gjyqësi. Pavarësia gjyqësore është një koncept abstrakt që varet shumë nga kredibiliteti dhe qartësia ligjore që duhet të inspiroj publikun e gjerë; siç ka theksuar shumë herë edhe vetë Gjykata Evropiane, *drejtësia nuk duhet vetëm të bëhet, ajo gjithashtu duhet të shihet se është duke u bërë*.⁶⁵

Ndërhyrja e legjislativit në pavarësinë gjyqësore

Ndërhyrja e cila mund të jetë e dëmshme për pavarësinë funksionale të gjyqësisë mundet gjithashtu të vij edhe nga vetë degët legjislative të autoritetit shtetëror. Gjykata Evropiane mban qëndrim se statuti i nxjerrur nga organet legjislative, me qëllim të ndryshimit të situatës ligjore të rastit të caktuar që është në shqyrtim e sipër para gjykatës, çënon pavarësinë gjyqësore, posaçërisht në rastet kur vetë shteti është palë.⁶⁶ Ky interpretim dhe arsyeja prapa saj, e dhënë nga Gjykata Evropiane në lidhje me lëndët civile ku Shteti është njëra prej palëve të përfshira në proces dhe e cila ka interes të drejtpërdrejt në rezultatin e procesit gjyqësor, është zgjeruar edhe në rastet penale. Si rregull, shteti është palë në procedurën penale apo, edhe kur nuk është, shteti ka interes të përgjithshëm në ndjekjen ligjore të veprave penale.

Në këtë drejtim, OSBE-ja është thellë e brengosur përkitazi me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/18⁶⁷, pasi që nxjerrja e saj paraqet një shembull të qartë të legjislativit i cili ndryshon statusin ligjor të lëndës penale e cila është në shqyrtim e sipër para gjykatës, duke ndërhyrë në funksionet e këtij të fundit. Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18, e nxjerrë nga PSSP-ja më 25 gusht 2001, duket se krijon një kornizë gjyqësore e cila mund t'i vendos paraburgimet e caktuara nga ekzekutivi në kuadër të procesit gjyqësor. Sidoqoftë, aty ekzistojnë edhe apsekte të tjera sa i përket zbatimit të rregullores në fjalë nga e cila burojnë një sërë shqetësimesh që kanë të bëjnë me ndeshjen e tyre me pavarësinë e gjykatave.

Së pari, komisioni i themeluar në bazë të rregullores është një organ gjyqësor ad-hoc struktura, funksionet dhe përbërja e të cilit nuk bijnë askund në kuadër të sistemit të rregullt gjyqësor në Kosovë; për më tepër, anëtarët e këtij komisioni të gjithë ishin zgjedhur dhe emëruar sipas autoritetit të PSSP-së, autoritetin e të cilit pritej ta shqyrtonte vetë komisioni në fjalë. Në këtë drejtim, komisioni i themeluar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/18 nuk mund të konsiderohet gjykatë në kuptim të nenit 6 të

⁶⁵ Shih *Delcourt kundër. Belgjikës*, GJEDNJ, 17 janar 1970.

⁶⁶ Rasti *Stran Greek Rafineritë dhe Straties Andreadis kundër. Greqisë*, GJEDNJ.

⁶⁷ Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 mbi Themelimin e Komisionit për Rishqyrtimin e Paraburgimit për Paraburgimet Jashtë-Gjyqësore të bazuara në Urdhërat Ekzekutiv.

KEDNJ dhe në kuptim të Parimit 5 të Parimeve Themelore mbi Pavarësinë e Gjyqësisë.⁶⁸ Këto të fundit parashohin se çdonjëri do të ketë të drejtë të gjykohet nga gjykatat e rregullta apo tribunale duke përdorur procedurat ligjore. Ato në vazhdim parashohin se tribunale të cilat nuk përdorin procedurat e duhura të proceseve ligjore nuk do të krijohen për të zhvendosur kompetencat të cilat u takojnë gjykatave të rregullta apo tribunaleve gjyqësore. Si rezultat i kësaj, themelimi, pas intervenimit të legjislativit, i komisionit të jashtëzakonshëm gjyqësor për rishqyrtimin e çështjeve të paraburgimit në rastet specifike, ka efektin e uzurpimit të kompetencave të cilat i takojnë sistemit të rregullt gjyqësor.

E dyta, aplikueshmëria e rregullores ishte drejtuar vetëm tek një numër specifik i rasteve penale, respektivisht për të siguruar një shqyrtim të statusit të paraburgimit të tre shqiptarëve të Kosovës, të dyshuar për përfshirje në vendosjen e bombës në autobusin e Nish Express-it. Në momentin e nxjerrjes së rregullores në fjalë, këta tre të dyshuar tashmë veç kishin kaluar tre muaj në paraburgim në bazë të Urdhërave Ekzekutiv të PSSP-së dhe hetimet e ndërmarra nga gjykatësi ndërkombëtar ishin në zhvillim e sipër. Vlen të theksohet se rregullorja e edhe komisioni në fjalë, kanë pasur fuqi ligjore vetëm për tre muaj. Në frymën e parimeve të pavarësisë gjyqësore, e vetmja alternativë e pajtueshme me garancat e gjykimit të drejtë nga gjykata e pavarur e themeluar me ligj, do të kishte qenë rivendosja dhe plotëfuqishmëria e vendimit mbi paraburgimin e dhënë nga kolegji i gjykatësve të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë (vendimi të cilin PSSP-ja më parë nuk e kishte përfillur fare). Si mjet i fundit, çështja e paraburgimit mund të ishte parashtruar sërish pranë sistemit të gjykatave të rregullta për ri-dëgjimin e rastit bazuar në provat e përmbajtura në shkresat e lëndës dhe në gjetjet/zbulimet e gjykatësit hetues. Në vend të kësaj, me ntervenimin në vendimin ligjore të pruar për lëndën e cila ishte në procedurë e sipër në gjyq, dhe me ndryshimin e statusit ligjor të çështjes e cila tanimë ishte vendosur nga ajo gjykatë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/18 përmban paragjykime në lidhje me pavarësinë funksionale të gjyqësisë.⁶⁹

Imuniteti për UNMIK-un dhe KFOR-in

Një çështje tjetër në lidhje me pavarësinë funksionale gjyqësore në Kosovë, e cila buron nga Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47.⁷⁰ Rregullorja parasheh që UNMIK-u, me pronat e saj, fondet dhe pasuritë, do të gëzojë imunitet nga çdo proces ligjor. Rregullorja gjithashtu parasheh që PSSP, zëvendësi kryesorë i PSSP-së, katër zëvendësit tjerë të PSSP-së, Komisioneri i Policisë, dhe zyrtarë tjerë të lartë të caktuar nga PSSP “*kohë pas kohe*” do të jenë imunë nga jurisdiksioni lokal në lidhje me qfardo veprimi civil apo penal të ushtruar apo të bërë nga ata në Kosovë.⁷¹ Për më tepër edhe personeli i tij do

⁶⁸ Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur qëndrimin se një varshmëri e tillë aq e dukshme nga ekzekutivi, përjashton organin nga të qenit i pavarur. Shiko për shembull, *Ringeisen v. Austria*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 16 qershorit 1971; *Landborger kundër. Suedisë*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 22 qershorit 1989, posaçërisht alinea 32; *Belilos kundër. Zvicrës*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 29 prillit 1988; dhe *Findlaz kundër. Britanisë së Madhe*, Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i 25 shkurtit 1997, alinea 73. Shiko gjithashtu *Starrs dhe të tjerët kundër. Prokuratorit Fiskal*, Gjykata e Lartë e Drejtësisë, 11 Nëntor 1999 (vendim i Skocisë, një prej shumë rasteve vendore që aplikon praktikën gjyqësore të GJEDNJ mbi pavarësinë).

⁶⁹ Një mendim i detajuar në lidhje me pajtueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut 2001/18 me standardet e pranuar ndërkombëtarisht për pavarësinë e gjyqësisë është shprehur edhe nga vetë Ombudspersoni në Raportin Special nr.4 të 12 shtatorit 2001. Ombudspersoni shqyrtoi Rregullorën 2001/18 dhe e bëri të qartë se PSSP-ja, gjatë veprimit të tij në cilësinë e ligjvënësit në Kosovë, ka nxjerrur një ligj në Kosovë i cili i garanton atij të ketë kontroll mbi çfarëdo procesi gjyqësor me rëndësi fundamentale për të. Rregullorja në fjalë e vendos komisionin nën kontroll substancial të ekzekutivit, veprimet e të cilit komision ishin kontestuar mjaft nga ana e gjykatave të rregullta pavarësisht, paanshmëria dhe jurisdiksioni i plotë i të cilave kurrë nuk duhet të vihen në pikëpyetje.

⁷⁰ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47 mbi Statusin, Privilegjet, dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe Personelit të tyre në Kosovë, e nxjerrur më 18 gusht 2000.

⁷¹ Seksioni 3.2 I Rregullorës së UNMIK-ut 2000/47.

të gëzojë imunitet nga jurisdikcioni vendës në drejtim të çfarëdo vepre civile apo penale të kryer nga ta gjatë veprimit të tyre në cilësinë e zyrtarit brenda territorit të Kosovës.⁷²

Imuniteti i UNMIK-un gjatë veprimit të tij në cilësi administrative

Imuniteti për misionet humanitare të KB-së rjedh nga Karta e KB-së dhe Konventa mbi Privilegjet dhe Imunitetet e KB-së, dhe qëllimi i saj funksional është që të sigurojë ushtrimin e pavarur të misioneve të saj në lidhje me qeveritë vendëse të shteteve nikoqire. Në Kosovë, megjithatë, UNMIK-u nuk është vetëm prezencë ndërkombëtare të cilës i është dhënë mandati që të monitoroj dhe ndihmoj qeverinë vendëse, për më tepër ajo paraqet një qeveri⁷³. Kjo pozitë unike që e ka UNMIK-u në Kosovë rezulton në një kolizion ndërmjet të çështjes së imunitetit dhe pavarësisë së gjyqësisë, pasi që ky imunitet nuk bën asgjë tjetër pos që e mbron UNMIK-un nga vetvetja.⁷⁴ Imuniteti i krijuar në bazë të Rregullores 2000/47 siguron që, pa marrë parasysh karakterin dhe pasojat e aktiviteteve apo vendimeve të ndërmarra nga UNMIK-u në cilësinë e tij zyrtare si qeveri e përkohshme, gjykatat nuk mund të shqyrtojnë ligjshmërinë e këtyre aktiviteteve apo vendimeve të tilla, dhe as që mundën të pranojnë apo vendosin mbi ankesat private kundër tyre.

Një element thelbësor i pavarësisë funksionale të çfarëdo sistemi demokratik gjyqësor buron nga pushteti të cilin e ka gjyqësia që t'i shpall të gjitha aktet legjislativë dhe ekzekutive si të paligjshme dhe së këndejmi të ofroj mbrojtje dhe mjete juridike për individët të drejtat e të cilëve janë cënuar nga veprimet e organeve të tilla ekzekutive dhe administrative. Përderisa gjyqësia në Kosovë nuk ka pushtet për të ushtruar një kontroll të tillë mbi veprimet e organeve qeveritare, pavirusia e sistemit gjyqësorë është e paragjykuar.

Një shembulli goditës i ndikimit të imunitetit të UNMIK-ut në pavarësinë gjyqësore dhe në të drejtat e njeriut të palëve të përfshira në procese ligjore është rasti i gruas shqiptare të Kosovës e cila inicoj procedurë kontestimore kundër një akti administrativ të lëshuar nga komuna e Kaçanikut dhe Departamenti për Arsim dhe Shkencë i UNMIK-ut. Parashtruesja e kërkesës mori pjesë në konkursin e shpallur për pozitën e drejtorit të shkollës në Kaçanik. Parashtruesja e kërkesës konsideronte se rezultatet e testimit gjatë konkurrimit për atë post ishin jo korrekte dhe si rrjedhojë e kësaj inicoj procedurë kontestimore në lidhje me kushtet dhe procedurën e pafavorshme të aplikimit. Gjykata Komunale në Kaçanik e shqyrtoi rastin dhe vendosi në favor të aplikueses. Reagimi i UNMIK-ut për vendimin e Gjykatës Komunale ishte habitës. Në njërën anë Këshilli Juridik i UNMIK-ut dërgoi një letër gjykatës, e cila thoshte si në vijim: “*Drejtori i Drejtoratit Komunal për Arsim në Kaçanik është aktualisht i punësuar si Drejtor i Drejtoratit në kuadër të Departamentit për Arsim dhe Shkencë në Administratën e Përkohshme të UNMIK-ut. Andaj, ai gëzon imunitet nga çfarëdo procesi ligjor në lidhje me atë çka flet dhe çka bën përderisa të jetë duke vepruar në cilësinë e zyrtarit të UNMIK-ut. Imuniteti i personelit të UNMIK-ut i cili parashihet në pjesën 3 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/47 të 18 gushtit 2000 mbi Statusin, Privilegjet dhe Imunitetet e KFOR-it dhe UNMIK-ut dhe Personelit të tyre në Kosovë*”. Në anën tjetër, UNMIK-u në një tjetër letër të adresuar gjykatës deklaroi se DSHK pranë UNMIK-ut është i vetmi organ përgjegjës për procesin e zgjedhjes dhe rekrutimit të kandidatëve për

⁷² Neni 3 i Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, i shpallur nga PSSP-ja më 18 gusht 2000.

⁷³ Fakti që UNMIK-u në Kosovë ka dy funksione të dalluara, një si paqëruajtëse dhe një si administratë e përkohëshme, nuk mban efekt në implikimet praktike të qështjeve të lidhura me imunitetin. Dallimi mes këtyre dy funksioneve të UNMIK-ut është bërë nga OLA në një letër të adresuar OSBE-së. OLA më tutje theksonte që privilegjet e UNMIK-ut mbulojnë vetëm dimensionet e saj paqëruajtëse dhe kapacitetet e UNMIK-ut si një administratë e përkohëshme. Ku në teori dallimi mund të bëhet mes dy funksioneve të përmendura, dhe UNMIK-u duhet të pohoj imunitetin në lidhje me veprimet apo vendimet e saj paqëruajtëse, nuk ka mundësi praktike për të bërë dallimin mes veprimeve të ndërmarra në kapacitet të njëjës apo tjetrës. Në shumë instanca, veprime të tilla mund të involvojnë UNMIK-un në të dy kapacitetet.

⁷⁴ Në Raportin e tij 122/01, të datës 10 Dhjetor 2001, Ombduspersoni në Kosovë deklaroi se “*UNMIK-u vepron si Shtet surogat në Kosovë dhe jo si një Shtet i cili kërkon mbrojtjen kundër jurisdikcionit të një shteti tjetër, në kuptim të doktrinës së imunitetit sovran.*”

Drejtor të Shkollave, dhe që Drejtorati Komunal për Edukim nuk ka kompetenca mbi këtë qështje. Pasojat e një qëndrimi të tillë të miratuar nga vetë UNMIK-u ishin se vendimet gjyqësor nga aspekti ligjor nuk mund të zbatohen apo ekzekutohen. Gjykata Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut mbante qëndrimin se ekzekutimi i vendimit të plotfuqishëm të gjykatës e cila ka karakter obligues dhe përbën një pjesë të së drejtës për gjykim e cila parashihet me nenin 6 të Konventës Evropiane.⁷⁵ Ombudspersoni gjithashtu e shqyrtoj këtë rast dhe lëshoj raportin e datës 10 dhjetor 2001.

Standartet për të drejtat e njeriut janë drejtëpërdrejtë të zbatueshme në sistemin ligjor të Kosovës dhe, bazuar në formulimin e Rregullores së UNMIK-ut 1999/24⁷⁶, ato kanë përparësi mbi dispozitat vendëse të cilat nuk janë në pajtim me këto standarte. OSBE-ja është tejet e shqetësuar që sistemi gjyqësor deri më tani ka dështuar të interpretoj zbatueshmërinë e legjislacionit vendës dhe rregulloreve të UNMIK-ut në dritën e parimeve të përmendura më lartë. Pasiqë dispozitat që kanë të bëjnë me imunitetin e KFOR-it dhe UNMIK-ut privojnë shumë individë nga të drejtat e tyre themelore, sikurse është e drejta për mjet efektiv juridik⁷⁷, OSBE është thellë e brengosur në lidhje me mosveprimin e gjykatave sa i përket kufizimit të shkallës së imunitetit, sidomos për veprimet apo vendimet e KFOR-it dhe UNMIK-ut të cilat nuk dëmtojnë të drejtat e individëve të ndryshëm për t'i gëzuar të gjitha të drejtat dhe liritë e tyre në mënyrë të plotë.

Imuniteti nga arrestimi dhe ndjekja penale

Nga një perspektivë tjetër e cila përsëri është e ndërlidhur me çështjen e njëjtë, që është imuniteti i UNMIK-ut dhe KFOR-it, e cila përfshin edhe personelin e tyre, sjell një mori paragjykimesh që kanë të bëjnë me funksionimin e pavarur të gjyqësisë në Kosovë në rastet kur të punësuarit ndërkombëtarë të UNMIK-ut apo KFOR-it janë të akuzuar për kryerjen e veprave penale.

Në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, personeli i UNMIK-ut dhe KFOR-it gëzojnë të drejtën në imunitet nga çfarëdo formë e arrestimit apo paraburgimit (neni 3.4) në lidhje me çfarëdo fjale të thënë apo veprimi të kryer në “cilësinë e zyrtarit” (neni 3.3). Rregullorja në thelb, pasqyron dispozitat e nenit V të Konventës mbi Privilegjet dhe Imunitetin e Kombeve të Bashkuara (“Konventa”) e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në shkurt të vitit 1946. Krahas kësaj, neni 105 i Kartës së KB-së në përgjithësi parasheh gëzimin e privilegjeve dhe imunitetit nga ana e anëtarëve të tij, pasi që një gjë e tillë është e domosdoshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve nga ana e anëtarëve të KB-së.

Sidoqoftë, ekzistojnë një sërë dispozitash ligjore si në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 ashtu edhe në kuadër të Konventës, në të cilat parashihen kufizimet dhe kushtet për një imunitet të tillë. Neni 3.5 i rregullores në fjalë obligon personelin e UNMIK-ut që të respektoj ligjet e Kosovës dhe t'i shmangët kryerjes së çfarëdo veprimi që është në kundërshtim me ato ligje. Imuniteti nga procesi ligjor mund të hiqet (Neni 6) vetëm nga Sekretari i Përgjithshëm i KB, për shkak se nga imuniteti përfitojnë UNMIK-u/KFOR-i e jo individët. Formulimi i rregullores është fuqishëm i përkrahur nga Konventa, e cila parasheh se privilegjet dhe imuniteti jipen vetëm nëse një gjë e tillë është *në interes të KB-ve e jo për përfitim personal të individëve të ndryshëm* (Neni 20). Për më tepër, Sekretari i Përgjithshëm i KB ka të drejtë dhe obligim që të heq imunitetin nëse një gjë e tillë rezulton me shtrembërim të drejtësisë, dhe heqja e imunitetit në rastet e tilla pa kurrfarë paragjykimi është në interes të Kombeve të Bashkuara. Neni 21 i Konventës është veçanërisht i rëndësishëm këtu, pasi që ajo definon se KB-ja ka për detyrë të bashkëpunoj në çfarëdo kohe me organet përkatëse *me qëllim të lehtësimit të*

⁷⁵ Shih *Horsnby kundër. Greqisë*, GJEDNJ, 5 shkurt 1997; *Immobiliare Saffi kundër. Italisë*, GJEDNJ, 28 korrik 1999.

⁷⁶ Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24 mbi Ligjin e zbatueshëm në Kosovë, 12 dhjetor 1999.

⁷⁷ Neni 6 i KEDNJ-së; shih më tutje *Golder kundër. Britanisë së Madhe*, KEDNJ, 21 shkurt 1975, *Osman kundër. Britanisë së Madhe*, 28 tetor 1998, *Fayed kundër. Britanisë së Madhe*, KEDNJ, 21 shtator 1994.

administrimit të drejtë të drejtësisë dhe për të siguruar mbikqyrjen e rregulloreve të policisë dhe për të penguar shfaqjen e çfarëdo abuzimi në lidhje me ndonjë privilegj apo imunitet. Përvojat praktike të fituara nga misionet e KB-ve, duket se ekziston një pranim unanim i faktit se çështja e imunitetit për të punësuarit ndërkombëtar në kuadër të KB-së është më shumë e kufizuar në veprimet e ndërmarra apo fjalët e përdorura nga ana i ndonjë të punësuarit përderisa ka qenë duke vepruar në cilësinë e tij si zyrtar sesa përderisa ka qenë duke vepruar në cilësi private.

Një ilustrim mjaft i mirë i gjithë kësaj është edhe Mendimi Këshilldhënës i GJND-së (29 prill 1999) që ka të bëjë me paditë civile të ngritura nëpër gjykatat Malajziane për katër raste të shpifjes dhe përgojimit të cilat ishin bazuar në deklaratat e Raportuesit Special të KB-së mbi Pavarësinë e Gjykatësve dhe Juristëve, dokument ky i publikuar gjatë hetimeve të ndërmarra në atë shtet. GJND-ja, me vendim unanim, gjykoj se Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara i kishte bërë deklaratat të cilat kontestoheshin gjatë kryerjes së funksionit të tij dhe së këndejmi ai duhet të gëzoj imunitet.

Është e pranuar në përgjithësi se imuniteti nuk duhet të rezultoj patjetër në mosndëshkueshmëri, dhe se anëtarët e organizatave të cilët gëzojnë privilegje të tilla nuk duhet të prezumojnë se imuniteti të cilin e gëzojnë u jep fuqi atyre që të mospërfillin ligjet dhe rregulloret e vendeve ku ata ushtrojnë funksionet e tyre. Ky argument është edhe më i fuqishëm, sidomos në rastet kur shkeljet e ligjeve vendëse ndodhin nën rrethanat kur personat të cilët i shkelin ato nuk veprojnë në cilësi zyrtare, dhe gjithashtu nëse këto shkelje paraqesin vepra penale.

Sistemi i drejtësisë në Kosovë, sa i përket pavarësisë dhe pushtetit që e ka ky sistem për të jetësuar sundimin e ligjit, nuk ka ndonjë përvojë pozitive sa i përket ushtrimit të privilegjes së imunitetit, posaçërisht kur kemi të bëjmë me rastet penale. Gjer më tani, OSBE-ja ka arritur të monitoroj pesë procedura hetimore të inicuar kundër të punësuarve ndërkombëtar në UNMIK. Në të gjitha këto 5 raste, asnjëri nga personat e përfshirë në to nuk është mbajtur penalisht i përgjegjshëm për veprat penale të cilat pohohet se i kanë kryer.

OSBE-ja është veçanërisht e shqetësuar përkitazi me katër nga gjithsejt pesë rastet e sipërpërmendura, pasi që në to janë të përfshirë zyrtarë të policisë së UNMIK-ut. Në dy raste të cilat kishin ndodhur gjatë verës së vitit 2001, një polic i Jordanisë dhe një i Kenisë ishin nën hetime, përkitazi me dy ngjarje të cilat ishin të ndara nga njëra tjetra, për abuzim seksual të viktimave të mitura, të cilat ishin nën moshën 15 vjeçare. Për nga mbarëvajtja të dyja këto procedura hetimore të inicuar kundër tyre ndryshonin njëra me tjetrën, edhe pse rezultati përfundimtar ishte, në të dyja rastet, se të dyshuarit ishin riadhesuar dhe hetimet asnjëherë nuk ishin kryer gjer në fund.

Në rastin në të cilin ishte i përfshirë zyrtari Jordanez, prokuri publik ndërkombëtar shqyrtoi provat e mbledhura nga policia e UNMIK-ut. Pas dy javë shqyrtimi, prokuror konsideroi se deklarata e dhënë nga ana e viktimës 13 vjeçare nuk ishte e fuqishme dhe e qëndrueshme, edhe pse i dyshuari vetë i dyshuari kishte dhënë katër deklarata kundërshtuese njëra me tjetrën para hetuesve policor. Provat materiale, siç ishin pikat e gjakut dhe mbeturinat e cigares, gjithashtu ishin gjetur në shtëpinë e zbrazët të marrë me qira nga i dyshuari për atë natë. Dhe i dyshuari kishte pranuar, duke e dhënë versionin e tij final lidhur me ngjarjen, se ai e kishte marrë me qira shtëpinë enkas për atë natë dhe se kishte inicuar aktivitetin seksual me viktimën, mirëpo nuk arriti që të zhvilloj marrëdhënie seksuale me viktimën për shkak të disa arsyeve. Përkundër këtyre indikacioneve dhe provave, prokurori ndërkombëtar nuk parashtrroi kërkesën para gjykatësit hetues për të filluar hetimet zyrtare lidhur me rastin, dhe as që kërkoi që t'i hiqet imuniteti zyrtarit në fjalë, në pajtim me nenin 6 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/47. Dhe në fund hetimet ishin mbyllur dhe polici ishte riadhesuar.

Vetëm një muaj pas rastit me policin Jordanez, edhe një rast i ngjashëm ishte sjellur tek prokurori ndërkombëtar. Këtë herë, i dyshuari ishte paraburgosur menjëherë, dhe një ditë menjëherë pas arrestimit të tij ishte kërkuar heqja e imunitetit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së. Polici nga Kenia akuzohej për abuzim seksual të viktimës 14 vjeçare. Rrethanat të cilat e përshkonin veprën penale ndryshonin nga ato që janë përmendur më lartë, pasi që viktima që nga moshja e saj 13 vjeçare ishte eduke punuar si prostitutë. Raportet e policisë dhe deklaratat e dhëna nga viktima në polici ishin të mjaftueshme për të pasur bazë të dyshimit se viktima në të vërtetë ishte viktimë e trafikimit në bazë të nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4. Ajo zbuloi se ishte rekrutuar si prostitutë që nga moshja 13 vjeçare nga gruaja e cila, përmes shtrëngimit dhe abuzimit të pozitës së ndjeshme të viktimës, e kishte shfrytëzuar atë për qëllime të fitimit material. Të njëjtat raporte policore dhe deklarata bënë me dije se polici i UNMIK-ut e kishte dijeni paraprake në lidhje me pozitën e shfrytëzimit seksual të viktimës, por ai vazhdoi të kërkoj shërbime seksuale nga ajo. Këta tregues paraqesin bazë të mjaftueshme për të dyshuar se i dyshuari ka shkelur nenin 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4 (shfrytëzimi dhe sigurimi i shërbimeve seksuale nga personi i cili gjendet në situatë të shfrytëzimit seksual). Sidoqoftë, prokurori publik ndërkombëtar i cili udhëhiqte lëndën në fjalë nuk ngriti ndonjë aktakuzë të bazuar në legjislacionin për trafikim. Në bazë të provave të pakta të cilat u ishin vënë në dispozicion atyre dhe në bazë të akuzave të ngritura për dhunim dhe veprë të panatyrshme seksuale, trupi gjyqësor i përbërë nga gjykatës ndërkombëtar konsideroi se dëshmitë e prezentuara ishin të pamjaftueshme për të ngritur aktakuzën kundër të dyshuarit, dhe si rezultat i kësaj e liruan të pandehurin një muaj pas qëndrimit të tij në paraburgim. I dyshuari shkoi në atdheun e tij dhe, edhe pse kanë kaluar gjashtë muaj nga lirimi i tij, ende nuk mund të shohim ndonjë zhvillim pozitiv në procedurën hetimore të inicuar kundër të dyshuarit dhe edhe sot e kësaj dite prokurori ndërkombëtar nuk ka ngritur aktakuzën kundër personit në fjalë në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2001/4.

Në janar 2002, filluan hetimet kundër një polici nga Egjipti i dyshuar për vrasjen e përkthyeses së tij. Siç pohohet, ai gjithashtu ishte nën hetime për shkak të fshehjes së revoles së konfiskuar e cila i është dhënë në shërbim gjatë veprimit në cilësi zyrtare. Kjo revole duket të ketë qenë arma me të cilën është kryer vrasja. Mëpastaj personit në fjalë i ishte hequr imuniteti nga paraburgimi dhe ndjekja penale pas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara dhe si rezultat i kësaj polici ishte mbajtur në paraburgim gjatë tërë zgjatjes së procedurës hetimore. Është duke shqyrtuar mundësia për transferimin e tij jashtë Kosovës për shkak se gjatë incidentit ai kishte pësuar lëndime të rënda dhe si rezultat i kësaj duhet t'i nënshtrohet intervenimit kirurgjik.

Në mars 2002, kundër një polici austriak kishte filluar procedura hetimore për shkak se siç pohohet polici në fjalë kishte keqtrajtuar një të dyshuar gjatë marrjes së tij në pyetje. Megjithatë, polici arriti që të largohet nga një kompleks shëndetësor austriak, nën rrethana ende të panjohura. Më vonë arriti që të kthehet në Austri. Ikja e policit, sikurse dhe përpjekjet e qeverisë Austriake për të zgjidhur këtë çështje përmes kanaleve diplomatike, kishin gjetur vend edhe në shtypin ndërkombëtar, gjë që kishte shkaktuar shqetësime si në kuadër të Kombeve të Bashkuara ashtu edhe në kuadër të opinionit të gjerë publik.

Pas monitorimit të këtyre rasteve, OSBE-ja është thellë e brengosur për faktin, me përjashtim të të dyshuarit për vrasje nga Egjipti, i cili ende qëndron në paraburgim dhe është nën hetime, ku asnjë prej akuzave më të rënda penale të ngritura kundër të punësuarve ndërkombëtar nuk ishin hetuar si duhet me qëllim të gjetjes së vërtetës për pohimet e bëra. Shkaqet për ndërprerjen e hetimeve, sikurse dhe rrethanat, nën të cilat të dyshuarit ishin lejuar të kthehen në vendlindjet e tyre, ndryshojnë nga rasti në rast. Rezultati përfundimtar i gjithë kësaj ishte se viktimat ishin lënë pa asnjë kompensim, qoftë material apo moral, dhe pa asnjë mjet juridik, përderisa lëndët e tyre kishin mbetur të pakryera. Neni 6 i KEDNJ-së parasheh të drejtën për gjykim dhe për mjete efektive juridike të cilën duhet ta gëzoj çdo

individ në të gjitha rastet civile, administrative dhe penale. Për më tepër, Gjykata Evropiane mbante qëndrim se autoritetet qeveritare kanë për obligim që të sigurojnë, që të gjitha të drejtat e garantuara me KEDNJ, të jenë praktike dhe efektive, dhe jo teorike dhe iluzore.⁷⁸ Në këtë drejtim, këta shembuj të mbajtjes në dyshim të të punësuarve ndërkombëtar në kuadër të KB-së, për kryerjen e veprave të ndryshme penale, jashtë jurisdikcionit të sistemit gjyqësor të Kosovës dëmton rëndë realizimin e të drejtave të viktimës të parapara me KEDNJ-në dhe pushtetin e sistemit gjyqësor për tu marrur me këto raste në kuadër të kompetencave që i kanë. Këto raste e rrisin edhe më tepër ndjenjën e cila mbretëron në kuadër të anëtarëve të gjyqësisë vendëse se anëtarët ndërkombëtarë të UNMIK-ut mund të vepronin pa u ndëshkuar, pa marrë parasysh peshën e veprës penale të cilën e kryejnë. Masat alternative të ndërmarra nga UNMIK-u, siç janë mjetet e brendshme disiplinore kundër të punësuarve në fjalë apo riatdhesimi i tyre, mundësisht, me qëllim të ngritjes së akuzave kundër tyre në vendlindje, janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme, dhe mund të rezultojnë në keqpërdorime pa u mbajtur përgjegjës për veprimet e tyre.

Së fundi, rezultati i këtyre rasteve dëmton reputacionin e KB-së, e madje edhe të Sekretarit të Përgjithshëm. Të gjitha kërkesat për heqjen e imunitetit ishin shqyrtuar shumë shpejt, të cilat vërtetëtonin në secilin rast se nuk mund të ketë imunitet për veprat penale të kryera nga ana e individëve gjatë shërbimit të tyre nëpër misione paqësore. Sidoqoftë, kjo qasje e ndërmarrë nga ana e KB-ve në nivelet e saj më të larta nuk është përmbytur në mënyrë adekuate nga UNMIK-u.

IV. REKOMANDIMET

- Si garancë për pavarësinë gjyqësore, PSSP-ja dhe KFOR-i duhet zyrtarisht të braktisin çdo lloj ndërhyrjeje të ekzekutivit apo legjislativit në fushën e autoritetit gjyqësor, posaçërisht në aspektin e paraburgimit.
- Një prej funksioneve kryesore të sistemit gjyqësor është që në mënyrë të pavarur të rishqyrtoj ligjshmërinë e veprimeve administrative dhe vendimeve të marra nga organet shtetërore. Kjo sforcon pavarësinë gjyqësore dhe për të garanton të drejtën e individit për të parashtruar ankesë kundër vendimeve administrative që kufizojnë apo shkelin të drejtat dhe liritë e tyre. OSBE-ja rekomandon që të ndryshohet Rregullorja e UNMIK-ut 2000/47, ashtu që të lejoj gjykatat vendëse të shqyrtojnë dhe vendosin mbi veprimet e tilla administrative apo vendimet e autoriteteve të UNMIK-ut. Ndryshimi i Rregullores duhet të definoj qartë veprimet e rregullta të ndërmarra nga ana e UNMIK-ut në cilësi të administruesit të këtij vendi, të cilat veprime mëpastaj duhet t'i nënshtrohen shqyrtimeve gjyqësore. Gjykatat gjithashtu duhet të marrin iniciativa përkitazi me interpretimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 në frymën e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe rrjedhimisht të mundësojnë parashtrimin e ankesave kundër akteve administrative të lëshuara nga UNMIK-u dhe si rezultat i kësaj të shqyrtojnë në mënyrë efikase aktet e tilla administrative.
- OSBE-ja rekomandon se pavarësia e KGJPK-së duhet sforcëhet edhe mëtej. Në bazë të kornizës së tanishme, gjetjet e KGJPK-së gjatë sencave dëgjuese disiplinore i dërgohen, në formë të mendimeve këshilldhënëse, PSSP-së i cili paraqet organin më të lartë vendim-marrës në lidhje me këtë çështje. OSBE-ja rekomandon se vendimet e KGJPK-së të marra gjatë procedurave disiplinore duhet të kenë pushtet të plotë për zbatimin e tyre sesa të shërbejnë si rekomandime të cilat i jipen PSSP-së. Për më tepër, OSBE-ja rekomandon se duhet të ndryshohet rregullorja mbi themelimin e KGJPK-së, në aspektin që të gjithë gjykatësit dhe prokurorët të cilët dëgjojnë gjatë procedurave disiplinore të kenë të drejtë t'i shqyrtojnë vendimet e marra gjatë procedurave në fjalë. OSBE-ja

⁷⁸ Shih *Artico kundër. Italisë*, GJEDNJ, 13 maj 1980.

rekomandon emërimin e dy anëtarëve plotësues në kuadër të KGJPK-së ashtu që, prej 11 anëtarëve sa i ka gjithsejt ky organ, mund të krijohen dy seksione – njëra që vepron në instancën e parë dhe e dyta si organ i apelacionit.

- Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar duhet gjithashtu të jenë objekt i mekanizmave të njëjtë për mbajtjen e anëtarëve të gjyqësisë në përgjegjësi disiplinore sikurse që është rasti edhe me anëtarët e tjerë të gjyqësisë. Duke pasur parasysh se KGJPK-ja ka mundësi të rishqyrtimit të vendimeve të tij dhe se gjetjet e tij janë të mveshura me një pushtet për ekzekutimin e vendimeve të tilla dhe nuk kërkojnë miratim formal nga ana e PSSP-së, prandaj edhe gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar duhet të jenë objekt i procedurave disiplinore të inicjuara nga ana e KGJPK-së.
- Duke pasur parasysh mandatin e shkurtë të gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar, për shkak të sistemit të punësimit i cili mbretëron në kuadër të KB-së dhe varësia e zgjatjes së mandateve të tyre nga pëlqimi i dhënë nga qeveritë e shteteve të tyre, zgjatja e kontratave të këtyre zyrtarëve duhet të mirret jashtë autoritetit të DD-së dhe PSSP-së, si garancë e pavarësisë institucionale efektive. Çështja e zgjatjes së kontratave për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar duhet të ngritet për shqyrtim rregullisht pranë KGJPK-së; gjatë së cilës një shqyrtim i tillë duhet të përmbajë të njëjtat kriteret sikurse edhe ato të aplikuara gjatë procedurave të vlerësimit disiplinor.
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 duhet të ndryshohet. Së pari, duhet të miratohen kriteret të sakta për definimin e zbatueshmërisë së rregullores për rastin përkatës. Krahas kësaj, duhet të themelohet një mekanizëm për caktimin e rastësishëm të gjykatësve për lëndët përkatëse; ose, caktimi i zyrtarëve gjyqësor për lëndët përkatëse nuk duhet lënë në diskrecion të DD-së dhe PSSP-së. Gjykatësit dhe prokurorët e caktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 duhet t'i përmbahen dhe nënshtrihen të gjitha garancave procedurale të siguruara nga ligji vendës, përfshirë këtu edhe dispozitat mbi përjashtimin për shkaqe të paanshmërisë.
- Vlerësimi përkitazi me aplikueshmërinë e Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 duhet të jetë transparent dhe i saktë. Kriteret të cilat merren parasysh gjatë vlerësimeve të tilla duhet të miratohen zyrtarisht në formë të urdhëresës administrative. Këtyre kriterëve duhet përmbajtur në mënyrë strikte. Me qëllim të përmirësimit të gjendjes sa i përket mbajtjes në përgjegjësi të zyrtarëve gjyqësor, vendimet e PSSP-së për aplikimin e rregulloreve përkatëse duhet të përmbajnë arsyetim ligjor dhe faktik.

PJESA 4: PARABURGIMI

I. HYRJE

Aspektet teorike dhe praktike të paraburgimit; gjyqësor dhe atij jashtë-gjyqësor, janë adresuar në mënyrë të plotë në tri raportet paraprake mbi sistemin e gjyqësisë penale të hartuara nga OSBE-ja⁷⁹. Kompetencat e PSSP-së dhe KFOR-it për paraburgimin e personave jashtë procesit gjyqësor vazhdimisht ka qenë nën observim të OSBE-së në kuptim të pajtueshmërisë së kësaj praktike me standartet dhe garancat për të drejtat e njeriut. Para adresimit të evolucionit të kësaj praktike të paraburgimit gjatë gjashtë muajve të fundit, OSBE-ja mirëpret ndryshimet që kanë ndodhur përkitazi me Urdhërat Ekzekutiv të PSSP-së dhe mbajtjet në paraburgim me urdhër special të KOMKFOR-it. Gjatë periudhës në të cilën jemi duke raportuar nuk është lëshuar asnjë Urdhër Ekzekutiv nga ana e PSSP-së, gjatë së cilës mund të themi se dhe numri i të paraburgosurve jashtë-gjyqësor nga ana e KFOR-it, është duke u zvogëluar gradualisht, ku nga 100 persona të mbajtur në paraburgim në fillim të shtatorit 2001, në fund të shkurtit 2002 ky numër ra në vetëm një person.

Sidoqoftë, ekzistojnë aspekte praktike dhe ligjore të cilat i përshkojnë politikat e tilla të paraburgimit, të cilat ende ngrisin shqetësime të dukshme dhe kërkojnë analiza të mëtejme. Kjo pjesë do të adresoj vetëm zhvillimet dhe argumentet më të reja të cilat kanë ndodhur në fushën e politikës së paraburgimit nga ana e PSSP-së dhe KFOR-it, pa pasur nevojë të përsërisim komentet e bëra gjatë raporteve paraprake.

II. PARABURGIMI SIPAS URDHËRIT EKZEKUTIV TË PSSP-së

Pushteti i PSSP-së për paraburgimin e personave përkatës jashtë procesit gjyqësor ende ngrit shqetësimet sidomos sa i përket mungesës së bazës juridike dhe mospajtueshmërisë së saj me garancat e të drejtave të njeriut kundër privimit arbitrar nga liria. Pa marrë parasysh faktin se pushteti ekzekutiv i PSSP-së nuk është ushtruar më sa i përket çështjes së paraburgimit, OSBE-ja ende është e shqetësuar sa i përket ruajtjes teorike të këtij koncepti. Siç është përmendur edhe më lartë në këtë raport sidomos kur diskutuam për pavarësinë e gjyqësisë, vetë ekzistimi i kësaj kompetence për paraburgimin e personave përkatës dëmton imazhin e pavarësisë të cilën e posedon gjyqësia dhe gjithashtu edhe besimin që e ka shoqëria kosovare në sundimin e ligjit.

Nga pikëpamja praktike, OSBE-ja është thellë e brengosur përkitazi me evolucionin dhe rezultatin përfundimtar të rastit të fundit në të cilin PSSP-ja ka ushtruar pushtetin e tij të paraburgimit. Tre personat e fundit të mbajtur në paraburgim në bazë të Urdhërit Ekzekutiv të lëshuar nga PSSP-ja ishin pjesëtar të grupit prej katër të dyshuarve, të arrestuar nga organet për zbatimin e ligjit në lidhje me eksplozimimin e bombës në autobusin i cili barte serbë të Kosovës më 18 shkurt 2001. Rezultati i gjithë kësaj ishte se edhe pas më tepër se një vit hetimesh të zhvilluara për këtë rast, që paraqet një vepër penale të rëndë të kryer në territorin e administruar nga KB-të dhe gjatë një operacioni të udhëhequr nga KFOR-i ky rast ende nuk është zgjidhur, për shkak se siç duket ekziston mungesë e provave të qëndrueshme në lidhje me rastin. Intervenimet e PSSP-së renditen nga lëshimi i Urdhërave Ekzekutiv për paraburgimin e të dyshuarve e deri të nxjerrja e Rregullores dhe formimi i komisionit të jashtëzakonshëm i përbërë nga gjykatës të rekrutuar nga PSSP-ja enkas për këtë rast. E tërë kjo ndërhyrje e ekzekutivit arsyetohej me ndjeshmërinë e provave që inkriminonin të dyshuarit. Megjithatë, statusi i tanishëm i provave të lëndës tregon se qëllimi i vërtetë ka qenë që të dyshuarit të mbahen në paraburgim përderisa hetuesit të mbledhin dëshmi të mjaftueshme kundër tyre.

⁷⁹ Për një analizë më përfshirëse të çështjes së paraburgimit, shiko, Shqyrtimi I Tretë, Seksioni 4.

III. PARABURGIMI NGA KFOR-I

Shqyrtimi faktik

Në raportet e saj të mbi drejtësinë penale në Kosovë, OSBE-ja ka adresuar në mënyrë të hollësishme çështjen e pajtueshmërisë së praktikave të paraburgimit të përdorura nga ana e KFOR-it me standartet ndërkombëtare për të drejta e njeriut⁸⁰. Në atë kohë, OSBE-ja kishte shprehur një varg shqetësimesh në lidhje me numrin e madh të personave të paraburgosur jashtë-gjyqësor, të cilët mbaheshin në Qendrën e Paraburgimit në Bondstill (QPB) dhe në të njëjtën kohë kishte vërejtur se personat e paraburgosur nga organet e KFOR-it mbaheshin ende në paraburgim pa kurrfarë baze ligjore dhe pa ndonjë mundësi shqyrtimi të rastit të tyre të paraburgimit nga ndonjë organ gjyqësor.

Pikëpamja e OSBE-së lidhur me autorizimet e KFOR-it për paraburgimin jashtë-gjyqësor të personave të ndryshëm mbetet e pandryshuar, edhe pse ekzistojnë një sërë faktorësh të cilët kanë ndikuar në numrin e personave të mbajtur në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Bondstill dhe procedurat të cilat i kanë paraprirë paraburgimeve të tilla. OSBE-ja është duke vërejtur një zvogëlim të dukshëm në numrin e personave të mbajtur në paraburgim nga ana e KFOR-it. Një gjë duhet të mbahet në mend se një zvogëlim i tillë në numrin e personave të paraburgosur ka të bëjë me përfundimin e dy konflikteve në IRJM dhe Serbinë jugore të cilat ishin arsyeja kryesore se pse kishim një numër kaq të madh të personave të paraburgosur nga ana e KFOR-it gjatë verës së vitit 2001.

OSBE-ja përshëndet sqarimet e bëra nga ana e KFOR-it përkitazi me politikën e tyre të paraburgimit sidomos sigurimi i garancave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në pajtim me standartet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.. Në këtë kontekst, vlen të përmendet edhe lëshimi i Urdhëresës Nr. 42 të KFOR-it⁸¹, të cilat kishin për qëllim të hartojnë politika dhe procedura për ushtrimin e pushtetit nga ana e KOMKFOR-it sa i përket paraburgimit të personave përkatës dhe atë jashtë procesit gjyqësor. Për më tepër, KFOR-i ka filluar dorëzimin e disa formularëve të shkruar secilit të paraburgosur të cilët paraprakisht kishin qenë të mbajtur në paraburgim në Qendrën e Paraburgimit në Bondstill; të cilët formular përmbajnë informata të shkurta në lidhje arsyet e paraburgimit, kohëzgjatjen e paraburgimit dhe procedurat e shqyrtimit të brendshëm nga ana e KFOR-it. Këta formular flasin edhe për të drejtat dhe garancat që duhet t'i gëzojë secili person gjatë qëndrimit të tij në paraburgim, siç është e drejta për angazhimin inter alia të avokatit mbrojtës ku përfshihet e drejta për të pranuar vizita nga familja së paku një herë në javë dhe e drejta për të parashtruar ankesë pranë KFOR-it. Nga intervistat e zhvilluara me personat e mbajtur në QPB, OSBE-ja vëren se formularët ende nuk kanë filluar që të përdoren në praktikë⁸².

Pa marrë parasysh zhvillimet që janë bërë në qasjen e KFOR-it në lidhje me praktikën e paraburgimit, OSBE-ja vazhdon të jetë e brengosur lidhur me aspektet më kryesore të pushtetit të KFOR-it në lidhje me këtë çështje. Procedurat e përcaktuara në bazë të Urdhëresës 42 të KFOR-it, paraqesin një hap përpara drejt sigurimit të një kornize ligjore mbi urdhërimin, rishikimin dhe ndërprerjen e paraburgimit; edhe pse procedurat e tilla nuk i japin bazë ligjore pushtetit të KFOR-it për paraburgimin.

⁸⁰ Shih Shqyrtimi i tretë, Pjesa 4, Titulli III, faqe 37-39.

⁸¹ Urdhëresa 42 e KOMKFOR-it mbi Paraburgimin (mëtuftje e njohur si Urdhëresa 42 e KFOR-it), e datës 9 tetor 2001, zëvendësoj një urdhëresë të fshehtë mbi paraburgimin të njohur me emrin FRAGO 997.

⁸² Që nga tetori 2001, OSBE-ja ka bërë vizita informative në QPB së paku çdo muaj dhe sidomos kur një gjë e tilla është kërkuar nga vetë i paraburgosuri. OSBE-ja ka arritur të intervistoi shumicën e të paraburgosurve të cilët janë mbajtur në QPB që nga tetori 2001.

Bazat për Paraburgim

Politika dhe arsyetimi i paraparë me Urdhëresën 42 të KFOR-it i referohet RKS 1244, si bazë për autoritetin që e ka KFOR-i për paraburgimin e personave të ndryshëm jashtë procedurës gjyqësore. Argumentet mbështetëse të këtij fakti janë po të njëjtat të cilat i janë dhënë OSBE-së edhe gjatë shtatorit 2001, të cilat janë përmendur dhe komentuar në raportet paraprake mbi sistemin e drejtësisë penale.⁸³ Nga formulimi i Urdhëresës, OSBE-ja kupton se KFOR-i ka marrur pushtetin e paraburgimit në bazë të dispozitave të RKS 1244, e cila autorizon prezencën ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë (KFOR) që të përdorë të gjitha mjetet domosdoshme në mënyrë që ti përmbush obligimet e veta. Për më tepër, KFOR-i konsideron se është i autorizuar që të bëjë paraburgimin e njerëzve në mënyrë që të mbështes një “mjedis të sigurtë” në Kosovë, për deri sa “autoritetet civile këtë nuk janë në gjendje apo nuk kanë vullnet për të marrur përgjegjësinë për këtë çështje.”⁸⁴

Duke marrë parasysh argumentet e KFOR-it të theksuara më lart, OSBE-ja vazhdon të mbetet e brengosur se autoriteti i ushtruar nga ana e KFOR-it në çështjet që kanë të bëjnë me paraburgimin nuk është në pajtim me zhvillimet që janë bërë në kuadër të sistemit të drejtësisë në Kosovë dhe situatën e sigurisë në rajon. OSBE-ja kupton se, gjatë fillimit të funksionimit të misionit të UNMIK-ut, ekzistonte nevoja për të pasur një autoritet stabilizues i cili do të mbante sigurinë, siguri kjo e cila nga pikëpamja operacionale ka mundur të ofrohet dhe mbahet vetëm nga ana e KFOR-it. Sidoqoftë, me themelimin e sistemit të rregullt gjyqësor, pa marrë parasysh se ajo sapo kishte filluar të funksiononte, KFOR-i është dashur që në mënyrë graduale të miratojë politikën e tij në lidhje me paraburgimin duke u larguar ndalngadalë nga kjo çështje dhe duke inkurajuar rishqyrtimin e çështjeve të paraburgimit nga ana e organeve të rregullta gjyqësore.

Një shembull goditës i cili paraqet një kundërgjyqësor vizavi konstatimeve të KFOR-it se pushteti i tij mbi paraburgimin mund të justifikohet me nevojën për ruajtjen e klimës së sigurtë dhe të qetë në territorin e dalë nga konflikti, është Administrata e Përkohshme e Kombeve të Bashkuara në Timorin Lindor (UNTAET). Misioni i KB në Timorin Lindor, është konfrontuar me një mjedis të ngjashëm të sigurisë post-konfliktuale sikurse ai në Kosovë. Për më tepër, mandati të cilin UNTAET dhe forcat ushtarake shoqëruese e kishin në Timorin Lindor ishte tejet e ngjashme me mandatin e UNMIK-ut dhe KFOR-it në Kosovë. Sidoqoftë, zgjidhja e miratuar nga Këshilli i Sigurimit të KB për prezencën ushtarake në Timorin Lindor ishte i ndryshëm nga ai i miratuar për Kosovën, pasi që forcat ushtarake ndërkombëtare në Timorin Lindor ishin vënë nën autoritetin civil të PSSP-së dhe asnjëherë nuk kanë ushtruar pushtetin për paraburgim. Nga raportet publike të dhëna nga UNTAET-i dhe organizatat ndërkombëtare të pavarura dhe OJQ-të e ndryshme që operojnë në Timorin Lindor, OSBE-ja kupton se zgjidhja e aplikuar për Timorin Lindor në asnjë mënyrë nuk ka pasur ndikim në mandatin e saj për sigurimin e një mjedisi të qetë dhe sigurtë, mandat ky i cili ishte realizuar me sukses nga ana e prezencës ndërkombëtare ushtarake e cila nuk ka pushtet për paraburgimin e personave përkatës jashtë procesit gjyqësor. Të njëjtat raporte pohojnë se gjyqësia në Timorin Lindor është në fazën e ngjashme të zhvillimit sikurse ajo në Kosovë; sidoqoftë, sistemi gjyqësor në Timorin Lindor asnjëherë nuk është konsideruar si e paaftë për të marrë përgjegjësinë për zbatimin e rendit dhe ligjit, aq sa për të pasur nevojë për organe shtesë në këtë drejtim.⁸⁵

Një argument tjetër i paraqitur nga ana e KFOR-it, që arsyeton vazhdimin e praktikës së paraburgimeve jashtë-gjyqësore, ishte, siq u përmend më lart, se sistemi gjyqësor në Kosovë ende nuk është në gjendje që të mirret me llojet e rasteve të cilat kërkojnë paraburgimet nga ana e KFOR-it. Pas rekomandimeve

⁸³ Letra e 6 shtatorit 2001 e dërguar nga KOMKFOR udhëheqësit të misionit të OSBE-së.

⁸⁴ Shih Urdhëresa 42 e KFOR-it, Pjesa 4/a.

⁸⁵ Shih raportet e Programit të Monitorimit të Sistemit Gjyqësor në Timorin Lindor, (PMSGJ), të bazuar në raportet e OJQ-ve <http://ëëë.jsmp.minihub.org/Resources.htm>.

të bëra nga OSBE-ja për krijimin e një sistemi gjyqësor në të cilin gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtar do të caktohen për rastet më senzitive, KFOR-i kishte shprehur ngurrim në referimin e këtyre rasteve gjyqësive vendëse dhe gjithashtu shprehu pikëpamjen e tij se inteligjenca dhe informatat ushtarake as që bën e as që nuk mundet të ndahet me zyrtarët ndërkombëtar gjyqësor. Një qëndrim i tillë i KFOR-it na bie deri te konkluzioni se KFOR-i përjashton *a priori* çdo shqyrtim civil të praktikës së tyre të paraburgimit, si alternativë për ndërprerjen e praktikës së paraburgimeve jashtë gjyqësore nga ana e tij. KFOR-i mbështet faktin se me inteligjencën ushtarake e cila shërben si bazë për paraburgim, mund të merren vetëm ata zyrtarë të cilëve u jiper drita e gjelbërt nga “NATO”.

Për më tepër duket se një leje e tillë e veçantë nuk mund tu jipet gjykatësve dhe prokurorëve ndërkombëtar për shkaqe ushtarake,. Edhe nëse një gjë e tillë lejohet, ende do të ekzistojnë shqetësime në lidhje me të drejtën e mbrojtjes për të pasur qasje në informatat dhe provat e natyrës së tillë. E drejta për gjykim të drejtë dhe proces të rregullt gjyqësor nuk mund të realizohet në mënyrë të plotë nëse vetëm trupi gjykues apo prokurori kanë qasje dhe njohuri në lidhje me dëshmitë të cilat e ngarkojnë të pandehurin. Ky i fundit, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejt apo përmes avokatit mbrojtës, duhet të jetë në gjendje të kundërshtoj, në mënyrë të kundërt, peshën dhe saktësinë e provave apo informative të tilla. KFOR-i bën me dije se adresimi i çështjes së informatave të sekrete të NATO-s duhet të bëhet nga këshilltarët special, me leje të veçantë të lëshuar nga NATO, të cilët do të emëroheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga drejtori i DD-së ashtu që KFOR-i në këtë mënyrë do të ishte në gjendje të ndaj informata me ta, të cilën gjë nuk do të ishte në gjendje ta bëj me zyrtarët gjyqësor. OSBE-ja është thellë e brengosur se kjo zgjidhje, do të forcoj kontrollin e autoriteteve ekzekutive, mbi atë çka duhet të jetë thjeshtë një çështje gjyqësore, e ajo është urdhërimi dhe shqyrtimi i bazave ligjore të privimit nga liria.

KFOR-i gjithashtu mbështet faktin se sistemi gjyqësor në Kosovë jo vetëm që është i pa përgatitur të marr përgjegjësinë mbi çështjen e paraburgimit, mirëpo edhe legjislacioni ekzistues është e pazhvilluar dhe pamjaftueshme⁸⁶. KFOR-i dha një shembull duke thënë se shumica e të paraburgosurve të mbajtur nga vera e vitit 2001, kanë qenë ose të përfshirë në kalim ilegal të kufirit me IRJM-në dhe Serbinë jugore, apo për armëbajtje pa leje, apo në të dyja këto vepra penale. KFOR-i shpjegoi se nëse kryesit e mundshëm të veprave penale u dorëzohen autoriteteve gjyqësore, atëherë ata nuk do të marrin dënimet e merituar për veprat penale të cilat i kanë kryer dhe një gjë e tillë nuk do të parandaloj keqbërësit, dhe së këndejmi KFOR-i është “i detyruar” që të marr përgjegjësinë mbi këto raste. OSBE-ja konsideron se një arsytim i tillë nuk është i qëndrueshëm posaçërisht sidomos kur kemi parasysh zhvillimeve e fundit të bëra në sistemin e drejtësisë në Kosovë, ku një theks i posaçëm shkon në reformat legjislative.

Rregullorja e fundit e UNMIK-ut mbi kalimin e kufirit, terrorizmin dhe autorizimet për armëbajtje dhe masat kundër krimit të organizuar sigurojnë mjete ligjore për të hetuar dhe ndjekur penalisht personat që janë të dyshuar se janë të përfshirë në aktivitete ilegale në kufi dhe zonat të cilat gjenden në vijën e kufirit administrativ me Kosovën.⁸⁷ Për më tepër, shkalla e dënimit për personat të cilët shpallen fajtor për vepra penale të tilla, siç parashihet me këto Rregullore, paraqet një garancë të mjaftueshme dhe të fortë se dënimi i caktuar kundër këtyre personave do të plotësoj konditën e parandalimit dhe risocializimit që përndryshe është i paraparë para se të jipet një dënim. Veprat penale që kanë të bëjnë me përdorimin apo posedimin ilegal të armëve janë të dënueshme deri në 10 vjet burg, përfshirja në krim të organizuar dënohet deri me 20 vjet burg, përderisa sipas dispozitave mbi terrorizmin parashihet dënimi me burg deri në 40 vjet, derisa legjislacioni i ri mbi kalimin ilegal të kufirit, parasheh dënimin deri në një vit burg, ku procedura gjyqësore në lidhje me këto vepra penale zhvillohet nga ana e

⁸⁶ Këto pikëpamje janë shprehur nga këshilltarët juridik të KFOR-it gjatë një diskutimi në një tryezë të rumbullakët të mbajtur me përfaqësuesit e OSBE-së, Këshillit të Evropës, UNHCS-së dhe PSSP-së të mbajtur në shkurt 2002, ⁸⁷ Rregullorja e UNMIK 2001/10,12,7 &22.

zyrtarëve gjyqësor të emëruar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 dhe kërkesë së ekspeditivitetit⁸⁸. Duke i marrë parasysh të gjitha këto fakte, OSBE-ja konsideron se korniza ekzistuese legjislative siguron garanca të mjaftueshme që personat për të cilët KFOR-i merr përgjegjësi për t'i paraburgosur dhe mbajtur, do të ndiqen penalisht në mënyrë mjaft efektive dhe do të gjykohen nga sistemi i gjyqësisë .

Duke u kthyer tek shqetësimet e mëparshme përkitazi me të drejtat e njeriut, të paraqitura në rastet e kaluara, OSBE-ja vazhdon ta shoh autoritetit për paraburgim që e ka KFOR-i si shkelje të dy garancave themelore kudër privimit arbitrar të lirisë të cilat parashihen edhe me nenin 5 të KEDNJ-së: e drejta për të qenë i informuar në lidhje me arsyet e paraburgimit që nga momenti i arrestimit, si dhe e drejta për tu sjellur sa më shpejtë para zyrtarëve gjyqësor. Mospërfillja e garancave të tilla paraqesin shqetësim të veçantë për OSBE-në, për shkak se ato kanë të bëjnë me të gjitha llojet e paraburgimit, pa marrë parasysh rrethanat të cilat mund të lejojnë derogimin e përkohshëm të të drejtave njeriut. Si KEDNJ-ja ashtu edhe Komisioni Ndër-Amerikan i të Drejtave të Njeriut mbajnë qëndrimin se e drejta për tu sjellur menjëherë para autoriteteve gjyqësore me qëllim të shqyrtimit të çështjes së paraburgimit aplikohet, me kufizime të arsyeshme, në rastet emergjente dhe madje edhe gjatë konfliktit të armatosur.⁸⁹ Në komentet përkitazi me të drejtat dhe statusin e të burgosurve të mbajtur nga Forcat Amerikane në Guantanamo Bay, Kuba, pas konfliktit të armatosur në Afganistan, Komisioni Inter-Amerikan mbi të Drejtat e Njeriut theksoi se përderisa *disa të drejta të njeriut mund të hiqen apo të zvoglohen gjatë kohës së luftës apo situatave emergjente, standardet tjera të drejtave të njeriut vazhdojnë të aplikohen në mënyrë të plotë gjatë gjithë kohës. Instrumentet relevante për trajtimin e personave të privuar nga liria e tyre përfshijnë [...] Standartet e KB-ve Mbi Rregullat Minimale për Trajtimin e të Burgosurve, anëtare të së cilë janë bërë edhe Shtetet e Bashkuara në vitin 1994.*⁹⁰ Së këndejmi edhe Standartet e KB-së mbi Rregullat Minimale mbi Trajtimin e të Burgosurve përmbajnë një seksion të posaçëm E që i referohet personave të arrestuar apo paraburgosur pa akuzë, sikurse që është statusi i personave të cilët mbahen në paraburgim nga ana e KFOR-it. Pjesa E fillon duke theksuar se *pa i paragjykuar dispozitat e Nenit 9 të Konventës Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike [...], duke vendosur kështu një kategori të veçantë të paraburgosurve nën mbrojtjen të garancave ligjore dhe mjeteve juridike të cilat parashihen me Nenin 9 . Këto garanca përfshijnë të drejtën e një individi për tu sjellur menjëherë para gjyqtarit apo ndonjë zyrtari i cili është autorizuar me ligj për të ushtruar pushtetin gjyqësor. Neni 9 gjithashtu thekson se secili që është i privuar nga liria si rezultat i arrestimit apo paraburgimit, do të jetë i autorizuar të inicioj procedurë gjyqësore para gjykatës, në mënyrë që Gjykata të vendosë pa vonesë lidhur me ligjshmërinë e paraburgimit, dhe të vendos për lirimin nëse paraburgimi ka qenë jo i ligjshëm.*

⁸⁸ Shih Rregulloren e UNMIK-ut 2001/10, Neni 5.2.

⁸⁹ Kjo u bë e qartë në rastin e *Coard et al. kundër. Shteteve të Bashkuara*, vendosur më 29 shtator 1999, nga ana e Komisionit Inter-Amerikan të Drejtave të Njeriut. Në këtë rast që ka të bëjë me paraburgimin e civilëve nga ana e Ushtrisë Amerikane gjatë invazionit të Grenadës, Shtetet e Bashkuara kanë mbështetur faktin se se ata i janë përmbajtur obligimeve që t'i paraqesin të paraburgosurit para gjykatës, duke i dorëzuar ata në gjykatë dy javë pas paraburgimit të tyre. Komisioni nuk u pajtua me faktin se paraburgimi nga ana e Ushtrisë për dy javë ishte mjaft i gjatë, edhe pse ushtria Amerikane ka qenë në një periudhë e përfshirë në konfliktin e armatosur. Rasti 10.951 Raporti Nr. 109/99. Shiko gjithashtu *Brannigan dhe McBride kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ, 26 maj 1993, ku GJEDNJ-ja parasheh se periudha prej shtatë ditësh e paraburgimit deri sa i paraburgosuri të silltet bie nën kompetencat të cilat mund t'i merr qeveria gjatë situatës emergjente, duke marrë parasysh faktin se në Irlandën Veriore, të gjithë të paraburgosurit në përgjithësi kishin të drejtën Habeas që nga momenti i paraburgimit të tyre. Në Aksoy kundër Turqisë, GJEDNJ-ja, më 18 dhjetor 1996 Gjykata Evropiane konsideroi se 14 ditë paraburgimi pa u sjellur te gjyqëtari janë shumë, sidomos pasi që atje nuk kishte mjet juridik të habeas corpus, edhe pse regjioni ishte i përfshirë në konflikt të armatosur.

⁹⁰ Dokumenti i Konventës së Gjenevës dhe personave të mbajtur nga forcat e SHBA-ve, Human Rights Watch, Shtypi i Human Rights Watch-it, 29 janar 2002.

Argumentet dhe shembujt e përmendur më lartë vërtetojnë se situata e sigurisë të cilat janë shumë më të rënda se ajo në Kosovë nuk e përjashtojnë realizimin e garancave për të drejtat e njeriut. Andaj, konstatimi i KFOR-it se pushteti i tij për paraburgimin e personave pa shqyrtim gjyqësor bazohet dhe arsyetohet me sigurimin e një mjedisi të qetë dhe të sigurtë në Kosovë, asesi nuk mund të pranohet.

OSBE-ja konsideron se formulari i veçantë të cilën e parasheh Urdhëresa 42 dhe e cila u jipet të paraburgosurve menjëherë pas arrestimit të tyre ofron informata të pamjaftueshme në lidhje me bazat për një paraburgim të tillë dhe në atë në kuptim të Nenit 5 të KEDNJ-së.⁹¹ Ky formular thjeshtë thekson se i paraburgosuri mbahet në paraburgim për shkak se ai apo ajo paraqet një kërcënim për sigurinë dhe qetësinë në Kosovë, pa treguar arsytet apo rrethanat faktike me të cilat ngarkohet individi i paraburgosur nga ana e KFOR-it.

Praktika e paraburgimit 72-orësh nga ana e KFOR-it

Urdhëresa 42 e KFOR-it, nuk i referohet vetëm pushtetit që e ka KOMKFOR-i ka për paraburgimin jashtëgjyqësor të personave. Ajo gjithashtu i jep Komandantit regjional të KFOR-it (MNB) pushtet për të paraburgosur personat e ndryshëm në periudhë kohore deri në 72 orë, pa pasur nevojë ta informoj KOMKFOR-in përpos nëse paraburgimi kalon kufirin prej 72-orësve. Bazat dhe arsyetimi për një pushtet të tillë janë po ato të njëjtat sikurse edhe për paraburgimet e kryera me urdhër të KOMKFOR-it dhe, mu për këtë arsye, OSBE-ja nuk do të përsëris komentet që kanë të bëjnë me këtë çështje. Sidoqoftë, ekzistojnë një sërë apsektesh që janë të ndërlidhura me këtë praktikë dhe të cilët kërkojnë një analizë më të hollësishme.

Së pari, OSBE-ja është e shqetësuar se vetë ekzistenca e një pushteti të tillë bën me dije se KFOR-i, në vend që të filloj në mënyrë graduale të përmbahet nga praktika e tij e paraburgimit me qëllim që ta braktis atë praktikë plotësisht në fund, ajo në të kundërtën është duke e zhvilluar atë edhe më shumë. . Pushteti i KFOR-it për paraburgimin e personave të ndryshëm jashtë procedurës gjyqësore gjithmonë ka qenë i prezentuar si një zgjidhje e jashtëzakonshme apo si një masë e fundit, dhe, si rrjedhojë e kësaj një gjë e tillë është perceptuar si një pushtet të cilin e ka vetëm KOMKFOR-i. Fakti se KOMKFOR-i i cili është i vetmi nivel komandues i cili e ka pushtetin për të urdhëruar paraburgimet e tilla, ka ofruar garanca shtesë se masat e tilla do të mirren vetëm në raste tejet tejet ekstreme. Duke zgjeruar edhe më tepër këtë pushtet edhe tek komandantët regjional, madje edhe nëse është paraburgimi është vetëm 72 orë, dhe duke lejuar që një pushtet i tillë të jetë i pakontrolluar dhe i paraportuar KOMKFOR-it, shkakton shqetësime në lidhur me përpjekjet e KFOR-it për të marrur më shumë përgjegjësi nga fusha e zbatimit të ligjit. Aktualisht KFOR LEGAD ka pranuar se praktika e tillë është shikuar me syrin e përputhshmërisë së saj me politikën e paraburgimit 72 orësh nga ana e policisë.⁹² Sipas ligjit vendës dhe atij mbi të drejtat ndërkombëtare të njeriut, paraburgimet e shkurta nga ana organeve për zbatimin e ligjit janë të udhëhequra nga garancat tejet strikte që kanë të bëjnë me të drejtat e të paraburgosurve. Ekzistojnë rrethana të caktuara në bazë të të cilave personi mund të mbahet në paraburgim nga policia; ato në veti përfshijnë edhe paraburgimin e personit me qëllim të verifikimit të identitetit të tij, pastaj paraburgimin me qëllim të parandalimit të rrezikut nga ikja apo rrezikut nga shkatërrimi i provave. Për më tepër, personi i mbajtur në paraburgim nga ana e policisë duhet të gëzoj një sërë të drejtash të cilat janë të definuara si me ligjin vendës ashtu edhe me atë ndërkombëtar në lidhje me të drejtat e njeriut. OSBE-ja është e brengosur se këto të drejta, e posaçërisht e drejta në avokat mbrojtës dhe e drejta në heshtje nuk janë në mënyrë efektive të vështruara, sidomos gjatë paraburgimeve 72- orëshe nga ana e

⁹¹ Shih Jecius kundër. Lituanisë, KEDNJ, 31 korrik 2000, paragrafi 51.

⁹² Sipas informatave të marra nga KFOR LEGAD, mesatarja e personave të mbajtur në paraburgim me urdhërin e komandantit të Brigadës Shumëkombëshe është 10 persona në muaj.

KFOR-it. Këta të paraburgosur janë marrë në pyetje nga ana e KFOR-it, pa iu përmbajtur asnjërës nga garancat e sipërpërmendur. Një preokupim tjetërr është se disa individ janë paraburgosur sipas dispozitave të paraburgimit 72 orësh, vetëm për qëllim të mbledhjes së informatave.⁹³

Së dyti, përderisa ushtrimi i pushtetit nga ana e KOMKFOR-it, kohëve të fundit është bërë më transparent dhe organizatat e interesuara ndërkombëtare tani janë në gjendje të pranojnë informata mbi këta të paraburgosur si dhe t'ju qasen atyre, praktika e paraburgimit 72-orësh shpeshherë i ik detektimit si nga ana e KOMKFOR-it ashtu edhe nga bashkësia ndërkombëtare. Procedura e zakonshme nëpërmjet të së cilës organizatat ndërkombëtare, siç janë OSBE-ja dhe KNKK-ja, kanë qasje në qendrat e paraburgimit të KFOR-it kërkon një konsultim të rregullt të listave të paraburgimit, një lajmërim paraprak që i bëhet KFOR-it në lidhje me vizitën, dhe miratimin dhe procesin e njoftimit e cila zakonisht zgjat më shumë se 72-orë, duke bërë të pamundshme mbajtjen në përgjegjësi të zyrtarëve që kanë urdhëruar paraburgimin.

Si rezultat i kësaj, OSBE-ja shpreh shqetësimet e saj lidhur me praktikën e paraburgimit 72 orësh, e cila e vendos KFOR-in, sidomos gjatë ushtrimit të autorizimeve të tij për të paraburgosur, siç parashihet edhe me RKS 1244, në një pozitë shumë afër arbitraritetit dhe mospërfilljes së parimeve themelore dhe garancave të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

IV. REKOMANDIMET

OSBE-ja gjithmonë ka ofruar rekomandime praktike me qëllim të sigurimit të dorëzimit të qëndrueshëm të kompetencave të KFOR-it nga fusha e zbatimit të ligjit organeve për zbatimin e ligjit të UNMIK-ut dhe sistemit gjyqësor. Zgjidhjet ishin identifikuar me qëllim që të sigurohet që hetimet dhe mbledhja e informatave të posaçme të bëhen nga ana e zyrtarëve për zbatimin e ligjit të UNMIK-ut. Asnjë nga këto rekomandime nuk janë marrë efektivisht parasysh nga KFOR-i.

- Duke pasur parasysh argumentet e mësipërme, OSBE-ja rekomandon se KFOR-i duhet të ndërprejë praktikën e tij të paraburgimit dhe zyrtarisht të braktisë autoritetin e tij në këtë fushë.

PJESA V: ÇËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL

OSBE-ja në mënyrë të konstante ka potencuar në raportet saj mbi sistemin e gjyqësisë se numri më i madh i të paraburgosurve në Kosovë ndodhet në kuadër të sistemit të shëndetit mental. Fatkeqësisht,

⁹³ Pjesa 4 (b) e Urdhëresës 42 të KFOR-it parasheh se *vet fakti që një person mund të posedojë informacion të vlefshëm nuk është bazë e mjaftueshme për paraburgim*. Intervistat që zhvilloi OSBE-ja me individët të cilët janë mbajtur në paraburgim nga ana e KFOR-it për 72 orë bën me dije që të paraburgosurit janë pyetur vetëm për çështjet që kanë qenë të rëndësishme për mbledhjen e informatave.

ajo gjithashtu paraqet një fushë të laraburgimit në të cilën është arritur më së paku përparim sa i përket adresimit të çështjes së privimit të paligjshëm nga liria. Në këtë raport OSBE-ja do të shtjelloj problemet që kanë të bëjnë me personat më paafësi mentale dhe sistemin e drejtësisë, e cila i takon tri fushave kryesore; përdorimi i paraburgimit; trajtimi i të burgosurve të ligjshëm; dhe përdorimi e ekspertizës së shëndetit mental përbrenda sistemit të drejtësisë penale.

I. PARABURGIMI

Të sëmurit mental janë të paraburgosurit të cilët zakonisht harrohen nga shumë sisteme të drejtësisë. Në fakt, paraburgimi i të sëmurëve mental shpeshherë është e shënuar nën ndonjë tjetër emër - p.sh. detyrim, profilizim, pranim jo vullnetar - që në fakt maskojnë faktin se ata persona janë të privuar nga liria e tyre. Në Kosovë çështja e paraburgimit është bërë një problem akut për shkak të ekzistencës së “institucionit social” në Shtime, ku personat për vite të tëra qëndrojnë në paraburgim pa pranuar ndonjë trajtim apo intervenim nga gjykata. Për më tepër, një numër i madh i personave janë të paraburgosur – për qellime të trajtimit mjekësor, mirëpo ende pa intervenim juridik – në Spitalin e Prishtinës në Repartin Psikiatrik.

Institucioni Special në Shtimje

Numri më i madh i të paraburgosurve mental mbetet në Shtime në Institutin Special për të Retarduarit Mental.⁹⁴ Sipas Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale, e cila është përgjegjëse për këtë Institut, që nga 11 marsi 2002 kanë qenë 230 banorë të këtij Instituti nga të cilët 135 ishin serb (shumica nga Serbia), 6 prej tyre ishin kroat, 5 maqedon, dhe 10 hungarez. 20 fëmijë ishin larguar nga ky institut dhe ishin vendosur në një “shtëpi të përkohshme” në Llapje Sellë dhe në qytetin e Shtimes (për fëmijët shqiptar dhe serb), edhe pse statusi i tyre juridik vazhdon të jetë i papërcaktuar.

Siç u tha më herët, të paraburgosurit në Shtime janë në pozitë të palakmueshme. Për personat e paraburgosur me probleme mentale, sipas ligjit ndërkombëtar, paraburgimi do të duhet të përdorej vetëm si një apo kur trajtimi mjekësor nuk është i mundur.⁹⁵ Të paraburgosurit në Shtimje nuk janë raste të sëmundjeve mentale, por në fakt janë “raste sociale” të vendosur në institucion shoqëror nga gardianët dhe të lënë, të mbyllur, me vite pa ndonjë trajtim mjekësor apo shqyrtim gjyqësor të rasteve të tyre.

Në raportin e fundit mbi sistemin e drejtësisë penale⁹⁶, OSBE-ja përmend edhe zhvillimet pozitive që janë bërë në aspektin e arranzhimit të shqyrtimeve gjyqësore për paraburgimin e tyre. Departamenti i atëhershëm i Shëndetit dhe Mirëqenies Sociale në vitin 2001, lëshoi një Urdhëresë Administrative e cila konfirmonte se asnjë person nuk mund të paraburgoset në këtë institucion pa vendim paraprak të gjykatës. Një gjë e tillë do të thotë se instituti atëherë kishte shqyrtuar të gjitha lëndët, duke i informuar të gjithë të burgosurit aty se janë të lirë dhe se mund t'i përcjellin lëndët e tyre për “paraburgim” gjykatave të cilat pastaj do të lëshonin urdhër për paraburgim kurdo që të konsideronin se një gjë e tillë është e nevojshme. Megjithatë, një gjë e tillë kurrë nuk ndodhi. Instituti filloi të shqyrtoi rastet me ndihmën e “Ekipit për Deinstitutionalizim”, ekip ky i cili vlerëson nevojat e personave të tillë, mirëpo ky proces si duket është mjaft i gjatë dhe i ngadalshëm. Deri tani, ky Ekip ka shqyrtuar 65 nga 230

⁹⁴ Shih OSBE Raporti mbi Sistemin e Drejtësisë Penale, tetor 2001 për më tepër detaje.

⁹⁵ Shih Parimet e KB Për Mbrojtjen e Personave me Sëmundje Mentale dhe Përparimi i Trajtimit të Sëmundjeve Mentale, Parimi 16; *Ënterëerp kundër Holandës*, GjEDNj, 24 tetor 1979.

⁹⁶ Shih Shqyrtimi i tretë, Pjesa 4, Titulli IV, faqe 41-42.

raste, dhe për shumicën e tyre u prua vendimi⁹⁷ se “nuk ka nevojë të qëndrojnë në paraburgim”. Këta persona janë njoftuar se janë të lirë dhe se mund të shkojnë, por asnjëri nga ta nuk e ka bërë një gjë të tillë, më së tepërmi për shkak se shumica prej tyre janë serb të cilët dëshirojnë të kthehen në Serbi. Megjithatë, Ministria vlerëson që së paku 60 persona në Institut duhet të qëndrojnë në paraburgimin në mënyrë që të marrin trajtim mjekësor dhe që ta mbrojnë veten dhe të tjerët.

Institucioni i dorëzoi të gjitha lëndët gjykatës përkatëse (Gjykatës Komunale në Ferizaj) duke kërkuar urdhër për paraburgim në bazë të Ligjit të Procedurës Jokontestimore të vitit 1986 (LPJK). Megjithatë, edhe pse lëndët e para i ishin përcjellur sistemit gjyqësor në janar të vitit 2001, gjykatat ende nuk i kanë shqyrtuar ato apo pruar ndonjë vendim në lidhje me asnjërin nga këto raste.⁹⁸ Ky ngurrim i gjykatave për tu marrur me këto raste duket se buron nga fakti se personat në fjalë kanë qëndruar në paraburgim në Shtimje pa përfshirje të gjykatave në këtë proces (pra në mënyrë të paligjshme) kështu që, gjykatat tani nuk dinë se si t'i shqyrtojnë lëndët në fjalë dhe çfarë vendimi të bijnë në lidhje me to. Në fakt, institucioni i Shtimjes paraqet një institucion social i cili në bazë të ligjit ekzistues nuk ka pushtet për t'i mbajtur personat e ndryshëm në paraburgim, ligj ky i cili parasheh vetëm paraburgimin për arsye të shëndetit mental dhe atë në një “institucion neuropsikiatrik”. Gjykatat mund të kenë ngurrim që të deklarojnë një gjë të tillë. Ato gjithashtu duket të kenë ngurrim në zbatimin e drejtpërdrejt të dispozitave themelore të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut që çdo person i cili mbahet në paraburgim ka të drejtë që lënda e tij të shqyrtohet nga gjykata e cila ka pushtet për të urdhëruar lirimin e tij/saj⁹⁹ Gjykatësit të cilët nuk kanë përvojë të mjaftueshme për tu marrur me lëndët e shëndetit mental, mund të pushtohen nga rastet të cilat edhe ashtu duket të jenë raste majft komplekse. Nuk ka gjykatës apo avokat mbrojtës në Kosovë të cilët janë specialistë në fushën e shëndetit mental, dhe duke marrë parasysh numrin e madh të personave me probleme mentale, siç duket ligjet nga kjo fushë janë përdorur mjaft rrallë. Përkundër këtyre problemeve, duke dështuar të japin vendime për atë se a munden personat individual të paraburgosen nga ana e këtij insitucioni, gjykatat janë ende duke dështuar sa i përket parandalimit të paraburgimit arbitrar. Krahas kësaj, përderisa të mos kemi urdhëresat e lëshuar nga ana e gjykatave në lidhje me këtë çështje, institucioni në fjalë është duke i mbajtur këta persona në paraburgim në mënyrë të paligjshme.

Ngurrimi i gjykatave për t'i adresuar këto çështje është e shtyer edhe nga problemet e shumta që burojnë nga vetë LPJK-ja. Ky ligj nuk përcakton bazat sipas të cilave gjykatat mund të urdhërojnë paraburgimin, lejon që secila gjykatë të dëgjoj një rast brenda periudhës kohore prej 15 ditëve, dhe gjithashtu përcakton kërkesat procedurale të cilat për momentin janë shumë vështirë për tu përmbushur (p.sh nevojiten tri mendime mjeksore, kur dihet se ekzistojnë vetëm 31 psikolog në tërë Kosovën). Draft rregullorja mbi privimin e lirisë dhe trajtimin e detyrueshëm të të sëmurëve mental, e hartuar nga një grup punues për të cilin kemi bërë fjalë edhe gjatë raportit të kaluar adreson të gjitha problemet e sipërpërmendura, duke ofruar baza dhe procedura të qarta për shqyrtimin e rasteve të paraburgimit, si dhe për Kolegjet e Shëndetit Mental në gjykata. Ajo gjithashtu i ofron institucionit të Shtimjes kompetenca të përkohshme për paraburgimin e personave të cilët duhet të mbahen në paraburgim në këtë institucion për t'ju nënshtruar trajtimit mjekësor përderisa të kërkohet gjetja e ndonjë zgjidhje afatgjate. Draft rregullorja në fjalë i është dorëzuar Zyres së Këshilltarit Juridik në tetor të vitit 2001 që në të vërtetë paraqet hapin e fundit para nxjerrjes së saj, përderisa kohëve të fundit OSBE-ja është informuar se çështja e nxjerrjes së kësaj rregullore do të shqyrtohet si prioritare nga ana e Zyrës së Këshilltarit Juridik.¹⁰⁰ Nxjerrja e kësaj rregulloreje do të paraqes një zhvillim tejet të madh, pasi që

⁹⁷ Ministria e Punës dhe Mirqenies Sociale nuk ishte në gjendje të jap shifra ekzakte në lidhje me këtë çështje.

⁹⁸ Më në fund një rast u caktua për dëgjim më 14 mars 2002, por ky dëgjim mëpastaj u shtye nga ana e gjykatës.

⁹⁹ Neni 5(4) GjEDNj, Neni 9 KNDCP.

¹⁰⁰ Në mars të vitit 2002 (jashtë periudhës kohore kur është përpiluar ky raport) DD-ja dhe OSBE-ja ishin informuar nga ana e ZKJ-së se nga ky moment kjo rregullore do të jetë prioritet.

mungesa e një ligji të qartë dhe funksional ka qenë shkaktari kryesor për paraburgimet e vazhdueshme të paligjshme që janë bërë në Shtime. Pa këtë, gjykatësit janë duke u detyruar që të aplikojnë një ligj të cilin ata kurrë nuk e kanë përdorur dhe i cili është thujse jo-funksional.

Krahas kësaj, edhe një “Institut Social” tjetër ekziston në Kosovë, e që është Shtëpia e Pleqve në Prishtinë me përafërsisht 100 banorë. Ky institucion megjithatë, nga aspekti juridik paraqet një institucion të ligjshëm pa persona të cilët mbahen në paraburgim në kuadër të saj. Drejtori i këtij institucioni ka thënë se edhe pse kanë banorë me probleme mentale të cilët banojnë në këtë institucion, ata kanë të drejtë shkojnë dhe ta lëshojnë këtë institucion kurdo që të dëshirojnë. Megjithatë ai informoi OSBE-në se disa banorë të këtij institucioni u detyruan që t’i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm mjekësor në kuadër të Spitalit të Prishtinës, pa intervenim gjyqësor (shih mëposhtë).

Spitali i Prishtinës

Edhe një lloj tjetër i paraburgimit është bërë dukuri në spitalin e Prishtinës. Më parë personat në Kosovë që është dashur të paraburgosen dhe të trajtohen janë dërguar në spitale në pjesët tjera të ish-Jugosllavisë (siç ishte Shkupi dhe Nishi). Megjithatë, me keqësimin e sistemit shëndetësor nëpër këto spitale gjatë vitit 1999, tani rastet më akute dërgohen në spitalin e Prishtinës, i cili nuk është disajnuar që t’i pranoj ata. Personat të cilët duhet të paraburgosen me qëllim që t’i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm, mbahen në këtë spital pa intervenim ligjor.

Spitali ka informuar OSBE-në se posedon me 75 shtretër në repartin e saj prikiatrik, por në përgjithësi në këtë repart janë të shtrirë rreth 100 pacientë. Nga të gjithë këta, vlersohet se mbi 50% (normalisht mbi 50 në çdo kohë) janë të sëmurë rëndë dhe për këtë arsye është dashur që të paraburgosen, në mënyrë që t’i nënshtrohen trajtimit të detyrueshëm. Spitali informoj OSBE-në që edhe pse reparti psikiatrik ishte i “hapur”¹⁰¹, personat të cilët kishin nevojë për trajtim të detyrueshëm ishin “të kontrolluar në mënyrë kimike”, psh. dhunshëm duke i injektuar me droga. Për këtë arsye një gjë e tillë paraqet paraburgim në të njëjtën mënyrë sikurse që është edhe përdorimi i dyerve të mbyllura apo gardianëve.

Sikurse edhe në Institucionin e Shtimes, asnjë ligj nuk përdoret për të qeverisur çështjen e paraburgimit/trajtimit të detyruar në spital. Me këtë rast spitali kishte informuar OSBE-në që LPJK edhe pse ekziston në letër për të vendosur mbi çështjet që kanë të bëjnë me privimin e personave nga liria, është përdorur shumë rrallë gjatë periudhës para vitit 1999, gjatë së cilës periudhë kishim të bëjmë me personat të cilët ishin paraburgosur me urdhër të psikiatrit e jo të gjyqit përkatës. Situata edhe sot e kësaj dite mbetet e njëjtë. Udhëheqësia e spitalit theksoi se ekziston nevoja urgjente për trajnimin e stafit të tij sidomos në fushën e ligjit që ka të bëjë me paraburgimin dhe trajtimin e detyrueshëm. Sot situata është madje edhe më e vështirë se ajo e para vitit 1999, për shkak se personat në fjalë mbahen në paraburgim në një spital i cili nuk është i disajnuar që të merret me këto çështje, dhe së këndejmi asaj i mungojnë zonat e sigurta, apo stafi i sigurisë dhe gjithashtu edhe urdhërat e gjyqit të cilat deklarojnë se një person është i paraburgosur dhe duhet t’i nënshtrohet trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Si rezultat i kësaj ishte edhe vendosja e policisë së UNMIK-ut në dy dhoma parapraakisht të mbyllura (shih mëposhtë).

¹⁰¹ Gjatë vizitës që ia bëri OSBE-ja këtij reparti, dera e cila shpiente për në repart ishte e mbyllur. Spitali tha se kjo ishte për të kontrolluar hyrjen e vizitorëve, jo për të kufizuar lëvizjen e pacientëve.

Edhe katër spitalet tjera në Kosovë (Pejë, Prizren, Gjakovë dhe Mitrovicë) kanë repartet e tyre psikiatrike, mirëpo tre prej tyre kanë informuar OSBE-në se nuk i paraburgosin pacientët e tyre mirëpo pacientët e tillë i dërgojnë në Spitalin e Prishtinës.

Përdorimi i “masave të sigurisë” në kuadër të sistemit të drejtësisë penale

Raporti paraprak i OSBE-së potenconte një sërë problemesh të cilat buronin nga përdorimi i “masave të sigurisë” nga ana e sistemit të drejtësisë penale për urdhërimin e paraburgimit për personat të cilët duhet t’i nënshtrohen trajtimit psikiatrik. Një gjë e tillë edhe vazhdon të jetë problem, sepse edhe pse personat në fjalë janë të paraburgosur me urdhër të gjyqit, fakti i cili i përshkon këto raste është se gjykatësit nëpër gjyqet penale kanë urdhëruar trajtimin mjekësor në lëminë në të cilën ata nuk janë ekspert. Për më tepër, duket se në shumicën e rasteve, urdhërat e tillë janë dhënë kur janë tërhequr akuzat dhe kur personi përkatës është shpallur si penalisht i papërgjegjshëm – psh. nuk janë të denuar për ndonjë vepër penale dhe nuk gkenden më në kuadër të sistemit të drejtësisë penale. Personat e tillë kanë nevojë për trajtim mjekësor në spital.

OSBE-ja e kupton faktin se deri në fund të shkurtit 2002, 8 persona të tillë janë mbajtur në sistemin e burgjeve mu për shkak të këtyre “masave të sigurisë”.¹⁰² Një gjë e tillë tregon se urdhërat e tillë dështojnë që të sigurojnë se personat të cilët duhet t’i nënshtrohen trajtimit mjekësor në kuadër të sistemit shëndetësor, përfundojnë në sistemin e burgjeve së bashku me kriminel të cilët janë shpallur fajtor për kryerjen e veprave penale. Arsyeja e përdorimit të urdhërave të tillë buron nga mungesa e njohurive në mesin e anëtarëve të sistemit të drejtësisë penale në lidhje me ligjin civil shfaqet të jetë mungesa e dijes përbrenda sistemit të gjyqësisë penale në ligjin civil mbi paraburgimin dhe trajtimin mjekësor, si dhe nga mungesa e hapësirës së sigurtë ku do të vendoseshin këta persona në kuadër të sistemit të spitaleve. Në fakt paraburgimi i personave të tillë nëpër burgje mund të jetë i paligjshëm, pasi që ligji ekzistues vendës parasheh urdhërimin e trajtimit psikiatrik të detyrueshëm dhe paraburgimit në kuadër të një **institucioni mjekësor**.¹⁰³

Implementimi i projekt-rregullores mbi privimin nga liria dhe trajtimin/shërimin e detyrueshëm, dhe Projekti i Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit Penal do të zgjidhnin këtë problem, duke hequr pushtetin të cilin e kanë gjykatat penale sa i përket urdhërimit të paraburgimit për qëllime të trajtimit psikiatrik të detyrueshëm (jo për qëllime penale) dhe duke e transferuar këtë pushtet në gjyqet civile të cilave edhe ju takon. Siç u tha edhe më lartë, ekziston një përparim minimal sa i përket implementimit të ligjeve në fjalë.

II. TRAJTIMI I TË BURGOSURVE ME NEVOJA TË SHËNDETIT MENTAL

Një shqetësim tjetër nga ai i paraburgimit është çështja e trajtimit të personave të burgosur në mënyrë të kundërligjshme sipas sistemit të gjyqësisë penale, e të cilët kanë nevojë për shërim/trajtim mental. Autoritetet e burgjeve dhe të shëndetësisë janë të obliguar të sigurojnë që të burgosurit e tillë të

¹⁰² Të gjithë këta janë të vendosur në qendrën e paraburgimit në Lipjan, kanë informuar OSBE-në se pesë prej tyre janë dërguar për arsye të shëndetit mental, përderisa dy prej tyre ishin narkoman të cilët ishin dërguar aty me urdhër të gjyqit për arsye të trajtimit mjekësor të detyrueshëm, trajtim ky i cili nuk mund të jipet në burg.

¹⁰³ Neni 63 LLP RFJ-së. Edhe pse UNMIK-u ka caktuar qendrën e paraburgimit në Lipjan si institucion mjekësor se në bazë të asaj çka parasheh ky nen, institucioni në fjalë është në gjendje të ofroj kujdes shëndetësor të kufizuar. Gjer më tani asnjë avokat nuk është munduar të parashtroj ndonjë ankesë kundër vendimeve të gjyqit për paraburgimin e personave të tillë.

pranojnë shkallën më të lartë të përkujdesit shëndetësor.¹⁰⁴ Për personat e sëmurë rëndë, kjo duhet të bëhet në një ambient terapeutik të spitalit, duke siguruar kushte të duhura të sigurisë.¹⁰⁵

Për këtë arsye ajo që është e nevojshme është një marrëveshje mes Shtyllës së I-rë dhe autoriteteve të shëndetësisë për dhëjen sistematike të shërbimeve shëndetësore nëpër burgje¹⁰⁶ si dhe caktimin e masave adekuate të sigurisë, të profilit të ulët, nëpër spitale, për të burgosurit që kanë nevojë për t'u shëruar aty. Rezultati ka qenë i tillë që, së pari disa të burgosur kanë pasur vizita vetëm sporadike nga psikiatrët. Problem i mëtutjeshëm është mungesa e çfarëdo ligji në Kosovë për imponimin e, parasëgjithash, shërimit/trajtimit të obligueshëm, se sa paraburgimit, gjë që për qendrat e paraburgimit është e paqartë nëse ato mund të imponojnë shërim/trajtim të obligueshëm për personat që duken të kenë nevojë për të.¹⁰⁷ Kjo është edhe një çështje që është adresuar në projekt-rregulloren.

Shqetësim i thellë është edhe marrja efektive, nga ana e Policisë së UMIK-ut, e të dy dhomave në Spitalin e Prishtinës në Repartin e Psikiatrisë, për t'i përdorur të njëjtat për të "burgosurit". Spitali kishte informuar OSBE-në se, në fund të vitit 2001, Policia e UNMIK-ut i kishte njoftuar se atyre iu duhet t'i kenë dy dhoma në disponim për të burgosurit. Që nga atëherë policia i ruan këto dhoma, duke mos i lejuar personelit qasje në to pa lejën përkatëse. Udhëheqësia e spitalit është e shqetësuar thellë nga marrja e këtyre dy dhomave, por gjithashtu edhe nga efekti shqetësues të cilin e shkakton prezenca e policëve të armatosur dhe të uniformuar në pacientët tjerë në repart, shumica prej të cilëve vuajnë nga traumat e shkaktuara nga njerëzit me uniforma në vitin 1999 dhe më herët. Si duket, këto dy dhoma përdoren për të burgosurit që kanë nevojë për çfarëdo përkujdesi mjekësore, prej shërimit/trajtimit fiziologjik (p.sh. kardiologji apo kancer) deri te personat me probleme serioze të shëndetit mental. Kur OSBE vizitoi këto dy dhoma në mars të v.2002, aty gjindeshin 5 persona. Personeli i spitalit kishte kuptuar se tre nga këta ishin nën "masa sigurie" sipas urdhërit të Gjykatës në Pejë. Zyrtarët e spitalit kishin deklaruar se këta persona, sipas mendimit të tyre, nuk ka nevojë të mbahen më aty për shkaqe shëndetësore, por urdhëri nga gjykata (i dhënë nga gjykata penale) do të thotë se ata duhej të qëndronin. Personi i katërt ishte në spital për shërim/trajtim fiziologjik, por është detyruar që të ndaj dhomën me të pestin, i cili ishte paraburgosur nga policia për sjellje të dhunshme dhe dyshohej se ishte i sëmurë mentalisht. Për këtë arsye dukej se ky i pesti ishte paraburgosur në mënyrë të kundërligjshme, sepse, pa implementimin e projekt-rregullores, kompetenca të tilla nuk shtrihen në polici. Aq më tepër trajtimi i këtyre personave, dhe pacientëve tjerë, nga ana e policisë rezikon të jetë jo human dhe degradues në kundërshtim me nenin 3 të KEDNj, në veçanti, refuzimi që të lejohet personeli i spitalit në repart, prezenca e policëve të uniformuar dhe të armatosur, dhe përzierja e pacientëve me probleme të shëndetit mental me ata me sëmundje fizike. Edhe për kundër kësaj zyrtarët e spitalit thanë që ka qenë e pamundur që të diskutohen këto çështje me Policinë e UNMIK-ut. DD njoftoi OSBE-në që kryesuesi i Shtyllës së I-rë, para pak kohe, ka lëshuar një instrukcion sipas të cilit të gjitha spitalet duhet të ndajnë nga një dhomë të siguruar dhe të dedikuar për përdorimin e të burgosurve që kanë nevojë të qëndrojnë në spital, por së paku në Prishtinë, kjo ka sjellur gjer te situata e cila duket të jetë marrje e dy dhomave nga policia, dhe përzierja e të burgosurve me nevoja fizike me ata me nevoja të shëndetit mental. Rrënjët e problemit janë të dyanëshme. Së pari, që spitalit i mungon një repart akut

¹⁰⁴ Lexo, Parimin 24, Grupi i Parimeve të KB-së për mbrojtjen e të gjithë personave nën çfarëdo forme të paraburgimit apo burgimit.

¹⁰⁵ Lexo Standardet e KB-së, Standardet minimale të rregullave për trajtimin e të burgosurve, neni 22(2).

¹⁰⁶ DD thotë se tani kanë marrëveshje në të gjitha regjionet për vizita nga psikologët nëpër burgje/qendra të paraburgimeve, por vizitat ende janë sporadike. P.sh. Në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, vetëm një psikolog i bën vizitat dhe zakonisht një herë në javë.

¹⁰⁷ Qendra e Paraburgimit në Lipjan informoi OSBE-në se kanë pasur së paku një të burgosur, i cili kishte nevojë për tretman të obligueshëm, por në mungesë të çfardo kompetence juridike të qartë e cila autorizon këtë, nuk kanë pasur mundësi ta bëjnë këtë.

me mundësi që të ofroj sigurinë e nevojshme për rastet akute të shëndetit mental, që kanë nevojë për paraburgim dhe trajtim/shërim të detyrueshëm. Arsyeja e dytë është se, autoritetet e burgut, policia dhe autoritetet e mjekësore, nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje se si të ofrojnë siguri të profilit të ulët për të burgosurit që kanë nevojë për trajtim në spital, që do të respektoj, edhe nevojat e sigurisë edhe pozitën e spitalit si ambient terapeutik.

III. EKSPERTIZA E SHËNDETIT MENTAL BRENDË SISTEMIT TË GJYQËSISË PENALE

Fusha e fundit dhe më shqetësuese është përdorimi ekspertizës psikiatrike në rastet penale. Janë tri fusha kryesore ku sistemi i gjyqësisë penale ka nevojë për këto ekspertiza. E para është në caktimin e shkallës së përgjegjësisë mentale në kohën e veprës së raportar; e dyta, caktimi i zotësisë së personit për gjykim korrekt (nuk ka ligj të qartë në Kosovë për këtë, edhe pse drafti i kodit të procedurës penale e parashikon këtë) dhe në fund, duke pasur parasysh kompetencat e vazhdueshme të gjykatave penale, përdorimi i masave të sigurisë, kur një person ka nevojë për paraburgim dhe shërim/trajtim të detyrueshëm.

Monitorimi i OSBE-së në rastet penale tregon se niveli i ekspertizave psikiatrike është një problem i madh. Shumica e rasteve ka të bëjë me kërkesat nga gjykata për vlerësimin e gjendjes mentale të personit në kohën e veprës. Megjithatë, për t'u dorëzuar raportet e ekspertizës nevojiten javë të tëra, nëse dorëzohen fare, (gjatë së cilës kohë personi mbahet në spital, vetëm për qëllim të vlerësimit, e jo për trajtim/shërim). Ekspertiza e dorëzuar shpesh herë është e pa mundur të vlerësohet nga gjykatësi, duke përmbajtur, si shumë prova tjera forenzike në Kosovë, rreshta të thjeshtë që thonë "personi ka qenë plotësisht i përgjegjshëm", gjë që nuk mund të kundërshtohet nga mbrojtja apo gjykata.

Gjatë një hetimi të zhvilluar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, i dyshimti, një shqiptar i Kosovës kishte shfaqur shenja të sëmundjes mentale që nga momenti i arrestimi të tij dhe gjatë tërë kohës se hetimeve. I dyshimti së pari u vendos në Qendrën e Paraburgimit në Prizren me 13 nëntor të v.2001, dhe me 4 dhjetor, gjykatësi hetues urdhëroi që i dyshuari të transferohet në spitalin e Prishtinës në Repartin Psikiatrik, për vlerësimin e gjendjes së tij mentale. Pasi që u mbajt në spital për 7 ditë, i dyshuari u lirua nga spitali dhe u dërgua prap në Qendrën e Paraburgimit me 27 dhjetor 2001. Megjithatë, ekspertët psikologë, nuk dhanë kurrfarë vlerësimi për të dyshuarin; ata e arsyetuan refuzimin e tyre duke indikuar, në një dokument që ia dërguan gjykatës, se i dyshuari ka pasur "sjellje të keqe" dhe se ndonjë institucion tjetër duhet ta bëjë ekzaminimin.

Një prej problemeve është se ekziston vetëm një psikolog forenzik i cili punon deri në një shkallë të caktuar në dhënjen e ekspertizave forenzike. Prap, një prej shkaqeve për zvarritjen e dhënjes së vlerësimeve është se spitalet nuk posedojnë një repart akut, me ambient të sigurtë, ku vlerësimet e rasteve të rënda do të mund të bëheshin relativisht shpejtë. Problemi më i madh duket të jetë ai që, sistemi i gjyqësisë dhe sistemi i shëndetësisë, kurr nuk kanë diskutuar në tërësi se çfarë ekspertize dhe në çfarë forme duhet të përgatitet e njëjta.

IV. REKOMANDIMET

Ligjet

- Projekt-rregullorja për privimin nga liria dhe trajtimin/shërimin e detyrueshëm, duhet të shpallet si çështje prioritare. Kjo do t'i paracakttojë qartë bazat për paraburgim dhe trajtim/shërim të detyrueshëm, për të gjitha autoritetet, një procedurë funksionale për shqyrtim gjyqësor dhe periudhat e caktuara në mes shqyrtimeve.
- Kodi i ri Penal dhe Kodi i Procedurës Penale duhet gjithashtu të hyjnë në fuqi menjëherë. Këto parashikojnë heqjen e “masave të sigurisë”; procedurë e qartë për vlerësimin e zotësisë së dikujt për të dalë në gjykim apo përgjegjësinë mentale të tij/saj; dhe mjetet juridike kur dëshmitë vonohen apo nuk janë adekuate.

Paraburgimi

- Instituti Special në Shtime duhet të përfundojë shqyrtimin e të gjitha rasteve brenda një muaji. Ekspertët Psikolog të caktuar, duhet të sigurohen për të lejuar që ky proces të kryhet.
- Të gjithë personat që nuk janë në paraburgim duhet t'ju jipet sqarim i qartë se ata janë të lirë që të largohen.
- Gjykatat duhet menjëherë të shqyrtojnë ligjshmërinë e **paraburgimit** të pacientëve. Dështimi për të bërë këtë duhet të rezultojë në ankesë pranë NjIGj.
- Secili spital që dëshiron t'i mbajë personat kundër dëshirës së tyre apo t'ju ofrojë trajtim/shërim të detyrueshëm duhet t'i dërzojnë rastet e tyre në Gjykatën Komunale në Prishtinë për vendim meritor.
- Personeli mjekësorë dhe juristët profesional duhet t'i nënshtrohen një serie të trajnimeve të kombinuara (nga IGJK dhe të tjerët) mbi ligjin dhe çështjet e shëndetit mental.
- Në spitalin e Prishtinës, duhet të krijohet menjëherë një repart i sigurtë psikiatrik akut, me personel dhe trajnime speciale, por nëse ka nevojë, edhe në vendet tjera.
- Duhet të ndërpritet përdorimi i “masave të sigurisë” nga gjykatat penale.

Trajtimi i të Burgosurve

- Të gjithë të burgosurit duhet të njoftohen për të drejtën e tyre që të drejtohen në gjykatë dhe të kërkojnë trajtim adekuat. Askujt nuk duhet t'i mohohet trajtimi i nevojshëm për arsye të sigurisë.
- Ministria e Shëndetit dhe Menagjimenti i Divizionit Penal, pranë DD, duhet të pajtohet për një dokument gjithëpërfshirës për nevojën e përkujdesit mjekësor nëpër burgje dhe siguri përkatëse për të burgosurit në spitale (duke pasur parasysh që spitalet janë ambiente terapeutike, dhe duhet të kenë kontrollin përfundimtar mbi ndërtesat e tyre dhe përkujdesjen).
- Dy dhomat në spital duhet të hapen menjëherë dhe policia e armatosur dhe e uniformuar duhet të largohet.

Provat e ekspertizës

- Nevojitet trajnimi urgjent për më tepër psikolog për çështjet e provave forenzike.
- Duhet të krijohet një Njesi e Psikologëve Forenzik, i aftë që të ofroj ekspertiza mjekësore dhe trajtime/shërime të ligjshme për të burgosurit përbrenda sistemit të gjyqësisë penale. Këto dy role duhet të jenë të ndara qartë. Personat që nuk janë brenda sistemit të gjyqësisë penale (përfshirë këtu edhe ata që shpallen të pa përgjegjshëm) nuk duhet të mbahen në burgje.

REKOMANDIMET E KONSOLIDUARA

PAVARËSIA E GJYKATAVE

- Si garancë për pavarësinë gjyqësore, PSSP dhe KFOR-i duhet zyrtarisht të braktisin çfarëdo ndërhyrje ekzekutive apo legjislative në fushën e autoritetit gjyqësor, posaqërisht në fushën e paraburgimit.
- Një prej funksioneve kryesore të sistemit gjyqësor është që mënyrë të pavarur të rishqyrtojnë legalitetin e veprimeve administrative dhe vendimeve të marra nga autoritetet shtetërore; si mënyrë për përforcimin e pavarësisë gjyqësore dhe për të garantuar të drejtën e individit për të sfiduar vendimet administrative që kufizojnë apo çenojnë liritë dhe të drejtat e tyre, OSBE rekomandon ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/47, ashtu që të lejoj gjykatat vendore të shqyrtojnë dhe vendosin mbi veprimet e tilla administrative apo vendimeve të autoriteteve të UNMIK-ut. Ndryshimi i Rregullores duhet qartë të definoj aktet e rregullta të ndërmarra nga UNMIK-u në kapacitetin e tij si administrator vendor, e cila pastaj duhet të jetë zyrtarisht e hapur për shqyrtimin gjyqësor. Gjykatat duhet gjithashtu të ndërmarrin iniciativën përkitazi me interpretimin e Rregullores së UNMIK-ut 2000/47 në frymë të ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe pasueshëm, të lejoj që ankesat të parashtrihen kundër akteve administrative të lëshuara nga UNMIK-u dhe efektivisht të rishqyrtoj aktet e tilla.
- OSBE rekomandon që pavarësia e KGJPK duhet më të tej të përforcohet. Nën kornizë-punën aktuale, zbulimet e KGJPK në dëgjimet disiplinore dërgohen, në formë të mendimeve këshilluese, tek PSSP i cili është ultimativisht autoritet vendim-dhënës në këtë qështje. OSBE rekomandon që vendimet e KGJPK në procedurat disiplinore duhet të jenë të mveshura më tepër me autoritet të plotë dhe të plotëfuqishëm se sa të jenë rekomandime PSSP-së. Për më tepër, OSBE rekomandon një ndryshim të rregullores me të cilën themelohet KGJPK, në kuptim që gjykatësit dhe prokurorët e dëgjuar në procedurën disiplinore nga KGJPK duhet të kenë të drejtën të shqyrtojnë vendimet e tilla. Teknikisht, OSBE rekomandon emërimin e dy anëtarëve plotësues të KGJPK ashtu që, prej gjithësejt 11 anëtarëve, mund të themelohen dy degë – njëra që vepron në instancën e parë dhe e dyta si instancë ankimore.
- Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë duhet të jenë subjekte të mekanizmit të njëjtë të përgjegjësisë disiplinore sikurse çdo anëtar tjetër i gjyqësisë. Duke pasur parasysh se KGJPK ka mundësi të rishqyrtimit të vendimeve të tij dhe se zbulimet e tij janë të mveshura me autoritet të ekzekutueshmërisë dhe nuk kërkojnë miratim formal nga PSSP, prandaj edhe gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë duhet të jenë subjekt të procedurës disiplinore nga KGJPK.
- Duke pasur parasysh kohëzgjatjen e shkurtë të zyrave për gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë, për shkak të sistemit të punësimit të KB dhe mvarësisë së disponueshmërisë së tyre nga miratimi i qeverive të shteteve të tyre, zgjatja e kontratave të këtyre zyrtarëve duhet të mirret jashtë autoritetit të DD dhe PSSP, si garancë e pavarësisë institucionale efektive. Qështja e zgjatjes së kontratave për gjykatësit ndërkombëtarë dhe prokurorët duhet të parashtrihet rregullisht pranë KGJPK për shqyrtim; një shqyrtim i tillë duhet të përmbajë të njëjtat kritere sikurse ato të aplikuara në procedurën e vlerësimit disiplinor.
- Rregullorja e UNMIK-ut 2000/64 duhet të ndryshohet. E para, kritere precize duhet të adoptohen zyrtarisht për të definuar aplikueshmërinë e rregullores për rastin konkret. Si plotësim, duhet të themelohet një mekanizëm për caktimin e rastësishëm të gjykatësve të cilët janë të caktuar për një rast specifik; ose, caktimi i zyrtarëve gjyqësor në raste nuk duhet lënë në diskrecion të DD dhe PSSP. Gjykatësit dhe prokurorët e caktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 duhet ti

përmbahen dhe nënshtrohen të gjitha garancave procedurale të siguruara nga ligji vendor, përfshirë edhe dispozitat mbi përjashtimin për shkaqe të paanshmërisë.

- Vlerësimi i aplikueshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut 2000/64 duhet të jetë transparent dhe i saktë. Kriteret që shqyrtohen kur bëhen vlerësimet e tilla duhet që zyrtarisht të adoptohen me një instruksion administrativ, dhe pastaj, këtyre kriterëve duhet përmbajtur në mënyrë strikte. Për të përforcuar përgjegjësinë, vendimet e PSSP për aplikimin e rregulloreve duhet të arsyetohen legalisht dhe faktikisht.

PARABURGIMI

- OSBE rekomandon që KFOR-i duhet të ndërprejë praktikën e tij të paraburgimit dhe zyrtarisht të braktisë autoritetin e tij në këtë fushë.

QËSHTJET E SHËNDETIT MENTAL

Ligjet

- Draft rregullorja për Privimin e Lirisë dhe Trajtimin e Obliguar duhet plotëfuqizuar si qështje prioritare. Kjo do të caktojë qartë bazat për paraburgim dhe trajtim të obliguar për të gjitha autoritetet, një procedurë funksionale për shqyrtim gjyqësor dhe periudhat e caktuara mes shqyrtimeve.
- Kodi i ri Penal dhe Kodi i Procedurës Penale duhet gjithashtu të plotëfuqizohen menjëherë. Këto ofrojnë për largimin e “masave të sigurisë”; procedurë e qartë për ta vlerësuar kapacitetin e dikujt që të dalë në gjykim apo përgjegjësinë mentale; dhe mjetet juridike kur dëshmitë vonohen apo janë jo adekuate.

Paraburgimi

- Instituti Special në Shtimje duhet të përfundojë shqyrtimin e të gjitha rasteve brenda një muaji. Ekspertët Psikolog specialistë duhet të sigurohen për të lejuar që ky proces të kryhet.
- Të gjithë personat që nuk janë në paraburgim duhet tu jipet sqarim i qartë që ata janë të lirë që të largohen.
- Gjykatat duhet të shqyrtojnë legalitetin e **paraburgimit** të pacientëve menjëherë. Dështimi për të bërë këtë duhet të rezultojë në ankesë pranë NjIGj.
- Cili do spital që dëshiron të mbajë personat kundër dëshirës së tyre apo tu japin trajtim obligativ duhet të dërgojnë rastin në Gjykatën Komunale në Prishtinë për vendim.
- Personeli mjekësorë dhe juristët profesional duhet të pranojnë seri të trajnimeve të kombinuara (nga IGJK dhe të tjerët) mbi ligjin dhe qështjet e shëndetit mental.
- Një repart i siguruar psikiatrik akut, me personel dhe trajnime speciale, duhet të krijohet menjëherë në spitalin e Prishtinës, dhe në vendet tjera nëse nevojitet.
- Përdorimi i “masave të sigurisë” nga gjykatat penale duhet të ndërprehet.

Trajtimi i të Burgosurve

- Të gjithë të burgosurit duhet të njoftohen për të drejtën e tyre që të drejtohen në gjykatë dhe të kërkojnë trajtim adekuat. Askujt nuk duhet ti mohohet trajtimi i nevojshëm në bazë të sigurisë.

- Ministria e Shëndetit dhe Menagjmenti i Divizionit Penal pranë DD duhet të pajtohet për një dokument gjithëpërfshirës për nevojën e përkujdesit mjekësor nëpër burgje dhe siguri përkatëse për të burgosurit në spitale (duke patur parasysh që spitalet janë ambiente terapeutike, dhe duhet të kenë kontrollin përfundimtar mbi ndërtesat e tyre dhe përkujdesjen).
- Dy dhomat në spital duhet të hapen menjëherë dhe policia e armatosur dhe e uniformuar duhet të largohet.

Provat e ekspertëve

- Nevojitet trajnim urgjent për më tepër psikolog për provat forenzike.
- Një Njesi e Psikologëve Forenzik duhet të krijohet, në mundësi që të ofrojë ekspertiza mjekësore dhe trajtime të burgosurve legalisht përbrenda sistemit të gjyqësisë penale. Këto dy role duhet të jenë të ndara qartë. Personat që nuk janë brenda sistemit të gjyqësisë penale (përfshirë këtu edhe ata që shpallen të pa përgjegjshëm) nuk duhet të mbahen në burgje.